Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN

# Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

## Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Dibër

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat.Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar.

UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN Women Zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: https://albania.unwomen.org

Kjo analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i zbatuar nga UN Women dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e Italisë. Ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilësdo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications

Autorë: Erald Lamja, Diamanta Vito, ekspertë të UN Women

Me kontribut teknik të: Rachele Megna, Besmira Kukaj, nga UN Women

Bashkia Dibër

Përpunimi grafik: HL Branding

Ky botim është i disponueshëm me akses të lirë në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e disponueshme në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/.

Botuesit duhet të heqin logot e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, UN Women nga botimi i tyre dhe të krijojnë një kopertinë të re. Botuesit duhet të dërgojnë versionin e tyre në format elektronik në adresën: permissions@unwomen.org. Fotokopjimi dhe riprodhimi i pjesëve të veçanta lejohet, për sa kohë që jepet njohja e duhur.

# Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

## Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Dibër

Qershor 2025

# Tabela e Përmbajtjes


Lista e shkurtesave 9

Përligjja e studimit 11

Përmbledhje e konstatimeve kryesore kontekstuale 12

**PJESA 1:** METODOLOGJIA 16

**PJESA 2:** ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS SË BMA-VE 26

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës së BMA-ve 27

1.1 Situata e zinxhirit të vlerës të BMA-ve në zonën e Dibrës 28

2. Diagram i zinxhirit të vlerës të bimëve mjekësore dhe aromatike 32

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 33

2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 35

2.3 Konstatimet e studimit 39

2.4 Ndërhyrje të rekomanduara për zinxhirin e vlerës të BMA-ve në Dibër 41

**PJESA 3:** ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS TË BULMETIT/PRODUKTEVE TË QUMËSHTIT 44

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës të bulmetit/produkteve të qumështit 45

1.1 Situata e zinxhirit të vlerës në produkteve të bulmetit/qumështit në zonën e Dibrës 46

2. Diagram i zinxhirit të vlerës të qumështit në NJA. Muhurr 50

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 51

2.2 Kuadri ligjor 54

2.3 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 55

2.4 Konstatimet e studimit 64

2.5 Rekomandime për zinxhirin e vlerës të qumështit 67

**PJESA 4:** SHTOJCAT 72

Shtojca 1. Bashkia Dibër: Informacion i përgjithshëm 73

Demografia dhe popullsia 74

Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale 76

Shërbimet komunale: furnizimi me ujë dhe energji elektrike 77

Infrastruktura publike dhe jeta sociale 78

Shërbimet sociale dhe ndihma ekonomike 78

Edukimi 79

Shëndetësia 80

Konteksti shoqëror ekonomik 81

Aktiviteti ekonomik 81

Bizneset aktive 81

Tregu i punës, punësimi dhe papunësia në Dibër 83

Bujqësia dhe blegtoria 84

Turizmi, trashëgimia kulturore dhe historike 88

Ushqimi Tradicional 90

Shtojca 2: Konteksti kombëtar i barazisë gjinore 90

Shtojca 3. Bujqësia dhe zhvillimi rural: çështje gjinore kyçe në Shqipëri 94

# Lista e Tabelave


**Tabela 1.** Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore 20

**Tabela 2.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve 21

**Tabela 3.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e produkteve të qumështit/bulmetit 23

**Tabela 4.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në grupin e zinxhirit të vlerës agroushqimor 24

**Tabela 5.** Listë e bimëve të egra që mblidhen në zonën e Dibrës 28

**Tabela 6.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të BMA-ve 31

**Tabela 7.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të BMA-ve 42

**Tabela 8.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qumështit 48

**Tabela 9.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të qumështit 69

**Tabela 10.** Popullsia sipas statusit familjar, 2023 75

**Tabela 11.** Numri i anëtarëve të familjes, 2023 76

**Tabela 12.** Shpërndarja e tokës 76

**Tabela 13.** Njësitë e banimit dhe sistemet e furnizimit me ujë, 2023 77

**Tabela 14.** Kërkesa për strehim social 78

**Tabela 15.** Personat me aftësi të kufizuara sipas gjinisë 79

**Tabela 16.** Arritjet në arsim sipas gjinisë, 2023 79

**Tabela 17.** Numri i çerdheve dhe kopshteve 80

**Tabela 18.** Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas gjinisë 80

**Tabela 19.** Treguesit e shëndetit 81

**Tabela 20.** Bizneset aktive, vitet nga 2020 në 2023 82

**Tabela 21.** Bizneset aktive sipas gjinisë 82

**Tabela 22.** Numri i bizneseve të regjistruara sipas njësisë administrative dhe madhësisë 82

**Tabela 23.** Treguesit e tregut të punës, 2023 83

**Tabela 24.** Bagëtitë në shifra, 2023 84

**Tabela 25.** Produktet blegtorale në Dibër, 2023 85

**Tabela 26.** Kulturat bujqësore të fushave, 2023 86

**Tabela 27.** Sipërfaqja dhe prodhimi i perimeve 87

**Tabela 28.** Pemët frutore dhe prodhimi 88

**Tabela 29.** Bujtinat 89

**Tabela 30.** Monumentet në Dibër 89

# Lista e Figurave

**Figura 1.** Qasja metodologjike 20

**Figura 2.** Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve 32

**Figura 3.** Diagram i zinxhirit të vlerës të qumështit 50

**Figura 4.** Bashkia Dibër 73

**Figura 5.** Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë 74

**Figura 6.** Numri i fermerëve të regjistruar 84

**Figura 7.** Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri 100

# Lista e Shkurtesave

| | |
|---|---|
| **AICS** | Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim |
| **AIDA** | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve |
| **AKU** | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| **AKVMB** | Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve |
| **AREB** | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor |
| **NJA** | Njësi Administrative |
| **FAO** | Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së |
| **PMB** | Praktikat e Mira Bujqësore |
| **GIZ** | Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| **OMGJ** | Organizma të Modifikuar Gjenetikisht |
| **ANGJZV** | Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës |
| **HACCP** | Analiza e Rreziqeve dhe Pikave Kritike të Kontrollit |
| **UNKN** | Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës |
| **INSTAT** | Instituti i Statistikave i Shqipërisë |
| **BMA** | Bimë Mjekësore dhe Aromatike |
| **MBZHR** | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| **MEKI** | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit |
| **DHKZ** | Dhoma Kombëtare e Zejtarisë |
| **QTTB** | Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore |
| **UN Women** | Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave |
| **USAID** | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar |
| **ZV** | Zinxhir i Vlerës |
| **FEG** | Fuqizimi Ekonomik i Grave |

# Përligjja e Studimit

Dhuna me bazë gjinore mund të krijojë barriera që pengojnë mundësitë ekonomike dhe zhvillimin. Nga ana tjetër, fuqizimi ekonomik i grave (FEG) mund të shtojë besimin dhe pavarësinë dhe të zvogëlojë gjasat që ato të jetojnë në situata të dhunshme; po kështu, rritja e fuqizimit ekonomik të grave u kundërvihet edhe stereotipave gjinorë dhe normave shoqërore të rrënjosura thellë, të cilat mund të manifestohen me rritje të dhunës me bazë gjinore.

**Ky dualitet nxjerr në pah ndërveprimin kompleks midis fuqizimit dhe rezistencës ndaj ndryshimit, që thekson nevojën e një qasjeje ndaj barazisë gjinore që është tërësore dhe e përshtatur me kontekstin.** Rrjedhimisht, fuqizimi ekonomik i grave shihet edhe si mjet për t'i dhënë fund dhunës në rastin e grave të mbijetuara të dhunës, edhe si një mënyrë për forcimin e pavarësisë ekonomike të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në forcat e punës.Këto dinamika janë veçanërisht të dukshme në bashkitë e Bulqizës, Malësisë së Madhe, Shkodrës, dhe Dibrës, të cilat janë bashkitë në qendër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut,"[1] i zbatuar nga UN Women Shqipëri, me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tiranë). Në këto zona mbizotërojnë stereotipet gjinore dhe ato karakterizohen nga mungesa sistematike të shërbimeve sociale, si transporti publik dhe kopshtet e fëmijëve; aksesi i kufizuar ose i paqartë në të drejta pronësore të grave; si dhe shkallë e lartë e punës së papaguar dhe informale që kryejnë gratë, që mund të kufizojë shkallën në të cilën ato mund të marrin pjesë në veprimtari ekonomike.[2] Për t'i trajtuar këto probleme, UN Women promovon qeverisjen e përgjigjshme gjinore, ku përfshihen elementë të forcimit të reagueshmërisë gjinore të kornizës së politikave bujqësore dhe të zhvillimit vendor në nivel kombëtar dhe lokal, përmes rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e grave dhe adresimit të stereotipeve gjinore, përfshirë në lidhje me të drejtat pronësore dhe për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirit të vlerave është një strategji proaktive që jo vetëm promovon barazinë gjinore, por edhe forcon efikasitetin, qëndrueshmërinë, dhe karakterin përfshirës të ekonomive rurale. Kjo qasje e bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, parimet e drejtësisë sociale dhe avantazhet ekonomike të përfshirjes gjinore për bizneset – si ato që janë shtjelluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)[3] – i njeh gratë si kontribuese aktive në produktivitetin ekonomik dhe forcimin e aftësisë së komunitetit për të përballuar situata të vështira. Kjo nismë synon të transformojë dinamikën ekzistuese të pushtetit dhe të zgjerojë rolet e grave si veprimtare ekonomike. **Garantimi i reagueshmërisë gjinore të ligjeve, politikave dhe shërbimeve do të krijojë një mjedis mundësues që mbështet jo vetëm të drejtat e grave, por edhe aftësinë konkurruese dhe qëndrueshmërinë ekonomike të tyre.** Nga ana e tij, promovimi i fuqizimit ekonomik të grave forcon autonominë e grave dhe bën të mundur që ato të dalin nga cikli i dhunës, të kërkojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë më të plotë në familje dhe komunitet. Përmes njohjes së rolit kyç të barazisë gjinore në arritjen e një zhvillimi rural përfshirës dhe të qëndrueshëm, ky projekt ndërmerr të kryejë **analiza me ndjeshmëri gjinore të zinxhirit të vlerave, të përshtatura me veçoritë e zonave** në secilën bashki partnere. Këto analiza synojnë të evidentojnë sektorët kyç të ekonomisë dhe zinxhirët e vlerave që kanë potencial zhvillimor, të hartëzojnë rolet e diferencuara të grave dhe burrave në këta zinxhirë vlerash, dhe të identifikojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen dhe rolin drejtues të grave. Mbi bazën e këtyre të dhënave po përgatiten ndërhyrje të posaçme për rritjen e aksesit të grave në mundësi ekonomike dhe për të promovuar një zhvillim të drejtë gjinor të zinxhirit të vlerave. Studimi bën një analizë të Bashkisë së Dibrës nga këndvështrimi gjinor dhe sugjeron qasje me ndjeshmëri gjinore për forcimin e barazisë gjinore në zinxhirët e vlerës ekonomike dhe përmes tyre, bazuar në ekspertizën e UN Women në këtë fushë.[4] Ai synon të identifikojë strategji konkrete dhe të realizueshme për forcimin e barazisë gjinore **në zinxhirët e vlerës dhe përmes tyre,** duke u mbështetur në ekspertizën globale të UN Women dhe partneritetet vendore. **Përmes promovimit të zinxhirëve të vlerës me përfshirje të gjerë, projekti synon të çlirojë potencialin e plotë ekonomik të grave dhe të forcojë rolet e tyre si faktorë të ndryshimit në zhvillim të qëndrueshëm rural.**

1. Projekt i financuar nga AICS – Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor dhe i zbatuar nga UN Women Shqipëri (2024-2027).
2. *Empowering Women in the Rural Economy* (Fuqizimi i grave në ekonominë rurale). Shih: https://www.ilo.org/sites/default/files/wcms-sp5/groups/public/%40ed_dialogue/%40sector/documents/publication/wcms_601071.pdf
3. *Guide to Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development* (Udhëzues për qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerave). Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). (2022). Shih: https://www.ilo.org/publications/guide-gender-sensitive-approaches-value-chain-development
4. https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/12/gender-sensitive-value-chain-analysis

# Përmbledhje e Konstatimeve Kryesore Kontekstuale

Dibra ka një trashëgimi natyrore dhe kulturore të pasur, me potencial të konsiderueshëm për turizëm dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Burimet bujqësore në zonë ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për diversifikim, prodhim me vlerë të shtuar dhe zgjerim të tregut.

Gratë dhe vajzat janë më të shumta në numër, sidomos në grupmoshën 20-24 vjeç, që është grupmosha më e madhe, me 3.941 individë (1.819 meshkuj dhe 2.122 femra). Banorët e moshuar përbëjnë gjithashtu një grup të konsiderueshëm, me 2.880 persona në grupmoshën 65-69 vjeç dhe 3.877 në grupmoshën 60-64 vjeç. Numri i nënave të vetme (772) është shumë më i madh se sa ai i baballarëve të vetëm (136), që thekson nevojën e mbështetjes me shërbime përkujdesi për fëmijët, punësim dhe stabilitet financiar. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në forcat e punës (56,4%) vazhdon të jetë më e ulët se sa e burrave (67,2%), që është tregues i pengesave të hasura prej tyre për të pasur akses në punësim dhe sipërmarrje, duke ngritur nevojën e politikave reaguese për krijimin e një tregu pune më të barabartë. Tabloja e punësimit në Dibër pasqyron dallime sektoriale dhe me bazë gjinore për kapërcimin e të cilave duhen ndërhyrje të fokusuara me ndjeshmëri gjinore. Numri i bizneseve me pronare gra u rrit me 6,4% në vitin 2023, por ende mbetet shumë më i ulët se numri i bizneseve me pronarë meshkuj. Në ekonominë e zonës mbizotërojnë bujqësia dhe shërbimet, që ofrojnë mundësi të ndryshme punësimi; megjithatë, këta sektorë kanë dinamikë gjinore të veçantë. Gratë janë të punësuara në role përkujdesi dhe në punë me paga të ulëta, sidomos në arsim, shëndetësi, dhe në shërbimet e hotelerisë dhe të ushqimit.[5] Zinxhiri i vlerës i bujqësisë është i dominuar nga meshkujt, ndërsa gratë merren kryesisht me bujqësi për plotësimin e nevojave të familjes, prodhime bulmeti, dhe punë të papaguar. Forcimi i rolit të grave në bujqësinë komerciale dhe agrobiznes mund të forcojë qëndrueshmërinë ekonomike të tyre përmes sigurimit të mundësive për integrim në treg dhe pavarësi financiare. Sektori i tregtisë, ku gratë kanë një pjesëmarrje relativisht të lartë, përfaqëson një pikë hyrjeje për gratë sipërmarrëse, çka thekson nevojën për politika që lehtësojnë aksesin e tyre në kapital, trajnime dhe rrjete mbështetëse për zgjerimin e bizneseve të tyre. Sektori i bujqësisë në Dibër ka potencial të konsiderueshëm për prodhim me vlerë të shtuar, sidomos sa u përket bimëve mjekësore dhe aromatike, produkteve të bulmetit, dhe përpunimit agrobujqësor. Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike bëhet në 10 hektarë, me prodhim vjetor 17 ton dhe dëshmon për një sektor në rritje me potencial për përfshirjen e grave. Prodhimi i qumështit është i konsiderueshëm, me një total 26.094 ton, nga të cilët 23.147 ton qumësht lope, 1.682 ton qumësht delesh dhe 1,265 ton qumësht dhish. Zgjerimi i roleve të grave në kooperativat e bulmetit, përpunimin e produkteve me vlerë të shtuar dhe në menaxhimin e hallkave të furnizimit, mund të krijojë mundësi ekonomike të qëndrueshme. Përpunimi agrobujqësor, sidomos i drithërave dhe perimeve

**Gratë janë të punësuara në role përkujdesi dhe në punë me paga të ulëta, sidomos në arsim, shëndetësi, dhe në shërbimet e hotelerisë dhe të ushqimi.**



**Bizneset në pronësi të grave u rritën me 6.4% në vitin 2023, por mbeten të pakta dhe kërkojnë më shumë burime.**

**Shkalla e pjesëmarrjes së grave në forcën e punës është 56.4% krahasuar me 67.2% për burrat.**

5. *USAID PLGP "GSVCA Dibër"* (Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës në Dibër, Projekti PLGP i USAID), 2019.

– me 4.675 hektarë të dedikuar për prodhimin e drithërave, ndër të cilët 3.380 hektarë me misër që prodhojnë 25.170 ton dhe 1.140 hektarë me grurë që prodhojnë 5.315 ton – mbetet mundësi ende e pashfrytëzuar. Krahas kësaj, perimet kultivohen në 593 hektarë, me prodhim 17.610 ton, ku patatja është kulturë kryesore. Pjesëmarrja e grave në ruajtjen dhe përpunimin e ushqimeve, si dhe në prodhime organik karakteristike të zonës mund të forcojë hallkat e furnizimit vendor dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Turizmi është një sektor tjetër ku ndërhyrjet me ndjeshmëri gjinore mund të shtojnë fuqizimin ekonomik të grave. Në vitin 2024, Dibra pati 65.567 vizitorë të tërhequr nga bukuritë natyrore dhe vendet me interes kulturor. Gratë janë të përfshira në menaxhimin e bujtinave, shërbimet ushqimore, punimet artizanale, por kontributet e tyre në pjesën më të madhe mbeten të padukshme në statistikat ekonomike zyrtare. Dibra ka 22 bujtina të regjistruara, por ka edhe shumë akomodim informal, kryesisht i ofruar nga gratë, të cilat marrin përsipër rolet e gatimit dhe të menaxhimit të mikpritjes. Përveç kësaj, 70% e banorëve në lagjen "Llixha" i përdorin shtëpitë e tyre për akomodim të turistëve, ku gratë luajnë rol të rëndësishëm edhe në këtë sektor. Mbështetja e sipërmarrjeve turistike të grave dhe formalizimi i roleve të tyre përmes trajnimeve të posaçme, ndihmës për zhvillimin e bizneseve, dhe aksesit në financim, mund të nxisë një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe të krijojë mundësi të reja për gjenerimin e të ardhurave. Duke forcuar lidhjet ndërmjet turizmit, bujqësisë dhe trashëgimisë kulturore, Dibra mund të krijojë në zinxhir vlere të integruar që forcon pjesëmarrjen dhe rolin drejtues të grave. Me gjithë ekzistencën e këtyre mundësive, ekonomia e zonës ende përballet me sfida të konsiderueshme, si aksesi i kufizuar në kapital, kufizimet infrastrukturore, dhe dallimet gjinore në sektorë të ndryshëm.[6] Sa i përket qasjes me ndjeshmëri gjinore, mbizotërimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe i zonave natyrore, ofron mundësi potenciale për pjesëmarrjen e grave në përpunimin agrobujqësor dhe blegtoral. Planimetria urbane e Dibrës përbën një barrierë shtesë për barazinë gjinore, sidomos në lidhje me angazhimin shoqëror dhe mundësitë e lëvizjes. Në zonë mungojnë hapësirat dhe mjediset kulturore me përdorim të përbashkët, ku gratë mund të mblidhen, të krijojnë lidhje dhe rrjete, dhe të marrin pjesë në jetën publike, çka kufizon mundësitë e tyre për ndërveprim social, angazhim në komunitet, dhe akses në shërbime mbështetëse. Hapësirat publike të pamirëmbajtura, ndriçimi i pamjaftueshëm dhe rrugët e rrugicat jo të sigurta, kufizojnë m tej aftësinë e grave për të lëvizur lirisht dhe të sigurta në komunitetet e tyre, gjë që ndikon në pjesëmarrjen ekonomike dhe sociale të tyre. Në zonat rurale, problemi është edhe më i theksuar, ku gratë përjetojnë izolim social më të madh dhe akses të kufizuar në shërbime bazë, që përkeqëson cenueshmërinë ekonomike dhe kufizon rolin e tyre në proceset e vendimmarrjes. Peizazhi ekonomik i Dibrës ofron mundësi të shumta për ndërhyrje me ndjeshmëri gjinore në bujqësi, turizëm dhe sipërmarrje.[7] Hartimi i politikave reaguese gjinore në zhvillimin e biznesit, që sigurojnë aksesin e grave në burime financiare, tregje, dhe trajnime, si dhe forcimi i njohurive digjitale dhe financiare të tyre, mund t'i bëjë ato më konkurruese në zinxhirë të rinj të vlerës. Rritja e pjesëmarrjes së grave në prodhim bujqësor me vlerë të shtuar dhe turizëm, krahas investimeve të fokusuara në infrastrukturën shoqërore, do të forcojë qëndrueshmërinë e tyre ekonomike dhe përfshirjen në shoqëri. Duke trajtuar kufizimet specifike gjinore, Dibra mund të nxisë krijimin e një mjedisi ekonomik përfshirës që maksimizon potencialet e grave dhe të burrave, dhe kontribuon në një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të barabartë.

**Bashkia Dibër**

Sipërfaqe
**1,822 km²**
(15 njësi administrative)

Popullsia
**50,775**
(25,228 gra dhe 25,547 burra)

6. Bashkia Dibër; www.dibra.gov.al
7. Bashkia Dibër, www.dibra.gov.al

# Konstatimet Kyryesore

**Konstatimi I** reth 500 familje në zonat rurale merren me mbledhjen spontane të BMA-ve. Një numër i vogël familjesh vazhdojnë kultivimin në shkallë të vogël të kokoçelit në NJA Melan (në fshatrat Trepçë dhe Tren). Produktet i dorëzohen konsoliduesit pasi janë tharë. Probleme kryesore janë përdorimi i thasëve të kontaminuar gjatë mbledhjes dhe transportit, dhe mjediset e tharjes me rrezik të lartë kontaminimi. Konsoliduesi i zonës është i gatshëm të marrë rol aktiv dhe të promovojë kultivimin dhe praktikat e mira pas vjeljes (tharja).

**Konstatimi II** Grupi i Trepçës përbëhet nga 20 gra që mbledhin bimë të egra si rigoni i kuq, lule bliri, kalendula, lule shtogu, trëndafili i egër, trumza, etj. Tharja e bimëve bëhet kryesisht në mjedis të hapur ose mbi çarçafë në shtëpi, me rrezik të lartë kontaminimi dhe humbjeje të cilësisë. Një numër i vogël grash i shesin ato drejtpërdrejt në tregun vendor ose panaire. Megjithatë, paketimi është shumë primitiv dhe etiketimi pothuaj nuk ekziston. Pjesa më e madhe e produktit shitet me shumicë tek konsoliduesi i zonës. Gratë merren edhe me kultivim në shkallë të vogël. Ato shprehin interes për kultivimin e bimëve të përhershme, që do të kishte më pak kosto dhe do të kërkonte më pak punë. Konstatohet se gratë kanë vështirësi të menaxhojnë bimët të cilave u merren lulet.

**Konstatimi III** Vizita në familjen e bletërritësve zbuloi mangësi në njohuri dhe në teknikat e përdorura, si dhe humbje të vazhdueshme të kolonive të bletëve (deri në 60% vitin e kaluar).

**Konstatimi IV** Sektori i mikpritjes (agroturizmi, bujtinat, etj.) ka bazë potenciali të lartë në numrin e madh të vizitorëve. Megjithatë, dallimet midis një biznesi të ri, të thjeshtë e me pak investime të një gruaje dhe qendrës së konsoliduar të agroturizmit (ndërtuar me fonde të IPARD-it), vuri në pah nevojën për investime të mëdha buxhetore në këtë ZV.

**Konstatimi V** Rreth dhjetë gra në fshatin Staravec prodhojnë reçele, gliko, lëngje frutash (ftoi, qershie, vishnje, molle dhe kumbulle), si dhe produkte me bazë grurin, si jufka dhe tërhan. Ato aktualisht punojnë dhe prodhojnë vetëm për nevojat familjare dhe ndonjëherë marrin pjesë edhe në panaire të zonës. Ky grup është në hapat e parë të funksionimit. Gratë nuk kanë një vend pune të përbashkët, nuk zbatohen normat e sigurisë ushqimore, paketimi bëhet në shishe dhe kavanoza të përdorur, brandi dhe etiketimi janë inekzistent. Edhe këto gra mbledhin bimë të egra dhe kanë shprehur interes të merren me kultivim nëse u jepet mbështetje dhe njohuri.

**Konstatimi VI** Baxhoja në Muhurr mbledh kryesisht qumësht dhie prej 20 familjeve fermere. Gratë përbëjnë më se 60% të personave që merren me blegtori dhe ato janë aktive në të gjitha fazat, që nga kujdesi për bagëtitë, e deri tek mjelja. Mjelja bëhet me dorë dhe shumica e fermerëve përdorin bidonë plastikë dhe të vjetër që rezultojnë në cilësi më të ulët të qumështit dhe rrezik më të lartë kontaminimi. Përveç kësaj, gratë nuk kanë veshje, vegla dhe kushte pune të përshtatshme. Pronaret e baxhos, Liliana dhe Selmani janë shumë bashkëpunues dhe shprehin gatishmëri të mbështesin zhvillimin e ZV-së. Në qoftë se gratë që merren me blegtori do të kenë më shumë njohuri dhe kushte më të mira, ato mund t'i shtojnë tufat dhe të marrin më shumë të ardhura. Baxhoja planifikon të zgjerojë gamën e produkteve dhe të bashkëpunojë me më shumë fermerë të zonës.

### Sfidat dhe mundësitë:

- Gratë merren me mbledhjen spontane të BMA-ve, por puna e tyre është shpesh e nënvlerësuar, informale dhe e padukshme. Ndonëse gratë kanë njohuri tradicionale për BMA-të, ato nuk kanë njohuri të gjera për fazat e kultivimit, tharjes, përpunimit, dhe marketimit, si dhe për standardet, për t'i shtuar vlerën produkteve dhe për të rritur të ardhurat e tyre.

- Gratë përballen me barriera në aksesimin e burimeve dhe pjesëmarrjen aktive në zinxhirë vlere me potencial të lartë (si sektori i mikpritjes). Ndonëse zona ka potencial të konsiderueshëm për agroturizëm, kufizimet në infrastrukturë, përfshirë edhe në akomodim dhe aktivitete promocionale, pengojnë zhvillimin. Bashkia ka burime dhe kapacitete të kufizuara për t'iu përgjigjur kërkesave të vizitorëve në zinxhirin e vlerës së mikpritjes.

- Gratë punojnë në mënyrë informale dhe nuk kanë akses në informacion dhe burime. Mungesa e rinisë është e dukshme në zinxhirët e vlerës që u morën në shqyrtim.

- Përpunimi agroushqimor tradicional është mjaft i përhapur në gjithë territorin e bashkisë. Ndonëse disa nga grupet e grave janë më të përparuara për sa i përket bashkëpunimit, teknologjisë dhe marketingut, ka ende potencial për të zbatuar dhe zgjeruar më tej modelet ekzistuese të suksesshme.

- Gratë që merren me bletari nuk kanë njohuri, aftësi dhe nuk zbatojnë praktikat e mira. Puna e tyre është e nënvlerësuar dhe roli i tyre ende i padukshëm në këtë ZV: nga 18 gra bletërritëse në zonë, vetëm një është anëtare e shoqatës së bletarëve të zonës.

- Blegtoria, sidomos ajo e ripërtypësve të vegjël është aktivitet mjaft i përhapur në NJA Muhurr. Gratë kujdesen për bagëtitë, i mjelin ato dhe kryejnë punë të tjera të përditshme në fermat e tyre. Ato nuk kanë njohuri për praktikat e mira në kujdesin për bagëtitë dhe nuk kanë kontroll mbi asetet, dhe sidomos nuk kanë veglat dhe mjetet që lehtësojnë ngarkesën e punës dhe rrisin produktivitetin.

# Pjesa 1
# **Metodologjia**

Kjo analizë u krye nga UN Women Shqipëri, në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tirana).

Me mbështetjen e personelit të bashkisë dhe bashkëpunimin e grupeve të rëndësishme të interesit nga zinxhirët e vlerave, ky studim synoi të evidentonte sektorët ekonomikë me potencial rritjeje dhe për fuqizimin e grave në Bashkinë Dibër. Në veçanti, ai vlerësoi pjesëmarrjen e grave në këta sektorë, pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballen, si dhe disa zinxhirë vlerash me potencial të lartë për zhvillim. Krahas kësaj, ai ofron rekomandime reaguese gjinore për forcimin e roleve të grave dhe eliminimin e paragjykimeve gjinore në sistemin e tregut. Gjatë gjithë analizës u zbatua një qasje me ndjeshmëri gjinore për të siguruar përfshirjen e plotë të mendimeve të grave, të sfidave dhe mundësive të tyre, në vlerësimin e zinxhirit të vlerës.

Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore në zinxhirët e vlerës bazohet kryesisht në metodologjinë e shtjelluar në *Making the Strongest Links: A Practical Guide to Mainstreaming Gender analysis in Value Chain Development* (Krijimi i hallkave më të forta – udhëzues praktik për përfshirjen e analizës gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës) nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) botuar në vitin 2007; udhëzuesi plotësues *Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development: A Complementary Guide* (Qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës: Udhëzues plotësues), po ashtu botim i ONP-së në vitin 2022; dhe *Guide for Practitioners dhe Interested Stakeholders* (Udhëzues për profesionistët dhe grupet e interesit) përgatitur nga USAID në vitin 2019 dhe ribotuar nga UN Women Shqipëri në vitin 2021.
Në analizë u përdor metodologjia e kërkimit sasior, me përfshirje të burimeve parësore dhe dytësore të të dhënave për të mundësuar një kuptim tërësor të dinamikave ekonomike dhe gjinore në bashkinë e Dibrës. Analiza përfshiu edhe një ekzaminim të thelluar të të dhënave dytësore, ku përfshiheshin raporte zyrtare dhe burime statistikore. Ndër burimet dytësore që u konsultuan ishin raporte të dhe të dhëna të ndryshme, që u mblodhën kryesisht nga botime dhe statistika zyrtare të Institutit të Statistikave të Shqipërisë, raporte të bashkisë, raporte të këshillit të qarkut, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe të dhëna dhe informacion i marrë nga studime dhe projekte të mëparshme të zhvilluara në fushën përkatëse.[8] Raportet bashkiake (kryesisht planet strategjike dhe operacionale, planet buxhetore afatmesme), ishin veçanërisht me vlerë për të kuptuar strukturën ekonomike të zonës dhe vizionin e bashkisë për sigurimin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Për përzgjedhjen e zinxhirëve të vlerës u përdorën burimet parësore, d.m.th. puna kërkimore në terren, ku u përfshinë konsultime me grupe të ndryshme dhe seancave për rrahjen e mendimeve me përfaqësues të bashkisë, aktorë të zinxhirit të vlerës (gra dhe burra), prodhues dhe specialistë. Gjatë punës në terren dhe vlerësimit të zinxhirëve të vlerës të kryer në Bashkinë Dibër, u angazhuan drejtpërdrejt 30 individë në intervista, vizita në terren dhe takime, nga të cilët 28 gra dhe 2 burra.

**Vlerësimi paraprak:** U mbajtën diskutime dhe takime me përfaqësues të bashkisë, prodhues, anëtarë të ekipit të projektit dhe organizata mbështetëse për të parë mundësitë e zinxhirëve të vlerës. Seancat në grupe fokusi me përfaqësues të bashkisë ndihmuan në identifikimin e kufizimeve, pengesave specifike gjinore, dhe mundësive që lidhen me zinxhirët ekzistues apo të krijuar rishtas të vlerës.

Bazuar në këtë punë paraprake në terren, u identifikuan disa sektorë kyç për analizë të mëtejshme, në sajë të potencialit të tyre për zhvillim ekonomik dhe pjesëmarrjen e grave në fushat përkatëse. Këtu përfshihen **produktet bujqësore të përpunuara, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të), bletaria, shërbimet e lidhura me turizmin.** Këtyre sektorëve iu dha përparësi për shkak të aksesit të grave në to, potencialit për krijimin e vendeve të punës, njohurive ekzistuese në zonë dhe relevancës kulturore.Në përputhje me Agjendën e ONP-së për Punë të Denjë, përzgjedhja e këtyre sektorëve thekson objektiva si:

- **Promovimi i punësimit produktiv** përmes sektorëve me mundësi zhvillimi dhe me intensitet të lartë pune në nivel vendor;
- **Zgjerimi i aksesit në mundësi të drejta** për fitim të ardhurash nga gratë dhe grupet e margjinalizuara;

8. Shih: https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732; http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/programi-buxhetor-afatmesem-vendor/; http://dibra.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Raporti-i-Performanc%C3%ABs-Diber-2022.pdf; http://dibra.gov.al/wp-content/uploads/2019/10/Plani-i-Zhvillimit_PPV-Diber.pdf

- **Përmirësimi i kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale,** sidomos në bujqësi dhe aktivitetet informale;

- **Forcimi i zërit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje** në të gjithë zinxhirët e vlerës.

Mbledhja e të dhënave parësore u krye në dy faza: faza e vlerësimit paraprak të sektorit, dhe faza e dytë, më e thelluar, për përzgjedhjen e zinxhirit të vlerës dhe angazhimit të grupeve të interesit. Në fazën e parë, atë të vlerësimit paraprak, u bënë diskutime dhe takime me përfaqësues të bashkisë, me prodhues, dhe me ekipin e projektit, për të identifikuar mundësitë për gratë në sektorët ekonomikë dhe zinxhirët e vlerës. Kjo fazë filloi me një seancë në grup fokusi me përfaqësues të bashkisë, gjatë së cilës pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset patën mundësinë të diskutonin më tej për detajet, mundësitë dhe pengesat, si dhe të krijonin një ide dhe të kuptuar më të qartë të zinxhirëve të vlerës.

Mbi bazën e konstatimeve të fazës së vlerësimit paraprak, u kryen vizita në terren, intervista dhe takime me grupet e interesit, për të vlerësuar zinxhirë specifikë të vlerës. Konstatimet nga shqyrtimi i dokumentacionit fillimisht u validuan me bashkinë gjatë takimit në grup fokusi të datës 21.01.2025 (Ardit Hoxha, drejtor i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Bashkinë Dibër; Jeta Kaba, shefe e Sektorit të Turizmit; Erion Kola, specialist në Sektorin e Turizmit); si dhe u eksploruan më tej gjatë vizitave në terren. Puna në terren përfshiu:

- Vizitë dhe intervista më 19.02.2024 me dy grupe grash në Pocest dhe Kërçisht (NJA Maqellarë), që merren me përpunimin tradicional të prodhimeve agro-ushqimore (*jufka*, *tërhan*, reçele, turshi, ëmbëlsira, etj.).

- Vizitë në qendrën e grumbullimit/kompaninë e BMA-ve në Dibër, takim dhe intervistë me pronarin, Zyber Gjoni, më 22.01.2025.

- Vizitë në bujtinën/qendrën agroturistike "Nëna Dashuri", në NJA Melan. Takim me Fabjon Zerjën (anëtar i familjes Zerja) që merret me agroturizëm dhe prodhimin e produkteve të përpunuara bujqësore (PPB) më 22.01.2025

- Vizitë në terren dhe intervistë me Majlinda Keshin, bletërritëse në Majtarë (NJA Maqellarë) më 22.01.2025.

- Vizitë në një bujtinë të re informale (që ofron fjetje dhe mëngjes), dhe intervistë me Melita Keshin (Pocest, NJA Maqellarë), 22.01.2025

- Vizitë në terren dhe takim me grupin e grave që merret me mbledhjen spontane dhe kultivimin e BMA-ve në Trepçë (NJA Melan) më 14.02.2025 (Teuta Topuzi, Hajrije Mehmeti, Bashkime Deba, Ibe Kafali, Etmira Mehmeti, Adefije Karaliu, Fatbardha Doda, Dian Dema, Anila Topuzi, Safije Xhaferri, etj.).

- Vizitë në terren dhe takim me gra që merren me përpunimin (në fazë të hershme) të produkteve tradicionale agroushqimore në Staravec, më 14.02.2025 (Emrije Lata, Nafije Kurti, Melita Tapja, Tahire Ramku, Flora Ramku).

- Vizitë në terren dhe takim me një familje blegtorësh dhe vizitë në baxhon "Bjeshkët e Runjës" në Muhurr, më 14.02.2025 (Liliana Voka, Selman Voka, Nurie Farruku, Milita Zenehasani, Flutura Lleshi, Bleona Voka).

Këto vizita mundësuan kryerjen e vrojtimeve në terren dhe të intervistave të gjysmëstrukturuara dhe arritjen e një të kuptuari të thelluar të roleve të grave, si edhe të kufizimeve dhe mundësive në zinxhirët e vlerës.

Puna në terren ofroi informacion të rëndësishëm për strukturën dhe dinamikën e zinxhirëve të vlerës në Dibër, duke vënë në pah potencialin ekonomik, barrierat ndaj pjesëmarrjes së grave dhe fushat ku mund të kryhen ndërhyrje të fokusuara, si për forcimin e zhvillimit ekonomik, ashtu edhe për forcimin e barazisë gjinore.

Për vlerësimin e zinxhirëve potencialë të vlerës u përdorën këto kritere:

- A ka kërkesa në rritje për produktin?

- A janë të përfshira gratë në hallkat e zinxhirit të vlerës?

- A janë shumica e hallkave në zinxhirin e vlerës me bazë në bashki?

- A ka nisma të tanishme apo të kohëve të fundit që mund të shërbejnë si bazë për zinxhirin e vlerës?

- A krijohen mundësi nga zhvillimi i zinxhirit të vlerës?

- A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për zhvillim/diversifikim në zinxhirin e vlerës?

Grupet e interesit të përfshira kontribuan aktivisht për identifikimin e të gjithë përbërësve kryesorë të sistemit të tregut të zinxhirit të vlerës, duke diskutuar si për kufizimet, ashtu edhe rolin e grave në faza të ndryshme të proceseve.
Përmes vizitave në terren, vrojtimit të drejtpërdrejtë aktiviteteve të punës dhe intervistave të gjysmëstrukturuara me pyetësorë të posaçëm për pjesëmarrës të ndryshëm në zinxhirin e vlerës, studimi identifikoi zinxhirët e vlerës me potencialin më të madh për zhvillim dhe fuqizim të grave për vlerësim të mëtejshëm në bazë të tabelës së kritereve për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore këto zinxhirë të vlerës: BMA-të; sektori agroushqimor tradicional; dhe ai i qumështit/bulmetit (me fokus NJA Muhurr).

Në përgjithësi, në proces u ndoqën këta hapa:

1. Përcaktimi i objektivave dhe i grupit të synuar: Caktimi i objektivave bazuar në synimet kombëtare dhe bashkiake (konkretisht, përmirësimi i jetesës dhe promovimi i barazisë gjinore) dhe përcaktimi i grupit të synuar dhe i kritereve të përzgjedhjes:

2. Grupi i synuar: gratë dhe burrat në zonat rurale veriore;

3. Kriteret: rëndësia e zinxhirit të vlerës në krijimin e mundësive për fuqizimin ekonomik ët grave.

4. Vlerësimi i situatës në bashki: Studimi fillestar i situatës në bashki dhe studim i dokumentacionit të planeve, strategjive, studimeve të mëparshme, etj.;

5. Sektorët kryesorë: Identifikimi i sektorëve kryesorë përmes vlerësimit të raporteve, të dhënave dhe botimeve të ndryshme;

6. Vlerësimi i ZV-ve: Vlerësimi i zinxhirëve kryesorë të vlerës në sektorët e përzgjedhur përmes marrjes së mendimeve, diskutimeve, dhe grupeve të fokusit;

7. Përzgjedhja e ZV-ve: Përzgjedhja e një deri në dy zinxhirëve të vlerës dhe vlerësimi i mundësive, kufizimeve dhe fushave të ndërhyrjes përmes punës kërkimore në terren;

8. Rekomandime: Rekomandime për bashkinë lidhur me përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe rekomandime për projektin në lidhje me mundësitë e ndërhyrjes.

**Figura 1.** Qasja metodologjike




**Tabela 1.** Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore

| Kriteret | BMA-të | Sektori agroushqimor | Qumështi |
|---|---|---|---|
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | Gratë janë të përfshira në pjesën më të madhe të fazave të zinxhirit të vlerës, përfshirë kultivimin, vjeljen dhe tharjen fillestare. Disa gra bëjnë edhe transportimin e tyre tek konsoliduesit vendorë. Një numër i vogël i tyre kanë filluar të bëjnë paketim me etiketa të thjeshta për tregun lokal, që përfaqësojnë mundësi për rritje dhe diversifikim të mëtejshëm. | Gratë janë të përfshira aktivisht në çdo fazë të zinxhirit të vlerës, që nga furnizimi me inpute, deri tek aksesi në treg. Roli i tyre në përpunimin ushqimor tradicional krijon mundësi për zgjerim, sidomos përmes produkteve me vlerë të shtuar, brandit dhe komercializimit. | Gratë japin kontribut të rëndësishëm në kujdesin për kafshët, ushqyerjen e tyre, pastrimin e stallave, dhe mjelje. Përfshirja e tyre më këto veprimtari të rëndësishme krijon mundësi për rritje të biznesit, sidomos përmes përpunimit të qumështit në produkte bulmeti me vlerë të shtuar, si djathi dhe kosi. |
| A kanë (ose a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për shtimin e vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | Nevojiten më shumë njohuri, sidomos për zbatimin e standardeve, certifikim, dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha fazat. | Gratë punojnë mbi bazën e traditës. Nevojitet më shumë teknologji dhe siguri ushqimore, si dhe më shumë aftësi biznesi dhe tregu. | Gratë kanë aftësi blegtorale bazë por duhet të trajnohen më tej në praktikat më të mira, si praktikat e mira blegtorale, standardet e higjienës, dhe përpunimin në shkallë të vogël, për të shtuar mundësitë ekonomike të tyre. |

| Kriteret | | Sektori agroushqimor | Qumështi |
|---|---|---|---|
| A ofron ky zinxhir i vlerës mundësi të reja për gratë? | Po. Në qoftë se ka bashkëpunim dhe angazhim në kultivim dhe tharje. | Po. Sidomos në se gratë orientohen drejt krijimit të grupeve për të bashkëpunuar me njëra tjetrën. | Po. Përmes pajisjes së grave me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin e praktikave më të mira, sidomos në blegtori. |
| A mund t'i përmirësojë zinxhiri i vlerës kushtet e jetesës për gratë/familjet e tyre? | Aktualisht, veprimtaritë që lidhen me BMA-të përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Kalimi nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim mund të shtojë potencialin për fitim të ardhurash, do ët përmirësojë kushtet e punës dhe do të forcojë qëndrueshmërinë e sektorit. | Po. Këto punë mund të kryhen nga shtëpia dhe gratë mund të shtojnë të ardhurat e familjeve të tyre. Megjithatë, nevojiten investime të vogla në vendin e punës për të shtuar produktivitetin. | Po. Qumështi, sidomos ai i ripërtypësve të vegjël, është produkt mjaft i kërkuar nga baxhot e zonës dhe mund të gjenerojë të ardhura të konsiderueshme. Zinxhiri i vlerës ofron mundësi tranzicioni drejt përpunimit të vogël të produkteve të qumështit për shtimin e të ardhurave. |
| A ka një organizatë të motivuar në zinxhirin e vlerës që mund të mbështesë/ përfaqësojë pjesëmarrësit në zinxhirin e vlerës, e cila mund të çojë përpara zhvillimin? | Ka konsolidues në zonë që janë të interesuar të mbështesin këtë ZV. | Po. Projekte ekzistuese që po përpiqen të mbështesin këtë ZV, si dhe OSHC lokale si ALCDF, Dibra Turistike, Agritra Vision, CNVP Dibër, që mund ta ndërmarrin këtë rol. Përveç këtyre, grupi i grave në Maqellarë po ndihmon gra të tjera ose krijimin e grupeve satelite, me njohur dhe aftësi. | Po. Baxhoja "Bjeshkët e Runjës" në zonë është shumë e motivuar dhe e interesuar për të mbështetur aktorët në ZV. Krahas kësaj, grupimi i grave blegtore të zonës mund të forcojë më tej rolin e tyre. |
| A ka mundësi të bëhen ndryshime me investime të vogla? | Po, përmes mbështetjes së prodhuesve me materiale dhe pajisje, ofrimit të seancave të trajnimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve dhe promovimit të tyre. | Po. Përmes mbështetjes së krijimit të grupeve të reja me pajisje bazë dhe zhvillimit të mëtejshëm të grupeve ekzistuese, për paketim dhe krijimin e brandit, për akses në tregje të reja. | Po. Investime të vogla për pajisje, vegla të nevojshme për mjelje dhe bidonë të standardizuar për mjelje dhe transportim, ose pajisje të vogla për prodhimin e vogël të nënprodukteve të qumështit. |

**Tabela 2.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Një pjesë e konsiderueshme (rreth 70%) e personave të angazhuar në zinxhirin e vlerës të BMA-ve janë gra. Kjo u konfirmua në intervistat me gratë dhe konsoliduesit lokalë. |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 2 | 2 | 4 | Vetëm sipërmarrëse të vogla. Gratë marrin pjesë kryesisht në mbledhjen e bimëve të egra dhe më pak me kultivim, përpunim pas vjeljes dhe shitje tek konsoliduesit lokalë. Vetëm një numër i vogël i grave merren me paketim në shkallë të vogël dhe me shitje të drejtpërdrejta. |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Pronësia mbi tokën mbetet problem që kufizon kontrollin mbi asetet. Pajisjet dhe veglat janë nën kontroll të përbashkët. |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 4 | 1 | 4 | I lartë. Gratë mund të shtojnë aftësitë e tyre jo vetëm në lidhje me punët pas vjeljes, duke shtuar vlerë përmes paketimit dhe etiketimit për tregun përfundimtar, por edhe duke filluar zbatimin e praktikave më të mira në kultivim. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Gjatë intervistave me gratë, disa prej tyre theksuan se i menaxhojnë të ardhurat vetë, ndërsa të tjerat i menaxhojnë bashkërisht me kryefamiljarin (burrë). |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 3 | 1 | 3 | Po, duke kaluar nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 4 | 1 | 4 | I lartë. Kultivimi në parcela të vogla, me përdorim të pajisjeve të teknologjisë së ulët për aktivitetet pas vjeljes (tharja, prerja, paketimi) ndihmon hyrjen e tyre në treg me investime minimale. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 3 | 2 | 6 | Po. Gratë edhe tani janë të përfshira në mbledhjen e bimëve të egra, tharje, dhe përpunim fillestar të bimëve, me metoda primitive. Megjithatë mungesa e pajisjeve dhe e informacionit për tregun mbetet barrierë. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 2 | 4 | 8 | Mesatar, përveç në rastin kur gratë synojnë tregun përfundimtar (lokal). |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 4 | 2 | 8 | I lartë. Përmes kalimit në kultivim, futjes së bimëve të përhershme me një vjelje në vit, për uljen e kostove të mbjelljes dhe të forcës së punës, si dhe zbatimit të praktikave të mira bujqësore. |
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 4 | 1 | 4 | I lartë. Njësoj si më lart. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 3 | 2 | 6 | Të vetmet pengesa që u identifikuan gjatë intervistave dhe takimeve me gratë rezultuan të ishin mungesa e njohurive dhe aftësive, mungesa e pajisjeve, dhe mungesa e informacionit për kërkesat dhe standardet e tregut. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 61/102 | |

* Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).

** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara[9]

9. Trajtimi me përparësi i zinxhirëve të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

**Tabela 3.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e produkteve të qumështit/bulmetit

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Po. Gjatë takimeve dhe intervistave në terren u theksua se gratë janë gjithmonë të përfshira në veprimtari që lidhen me blegtorinë. |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 2 | 2 | 4 | Të paktën 20 gra në Muhurr merren me rritjen e bagëtive të imta për prodhim qumështi. I njëjti numër merret edhe me rritjen e lopëve për qumësht. |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Duke pasur parasysh se në shumicën e rasteve pronarë të fermave janë burrat, gratë nuk kanë të drejta pronësore. Megjithatë, ato kanë kontroll mbi pajisjet që përdoren në fazat ku janë të përfshira. |
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 3 | 1 | 3 | Gratë zotërojnë aftësitë bazë në praktikat bujqësore, por me trajnim të nevojshëm ato mund t'i zhvillojnë më tej aftësitë drejt praktikave të mira blegtorale. Përveç qumështit si produkt primar, mund të promovohet edhe përpunimi i vogël dhe diversifikimi i produkteve, duke pasur parasysh kërkesën e madhe për nënprodukte të qumështit. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Kontrolli i të ardhurave varion mes menaxhimit të pavarur dhe vendimmarrjes së përbashkët. |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 3 | 1 | 3 | Ndonjëherë tufat e ripërtypësve të vegjël janë larg shtëpisë. Ka edhe familje me tufa më të vogla, që i mbajnë ato afër shtëpisë. Përpunimi i qumështit bëhet kryesisht afër shtëpisë. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 2 | 1 | 2 | Krijimi i një tufe nga fillimi ka kosto shumë të lartë për sipërmarrësit e varfër. Për shembull, një dele/dhi kushton midis 15.000 deri 25.000 lekë. Fillimi i një tufe të re është pothuaj e pamundur për familjet e varfra. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 4 | 2 | 8 | Varet nga madhësia e tufës, por ende konsiderohet veprimtari familjare. Aksesi në teknologji është mesatar dhe nuk ka pengesa kulturore/zakonore. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 3 | 4 | 12 | Mesatar. Gratë mund të shtojnë aftësitë e tyre përmes trajnimeve për praktikat e mira blegtorale dhe të shtojnë vlerën përmes diversifikimit të produkteve. |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 4 | 2 | 8 | Po. Blegtoria siguron të ardhura të qëndrueshme gjatë gjithë vitit, sidomos nga prodhimi i qumështit. |
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 4 | 1 | 4 | Po. Futja e praktikave të mira blegtorale për sigurimin e mirëqenies së bagëtive, praktikave të mjeljes dhe teknologjive të reja për të garantuar sigurinë ushqimore dhe për të ulur sasinë e kohës dhe ngarkesën e punës së grave; si dhe mbajtja e dokumentacionit për menaxhim efektiv të tufës. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 4 | 2 | 8 | Jo. Gratë edhe tani merren aktivisht me blegtori dhe prodhimin e qumështit, pa ndonjë pengesë të madhe kulturore/zakonore. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 69/102 | |

* Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).

** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara[10]

10. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës u bë mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

**Tabela 4.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në grupin e zinxhirit të vlerës agroushqimor

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Pjesa më e madhe e forcave të punës (formale dhe informale) janë gra. Në vizitat në terren në vendet e vizituara (Postec, Kërçisht, Staravec) morën pjesë 17 gra dhe vetëm dy burra, që kishin kryesisht rol mbështetës (transport). |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 3 | 2 | 6 | Bizneset janë kryesisht në pronësi të grave, por burrat kontribuojnë në disa prej aktiviteteve në zinxhirin e vlerës. Gratë gjithashtu marrin vendime për çështje financiare. |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 3 | 2 | 6 | Gratë kryejnë aktivitete të shumta dhe kontrollojnë pajisjet. |
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 4 | 1 | 4 | Gratë zotërojnë njohuri dhe aftësi tradicionale, pir duhet të trajnohen në përdorimin e makinerive të reja, diversifikimin e produkteve dhe teknologjinë e re. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 4 | 2 | 8 | Po. Gratë vendosin për çmimin e shitjes së produktit, duke marrë parasysh çmimin e tregut dhe koston e prodhimit. |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 5 | 1 | 5 | Po, shtëpitë dhe vendet e prodhimit janë afër njëra-tjetrës, që e bën të lehtë aksesin. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 4 | 1 | 4 | Fillimi i një biznesi prodhues agroushqimor bazuar në traditë ka barriera të ulëta hyrjeje për gratë, por kjo është vetëm për prodhimin në shkallë të vogël. Fillimi i një biznesi më të orientuar nga tregu kërkon shpenzime fillestare për një objekt me të gjitha kushtet e nevojshme, si dhe makineri, kosto regjistrimi, për paketim dhe etiketim. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 3 | 2 | 6 | Njësoj si më lart. Po kështu, nuk ka kufizime kohore të lidhura me dallimet gjinore, sepse gratë janë të përfshira në pothuaj të gjitha proceset e prodhimit. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 3 | 4 | 12 | Po, duke pasur parasysh se aktiviteti drejtohet nga grua dhe gratë janë të përfshira në të gjitha fazat. |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 4 | 2 | 8 | Po. Produktet agroushqimore (jufka, tërhan, turshi, reçel etj.) janë traditë në Dibër. Grupi i grave të Pocestit e bën ndarjen e të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti mbi bazën e orëve të punës që ka bërë secila grua. Gjatë sezoneve dhe pushimeve të ndryshme (Ramazan, Viti i Ri, stina e dasmave, etj.), të ardhurat mund të arrijnë deri në 2.000 lekë në ditë për secilën prej tyre. |
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 3 | 1 | 3 | Njësoj si më lart. Përpunimi ushqimor është traditë. Zgjerimi i përfshirjes së grave në përpunim dhe shitje mund të përmirësojë eficiencën dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të zinxhirit të vlerës. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 2 | 2 | 4 | Proceset e prodhimit agroushqimor në përgjithësi konsiderohen si aktivitete të grave. Zakonisht kjo transmetohet nga një brez në tjetrin. Ka ende kufizime për sa i përket kontrollit mbi pronën, vendimmarrjen për fillimin e një biznesi, aksesin në financim, etj. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 72/102 | |

* Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).
** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara[11]

11. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës u bë mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

*Zinxhiri i vlerës ofron potencial të konsiderueshëm gjinor, duke qenë se gratë kanë rol qendror në prodhimet agroushqimore. Ka mundësi për rritje dhe fuqizim, sidomos përmes përfshirjes së grave në të gjitha fazat e prodhimit, si edhe në vendimmarrje dhe shitje. Megjithatë, probleme si rolet gjinore tradicionale, aksesi i kufizuar në financim dhe mangësitë në teknologji ende pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë.*
*Grupi i grave në Staravec përballet me një vështirësi të konsiderueshme për shkak të mungesës së një hapësire të përbashkët pune, që pengon mundësinë e bashkëpunimit efektiv, të ndarjes së detyrave dhe zbatimit të standardeve të sigurisë ushqimore. Megjithëse grupi u krijua zyrtarisht si kooperativë në vitin 2014[12] dhe është ndihmuar për krijimin e brandit dhe paketimin, gratë e kanë pasur të vështirë që të ecin me një hap me grupe të tjera në zonë. Mungesa e një hapësire pune posaçërisht për to dhe e pajisjeve të nevojshme i ka penguar që të racionalizojnë proceset e punës dhe t'u përgjigjen kërkesave të tregut. Megjithatë, problemi lidhet kryesisht me mungesën e hapësirave publike të disponueshme dhe faktin që gratë nuk kanë një mjedis të përbashkët në pronësi të tyre.*

*Për ta kapërcyer këtë pengesë nevojiten investime fillestare dhe punë ndërtimore e konsiderueshme për të ngritur një objekt të përshtatshëm për punë. Duke qenë se nevojat e tanishme lidhen me zhvillimin e infrastrukturës dhe jo me ndërtimin e kapaciteteve apo me aksesin në treg, investimi në një mjedis të përshtatshëm pune ka rrjedhoja sa i përket të drejtave pronësore, marrjes së lejeve dhe kostove mjaft të mëdha.*

*Krahas kësaj, projekte të mëparshme (si PLGP i USAID-it, AgroCapital, Brand Albania, projekte të UN Women, etj.), dhe projekte që po zhvillohen aktualisht në Dibër, si GIZ/SRD dhe New Perspectives, po u japin ndihmë të konsiderueshme grupeve të grave të angazhuara në sektorin agroushqimor me trajnime, marketing, dhe akses në pajisje.*
*Këto nisma po trajtojnë disa nga sfidat konkrete me të cilat përballen gratë në sektorin agroushqimor, si përmirësimi i aftësive teknike, rritja e aksesit në treg dhe ofrimi i mbështetjes financiare për pajisje pune. Për këtë arsye, ndërhyrja në këtë fushë konkrete mund të çojë në dublimin e përpjekjeve dhe përsëritjen e nismave ekzistuese.*

Duke marrë parasysh gjithë sa më lart dhe kufizimet në numrin e zinxhirëve të vlerës që mund të përzgjidhen (deri në dy zinxhirë vlere), analiza me ndjeshmëri gjinore në vijim do të fokusohet në ZV-të e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe të qumështit.

12. Gratë u ndihmuan për formalizimin e grupit të tyre ekonomik si shoqëri e bashkëpunimit bujqësor. Në bazë të Ligjit nr. 38, datë 05.04.2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", 20 gra të mbështetura nga ky projekt themeluan shoqërinë e bashkëpunimit bujqësor të quajtur "Prodhime Staraveci". Shih: https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/10/Final-Booklet_English.pdf

Pjesa 2

# Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

# 1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës të BMA-ve

Shqipëria ka një traditë të gjatë në prodhimin dhe eksportin e BMA-ve. Shtytësi kryesor i zhvillimit të sektorit të furnizimit është bollëku i BMA-ve të egra.

Rreth 15% e 3.250 llojeve të bimëve shqiptare kanë vlera si bimë mjekësore, aromatike, si erëza dhe tanina. Ky sektor ka një traditë të gjatë, më se 60 vjeçare. Aktualisht, mbledhja, kultivimi, përpunimi dhe tregtimi i BMA-ve është një biznes i rëndësishëm agropyjor në Shqipëri.[13]

Sipas Agjencisë Shqiptare të zhvillimit të Investimeve (AIDA), mbi 85.000 persona (kryesisht nga zonat rurale) janë të përfshirë në të gjithë zinxhirin e vlerës, që nga mbledhja e bimëve të egra, kultivimi, deri tek eksporti. Rreth 1/5 e familjeve në zonat rurale në rajonet malore janë përfshirë në aktivitete që sjellin të ardhura nga bimët mjekësore dhe aromatike: në mbledhje e kultivim, apo në punë të tjera në zinxhirin e vlerës të BMA-ve.

Afërsisht 400 lloje të BMA-ve janë identifikuar si bimë mjekësore dhe aromatike të florës shqiptare dhe mbi 200 lloje mblidhen dhe eksportohen. Rreth 90% e prodhimit të bimëve mjekësore dhe aromatike eksportohet, që përfaqëson gati 20% të Totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë. Në vitin 2022, prodhimi vendor i BMA-ve ishte 16.430 ton. Gjithashtu, në vitin 2022, eksportet totale të bimëve mjekësore dhe aromatike arritën vlerën 63 milion euro, me një rritje prej 6,7% nga viti i mëparshëm (59 milion euro).[14]
Sipërfaqja e kultivuar me BMA arriti në 7.200 hektarë në vitin 2023,me një prodhim prej 17.800 ton. Kultivimi i BMA-ve është përqendruar në Malësinë e Madhe (5.200 ha), por po përhapet me ritme të shpejta në rajone të tjera të vendit (në Belsh 478 ha, Cërrik 188 ha, Gramsh 135 ha, etj.).[15]

**Kushtet e veçanta klimatike dhe tokësore të zonës së Dibrës kanë ndikuar në krijimin e një shkalle të lartë biodiversiteti, ku BMA-të zënë vend të rëndësishëm në florën e zonës dhe jetesën e 500 familjeve.**

Edhe pse kërkesa për BMA në tregun e brendshëm është e kufizuar, ka një gamë të gjerë BMA-sh me nivel më të ulët përpunimi të cilat shiten në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta dhe në dyqane. Ndër produktet kryesore që shiten në tregjet e brendshme janë çajet bimore dhe erëzat që përdoren për gatim.

Aktualisht, çaji dhe salepi paketohen nga kompani shqiptare dhe shiten në dyqane, përfshirë në supermarkete dhe restorante.

Po kështu në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta shiten edhe barishte dhe erëza të tjera, të paketuara në qese të thjeshta - zakonisht 20-100 gram.[16]

13. Medicinal and Aromatic Plants Sector Study (Studimi i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike). MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf
14. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf
15. INSTAT – Vjetari statistikor i bujqësisë, 2023.
16. MEDICINAL AND AROMATIC PLANTS SECTOR STUDY. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf

## 1.1 SITUATA E ZINXHIRIT TË VLERËS TË BMA-VE NË ZONËN E DIBRËS

Kushtet e veçanta klimatike dhe tokësore të zonës së Dibrës kanë ndikuar në krijimin e një shkalle të lartë biodiversiteti, ku BMA-të zënë vend të rëndësishëm në florën spontane të zonës. Në zonën e Dibrës ka më se 100 lloje BMA-sh, që u përkasin 30 familjeve bimore. Pothuaj 98% rriten në gjendje të egër dhe kohët e fundit rreth 2% po kultivohen. Pjesa më e madhe rritet në lartësi 1.000-1.700 metra, ose edhe 2.000 metra mbi nivelin e detit, që i bën ato mjaft të vlerësuara. Rreth 500 familje në Dibër merren me BMA-të (kryesisht me mbledhjen e bimëve të egra).
Në vitin 1988, në zonën e Dibrës mblidheshin rreth 91 bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të cilat eksportoheshin. Sasia totale e BMA-ve të eksportuara atë vit ishte 5.374 ton, që gjeneroi një vlerë prej 1,124 milion USD.Sot në këtë zonë mblidhen 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike. Nga bimët që mblidhen sot, 16 janë të klasifikuara në një prej kategorive të gjendjes së rrezikuar nga Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (UNKN).[17]

Konkretisht:

- Në rrezik kritik (CR): me status të rrezikut të zhdukjes janë tri bimë: vërri i zi, mështekna dhe bliri.
- të rrezikuara (EN): me status të rrezikuar janë pesë bimë: alkemila molis (alchemilla mollis), sanzi (gentiana lutea), lule borziloku, arra dhe rigoni (çaji i malit).
- të cenueshme (VU): me status të cenueshëm janë shtatë bimë: dëllinja e zezë, dëllinja e kuqe, tisi, sherbela, shtogu, trumza, boronica (aronia).
- pothuaj të rrezikuar (NT): Nuk ka BMA që mblidhen sot në zonë me këtë status.
- Më pak shqetësuese (LC) ose me rrezik më të vogël (LR): këtu përfshihet një specie: rrushi i arushës.

**Tabela 5.** Listë e bimëve të egra që mblidhen në zonën e Dibrës

| Nr. | Emri latin | Emri në gjuhën shqipe | Statusi i kërcënimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Juniperus communis | Dëllinjë e zezë | VU Alb |
| 2 | Juniperus oxycedrus | Dëllinjë e kuqe | VU A1b |
| 3 | Achillea millefolium | Njëmijëfletësh | |
| 4 | Althaea officinalis | Mëllaga e bardhë | |
| 5 | Alchemilla catachnoa | Alkemilë kataknoe | EN A1b |
| 6 | Arctium lappa | Rrodhe | |
| 7 | Anthyllis montana | Antilidë e malit | |
| 8 | Arctostaphylos uva-ursi | Rrushi i arushës | LR cd |
| 9 | Artemisia absinthium - | Bar pelini | |

17. Informacion nga intervista me Prof. Dr. Alban Ibraliu, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

| Nr. | Emri latin | Emri në gjuhën shqipe | Statusi i kërcënimit |
|---|---|---|---|
| 10 | Bellis perennis | Luleshqerra | |
| 11 | Betula pendula | Mështekna | CR B2e |
| 12 | Castanea sativa | Gështenja | |
| 13 | Carlina vulgaris | Ushonjëz e rëndomtë | |
| 14 | Centaurea cyanus | Kokoçeli | |
| 15 | Corylus avellana | Lajthia | |
| 16 | Crataegus monogyna | Murrizi njëbërthamëz | |
| 17 | Crataegus oxyacantha | Murrizi dybërthamëz | |
| 18 | Colchicum autumnale | Xhërokull vjeshtor | |
| 19 | Cynodon dactylon | Grami | |
| 20 | Fragaria vesca | Luleshtrydhja | |
| 21 | Fraxinus excelsior | Frashër i zi | CR A1b |
| 22 | Fraxinus ornus | Frashër i bardhë | |
| 23 | Galium verum | Ngjitëse e vërtetë | |
| 24 | Gentiana lutea | Sanzi | EN A1b |
| 25 | Iris sp | Shpatore | VU A2b |
| 26 | Helichrysum arenarium | Lule aku | |
| 27 | Hypericum perforatum | Lule basani | EN A1b |
| 28 | Juglans regia | Arra | EN A1b |
| 29 | Malus sylvestris | Molla e egër | |
| 30 | Melilotus officinalis | Jonxha e egër | |
| 31 | Melissa officinalis | Melisa | |
| 32 | Ononis spinosa | Gjuhë nuse | |
| 33 | Origanum vulgare | Caj Mali | EN A1b |
| 34 | Papaver rhoeas | Lulëkuqja | |
| 35 | Parietaria officinalis | Parietaria | |
| 36 | Phaseolus vulgaris | Fasule | |

| Nr. | Emri latin | Emri në gjuhën shqipe | Statusi i kërcënimit |
|---|---|---|---|
| 37 | Plantago lanceolata | Gjethe delli | |
| 38 | Polygonum aviculare | Barpate | |
| 39 | Primula veris (=P. Officinalis) | Agulicia | |
| 40 | Prunus cerasus (=Cerasus vulgaris) | Qershia | |
| 41 | Prunus spinosa | Kulumbria | |
| 42 | Robinia pseudoacacia | Akacia | |
| 43 | Rosa canina | Trëndafili i egër | |
| 44 | Rubus fruticosus | Ferrëmanëza | |
| 45 | Rubus idaeus | Mjedra | |
| 46 | Salix alba | Shelgu i bardhë | |
| 47 | Salvia officinalis | Sherbela | VU Alb |
| 48 | Salvia sclarea | Shëngjini | |
| 49 | Sambucus ebulus | Qingël | |
| 50 | Sambucus nigra | Shtogu | VU Alb |
| 51 | Saponaria officinalis | Lule sapuni | |
| 52 | Satureja montana | Trumza | VU A1c |
| 53 | Taraxacum officinale | Lule shurdha | |
| 54 | Teucrium chamaedrys | Arrsi dushk | |
| 55 | Thymus serpyllum | Zhumbrica | |
| 56 | Tilia platyphyllos (=T. officinarum) | Bliri | CR Alc |
| 57 | Tilia tomentosa (=T. argentea) | Bliri i argjendtë | |
| 58 | Trifolium pretense | Tërfili i kuq | |
| 59 | Tussilago farfara | Thundërmushka | |
| 60 | Tussilago hybrida (=Syn. P. officinalis) | Llapoi | |
| 61 | Urtica dioca | Hithër | |
| 62 | Vaccinium myrtillus | Qershigla, boronica | VU A2b |
| 63 | Viola odorata | Manushaqe | |

*Rreth 500 familje në zonat rurale merren me mbledhjen spontane të BMA-ve. Një numër i vogël familjesh vazhdojnë kultivimin në shkallë të vogël të kokoçelit në njësinë administrative të Melanit (fshatrat Trepçë dhe Tren). Produktet i dorëzohen konsoliduesit të thara. Probleme kryesore janë përdorimi i thasëve të kontaminuar gjatë mbledhjes dhe transportit, dhe mjediset e tharjes me rrezik të lartë kontaminimi. Konsoliduesi i zonës është i gatshëm të marrë rol aktiv dhe të promovojë kultivimin dhe praktikat e mira pas vjeljes (tharja). Gratë që merren me bimë mjekësore në Trepçë: Grupi përbëhet nga 20 gra që mbledhin bimë të egra si rigoni i kuq, lule bliri, kalendula, lule shtogu, trëndafili i egër, trumza, etj. Ato janë ndihmuar me një makineri të vogël tharëse nga GIZ, përmes ADAD Malore, që është vendosur në shtëpinë e Hajrije Mehmetit. Duke qenë se tharësi është i vogël, ai përdoret kryesisht për mollët e egra, kumbullat, dhe sasi të kufizuara bimësh.*

*Tharja e bimëve bëhet më shumë në mjedise të hapura, ose në shtëpi, mbi çarçafë, me rrezik të lartë kontaminimi dhe me humbje të cilësisë. Disa gra i shesin produktet drejtpërdrejt në tregun vendor ose panaire. Megjithatë, paketimi është shumë primitiv dhe etiketimi pothuaj nuk ekziston. Pjesa më e madhe e produktit i shitet me shumicë konsoliduesit të zonës. Gratë merren edhe me kultivim në shkallë të vogël. Ato shprehin interes për kultivimin e bimëve të përhershme që do të kërkonin më pak kosto dhe punë. Gratë thonë që e kanë të vështirë menaxhimin e bimëve që kultivohen vetëm për lulet e tyre. Familja e Safie Xhaferrit mbledh boronica të egra në mal dhe me to fiton rreth 50,000 deri në 100,000 lekë në vit. Familja mbledh rreth 10 kg boronica në ditë dhe i shet me 500-600 lekë për kg. Kjo konsiston në 12 orë punë për mbledhjen e frutave nga djali i familjes dhe tetë orë punë nga Safia dhe bashkëshorti i saj për pastrimin e produktit nga gjethet.*

**Tabela 6.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të BMA-ve

| Anët e Forta | Dobësitë |
|---|---|
| **Biodiversitet i pasur dhe klimë e favorshme.** Në vend rriten rreth 400 lloje bimësh mjekësore, që përfaqësojnë afërsisht 15% të florës totale, dhe mbi 200 prej tyre mblidhen dhe tregtohen.<br>**Afërsia me tregjet evropiane.**<br>**Kohët e fundit është ngritur në Bulqizë një qendër e re grumbullimi.**<br>**Shembuj të mirë dhe zgjerim i shpejtë** i sipërfaqeve të kultivuara në vend, dhe përvoja të mëparshme kultivimi në zonë.<br>**BMA-të konsiderohen si një prej potencialeve** kryesore të rripërtërithshme për zhvillimin social-ekonomik të zonave rurale.<br>**Gatishmëria e konsoliduesve** për të bashkëpunuar me fermerët e zonës.<br>**Gatishmëria për të kultivuar** bimë të përhershme.<br>**Angazhimi i aktorëve kryesorë** të zinxhirit të vlerës për përmirësimin e cilësisë së produktit.<br>**Përfshirja e grave në mbledhjen spontane** dhe kultivimin e bimëve dhe ndërgjegjësimi në rritje i tyre për kontributin që japin.<br>**Traditë e gjatë e mbledhjes spontane** të BMA-ve dhe përfshirja e grave në to. | **Fermerët kanë njohuri të kufizuara** për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike ( BMA).<br>**Mungesa e burimeve financiare** dhe, rrjedhimisht investime të pamjaftueshme në teknologji dhe përpunim.<br>**Mungesa e mjediseve** për trajtim pas vjeljes (tharje).<br>**Mungesa e certifikimit** për standardet e sigurisë dhe cilësisë.<br>**Mangësi në aftësitë teknike** për kryerjen e të gjitha proceseve (pas vjeljes, tharje, përpunim).<br>**Prani informale** e mbledhësve në treg.<br>**Asimetri në informacionin** për zhvillimet e tregut.<br>**Vendi ku kryhet puna** – punëtorëve shpesh u duhet të shkojnë deri në tri orë larg shtëpisë.<br>**Cenueshmëria klimatike** mund të ndikojë në prodhimin e BMA-ve (sidomos të bimëve të egra).<br>**Largësia e vendeve** ku bëhet vjelja e bimëve (mal) nga qendra e grumbullimit.<br>**Puna e rëndë dhe kushte pune të vështira,** sidomos për gratë.<br>**Mungesa e interesit** të të rinjve për BMA-të. |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| **Shumëllojshmëria e madhe e specieve** të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në zonë tregon potencial për kultivim.<br>**Fokusi në kultivimin e bimëve** të përhershme.<br>**Mundësi e mirë për të sjellë ndryshim** me investime të vogla, përfshirë trajnimet në zbatimin e praktikave të mira bujqësore.<br>**Zhvillimet e reja** dhe përparimi i bërë në proceset e tharjes dhe të trajtimit të BMA-ve.<br>**Kërkesë e lartë për BMA** (në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar).<br>**Përpunim në shkallë të ulët** për konsumatorët përfundimtarë të tregut lokal. | **Speciet bimore të rrezikuara** (mbledhja e bimëve të egra);<br>**Ndikim negativ në biodiversitet** dhe habitatin natyror – vjelja e tepruar e BMA-ve dhe degradimi i mjedisit mund të rrezikojnë jetëgjatësinë e prodhimit të BMA-ve të egra.<br>**Niveli i lartë i migracionit** që ndikon në forcat e punës.<br>**Varësia nga kushtet klimatike:** ndryshimet klimatike përbëjnë kërcënim të konsiderueshëm sidomos sepse ndryshimet e motit mund të ndikojnë në rritjen dhe prodhimin e bimëve.<br>**Luhatjet në tendencat e tregut** (ndërkombëtar). |

# 2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistë. Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë hallkave të prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

**Figura 2.** Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve



## 2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më sipër, zinxhiri i vlerës i BMA-ve në Dibër është i organizuar në këto nivele kyçe:

- Inputet
- Kultivimi
- Mbledhja dhe vjelja e bimëve të egra
- Proceset pas vjeljes (tharja)
- Tregu

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga inputet deri tek shpërndarja në treg.

**Furnizuesit e inputeve** luajnë rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Përmes tyre, fermerët sigurojnë farat, fidanët dhe plehrat dhe ata shpesh shërbejnë si burime të rëndësishme informacioni dhe udhëzimesh teknike.

**Ofruesit e teknologjisë** furnizojnë me veglat dhe pajisjet e domosdoshme për faza të ndryshme të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, përfshirë vjeljen, trajtimin pas vjeljes, ruajtjen/magazinimin, tharjen, përpunimin dhe paketimin. Roli i tyre është kritik për përmirësimin e efikasitetit, ruajtjen e cilësisë së produktit, dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet e tregut.

*Në rrethin e Dibrës nuk ka furnizues të inputeve dhe teknologjisë. Këto kompani/individë gjenden kryesisht në zonat me intensitet më të lartë prodhimi, ose afër fermave bujqësore.*

**Kultivuesit** janë bujq që jetojnë në zona rurale dhe malore dhe kanë filluar të kultivojnë BMA-të në parcelat e tyre. Ata i thajnë dhe ruajnë bimët në shtëpi deri në momentin kur ua shesin konsoliduesve ose përpunuesve të zonës.

*Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike në Dibër është në fazat e para. Sasia e sipërfaqes së kultivuar me BMA është shumë e vogël. Dy vjet më parë, fermerët filluan kultivimin e tërfilit të kuq në rreth 5 ha. Kjo është një bimë e përhershme që fillon prodhimin vitin e dytë pas mbjelljes. Një fshatar në Maqellarë informoi se kultivonte 1 ha me kokoçel dhe një fshatar tjetër në Kastriot tha se kultivonte 0,5 ha me të njëjtën bimë, ndërsa në të gjithë zonën e bashkisë, kultivimi i BMA-ve arrin në rreth 10 ha me 17 ton prodhim. Sipas informacionit, një fshatar ka mbjellë një hektar me shtog, që është ende në fazat e para të kultivimit.*

*Gjatë periudhës së pandemisë, në vitin 2020, një projekt i financuar nga USAID mbështeti rreth 20 gra në NJA Melan për kultivimin e mëllagës. Disa gra që morën pjesë në takimin konsultues në Trepçë, theksuan se lulet e kësaj bime duheshin këputur çdo ditë gjatë kohës së vjeljes, dhe se duhej mbjellë rishtas çdo vit.*

*Produktet çohen në pikën e grumbullimit të zonës pasi kalojnë procesin e tharjes në shtëpitë e fshatarëve (në kushte jo të mira dhe të papërshtatshme).*

**Mbledhësit e bimëve të egra (vjelësit)** janë individë që jetojnë në zona rurale dhe malore që mbledhin bimë të egra mjekësore dhe aromatike nga mjedisi i zonës ku jetojnë. Ata i thajnë dhe ruajnë bimët në shtëpitë e tyre deri në momentin që ua shesin ato konsoliduesve ose përpunuesve në zonën e tyre.

*Në Dibër, në këtë aktivitet janë të angazhuara rreth 500 familje (70% gra). Bimët e mbledhura thahen në shtëpi, në kushte jo të mira (sikurse theksoi konsoliduesi i zonës) dhe çohen në pikën e grumbullimit. Vjelësit paguhen me para në dorë kur dorëzohet produkti.*

**Konsoliduesit vendorë** (150)[18] janë magazina ose kompani që veprojnë në zonë dhe që shërbejnë si ndërmjetës midis vjelësve dhe kultivuesve të bimëve të egra dhe përpunuesve në nivel rajoni. Ata luajnë rol thelbësor në zinxhirin e vlerës duke u dhënë vjelësve informacion për çmimet dhe shërbejnë si elementë rregullues kyç të marrëdhënies midis kultivuesve dhe përpunuesve më të mëdhenj.

18. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf

**Ekziston nevojë urgjente që të operohet me kontrata për garantimin e të ardhurave të qëndrueshme për familjet që merren me biznesin e bimëve mjekësore, të cilat janë nga më të varfrat në vend.**

*Në Dibër ka vetëm një konsolidues kryesor lokal, Zyber Gjoni, megjithatë, në zonë veprojnë edhe tre grumbullues të tjerë më të vegjël (burra). Në vitin 2023, ata mblodhën gjithsej rreth 241 ton produkt të freskët, ose afërsisht 65 ton produkt të tharë. Një grumbullues në Maqellarë mblodhi rreth 20 ton BMA të thara, një tjetër në Melan 10,6 ton, ndërsa i treti, në Peshkopi, 10 ton, ndërsa konsoliduesi në Peshkopi, rreth 25,5 ton BMA të thara. Dëllinja ishte produkti kryesor, me 15 ton produkt të thatë në vitin 2023. Një produkt tjetër i rëndësishëm janë gjethet e thara të mjedrës, me 7,5 ton. Pas tyre vijnë produkte si astralagusi me 6 ton, rrushi i arushës dhe lule shtogu me 4 ton secili. Çmimet shpesh caktohen në biseda me telefon, pa asnjë garanci, dhe pagesat nuk bëhen në kohë. Sipas konsoliduesve të zonës, ekziston nevojë urgjente që të operohet me kontrata për garantimin e të ardhurave të qëndrueshme për familjet që merren me biznesin e bimëve mjekësore, të cilat janë nga më të varfrat në vend.*

**Konsoliduesit rajonalë** (10)[19] janë të vendosur në rrethe të ndryshme të vendit dhe blejnë BMA-të nga konsoliduesit lokalë dhe/ose ambulantë. Këta konsolidues kanë rol kyç në zinxhirin furnizues, duke shërbyer si urë lidhëse midis konsoliduesve vendorë dhe përpunuesve ose eksportuesve të mëdhenj.

*Qendra e grumbullimit në pronësi të Zyber Gjonit shërben edhe për këtë qëllim, duke ia kaluar produktet BMA konsoliduesve të mëdhenj. Ai thotë se tregu është i deformuar dhe se eksportuesit nuk ua shpërndajnë të ardhurat në mënyrë të drejtë dhe të ndershme niveleve më poshtë. Ai shprehet se tregu mund të rregullohet dhe fitimet të maksimizohen vetëm nëse ai formalizohet dhe fillohet puna me kontrata*

**Përpunuesit e vegjël** tregtojnë mesatarisht 150 deri 500 ton BMA në vit. Ata zakonisht kryejnë aktivitete përpunimi dhe paketimi të thjeshtë, me fokus furnizimin e tregut të brendshëm me produkte si çaji i malit dhe erëza të tjera për gatim. Në ndonjë rast, këto kompani arrijnë t'ua shesin produktet e tyre blerësve ndërkombëtarë.

**Përpunuesit e mesëm** kanë kapacitet midis 500 dhe 1.000 ton BMA në vit. Në këto kategori bëjnë pjesë rreth 31 kompani, që kanë krijuar lidhje të rregullta eksporti me blerësi ndërkombëtarë. Këto kompani konkurrojnë me njëra tjetrën për mbledhjen dhe marrjen e BMA-ve nga kultivuesit vendorë.20

**Përpunuesit/Eksportuesit e mëdhenj** (15) përpunojnë mesatarisht 1.000 deri 1.800 ton bimë mjekësore dhe aromatike në vit. Kjo përbën një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të BMA-ve nga Shqipëria. Ata i marrin produktet nga të gjitha nivelet e zinxhirit furnizues, përfshirë nga kultivues të mëdhenj, konsolidues, dhe nga përpunues të vegjël e të mesëm. Këta përpunues/eksportues janë të pajisur me linjat më të avancuara të përpunimit, që u bën të mundur të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe t'u shërbejnë me efektivitet tregjeve botërore.[21]

*Në Dibër nuk ka përpunues ose eksportues. Një aspekt problematik që u theksua lidhet me mospagesat dhe krijimin e një zinxhiri borxhesh të papaguara. Grumbulluesit e mëdhenj nuk mund t'u paguajnë tarifat grumbulluesve të vegjël në rrethe, dhe këta të fundit nuk kanë likuiditet që të paguajnë fshatarët. Z. Gjoni tha se ishte detyruar disa herë të merrte hua për t'i paguar fshatarët.*

19. Po aty.

20. Të dhëna të konsoliduara nga Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-brochure-1.pdf, Studim i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf, dhe Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf

21. Po aty.

## 2.2 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

**Janë katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB)**,[22] me qendër në Shkodër, Lushnjë, Korçë, dhe Tiranë, të cilat operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

**Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)**[23] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

**Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)**[24] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

22. Shih:https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc
23. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/
24. Shih: https://akvmb.gov.al/

- **Shërbimet veterinare:** Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.

- **Mbrojtja e bimëve:** Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.

- **Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat:** Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.

- **Siguria ushqimore dhe inspektimi:** Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.

- **Kontrolli kufitar dhe biosiguria:** Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.

- **Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit:** Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.

- **Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet:** Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;

- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;

- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;

- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;

- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;

- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;

- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**[25] është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien e rreziqeve ndaj interesit publik. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për garantimin e sigurisë dhe cilësisë

25. Shih: https://aku.gov.al/

ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;
- garantimin e respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;
- kryerjen e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;
- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;
- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;
- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;
- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

**Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)**,[26] me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai financohet nga buxheti i shtetit dhe ka si objekt të punës së tij zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Misioni i ESHFF-së përfshin:

- mbrojtjen e interesave të fermerëve;
- shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- prezantimin e varieteteve të reja në treg;
- përmirësimin e treguesve të cilësisë të materialit mbjellës që tregtohet;
- sigurimi i një konkurrence të ndershme në treg.

Institucioni monitoron rrjetin zonal për prova krahasuese për testimin e varieteteve të reja të prodhuara në vend ose të importuara, për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të këtyre provave krahasuese dhe metodave laboratorike, ESHFF-ja bën vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar.

*Sektori i bujqësisë në Bashkinë Dibër (i përbërë nga dhjetë burra dhe tre gra) përqendrohet kryesisht në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, por jo edhe aq shumë në mbështetjen e fermerëve përmes shërbimeve të ekstensionit, që janë thelbësore për përmirësimin e praktikave bujqësore dhe rritjen e produktivitetit.*[27]

**Certifikimi** Standardet bazë janë Analiza e Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP) dhe Certifikimi Organik.

HACCP[28] është një standard ndërkombëtar që bazohet në parimet e *FAO/WHO Codex Alimentarius Commission* (Komisioni *Codex Alimentarius* i FAO-s dhe OBSH-së), dhe përfshin një grup të plotë parimesh mbi higjienën dhe sigurinë ushqimore. Ai është një sistem parandalues për menaxhimin e sigurisë ushqimore, që është i detyrueshëm për të gjitha bizneset ushqimore, në përputhje me Rregulloret Evropiane (EC) 178/2002[29] dhe 852/2004[30], si dhe me Udhëzimin Kombëtar nr. 20 20, datë 25.11.2010, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.[31] Procesi i certifikimit HACCP zakonisht zgjat nga 14 deri 30 ditë, në varësi të kërkesave konkrete të biznesit përkatës, dhe përfshin:

- **Vizitë tek biznesi:** Biznesi vizitohet nga një kompani konsulente e specializuar në vlerësimin e proceseve të punës dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime dhe përshtatje

26. Shih: http://www.eshff.gov.al/
27. Konstatime nga takimet dhe intervistat me përfaqësues të bashkisë
28. Shih: https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Udhezim_Nr.20.pdf
29. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002R0178
30. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004R0852
31. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb144203.pdf

me qëllim plotësimin e standardeve të HACCP-it.

- **Përgatitja e dokumentacionit:** Biznesi duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen evidenca, procedura dhe plane që lidhen me sigurinë dhe higjienën ushqimore.

- **Krijimi i sistemeve për mbajtjen e dokumentacionit:** Duhet të ngrihet një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave, për të garantuar që procedurat e sigurisë ushqimore të jenë të dokumentuara siç duhet dhe të gjurmueshme.

- **Inspektimi nga organi certifikues:** Organi certifikues inspekton biznesin për të siguruar plotësimin e të gjitha kritereve HACCP dhe kontrollon si dokumentacionin, ashtu edhe praktikat e ndjekura.

- **Lëshimi i certifikatës:** Pas inspektimit të suksesshëm, trupa certifikuese lëshon certifikatën HACCP, që konfirmon se biznesi përmbush standardet e sigurisë ushqimore.

**Certifikimi organik** është një proces i gjatë, por me vlerë, sepse jep akses në tregjet globale dhe u mundëson bizneseve t'i marketojnë produktet e tyre si organike, me çmime më të larta dhe kërkesë më të madhe. Ky është një proces që siguron që produktet të prodhohen sipas standardeve specifike të bujqësisë organike, që fokusohet në qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit, dhe përjashtimin e kimikateve sintetike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht (OMGJ).

Certifikimi kërkohet për bizneset që dëshirojnë t'i reklamojnë dhe shesin produktet e tyre si 'organike', sidomos në tregjet ndërkombëtare. Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar kohët e fundit Ligjin nr. 104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre".[32]

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave për prodhimin organik, certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim.
Ai gjithashtu përcakton rregullat për kontrollin zyrtar, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare. Fazat kyçe për certifikimin organik janë:

- **Aplikimi fillestar:** Biznesi dorëzon aplikimin në organin e akreditуar të certifikimit organik.

- **Inspektimi i fermës ose operatorit:** Kryhet një inspektim në terren nga trupa certifikuese për të siguruar respektimin e standardeve të bujqësisë organike dhe të përpunimit organik. Ky inspektim përfshin kontrollin e dokumenteve, metodave të prodhimit dhe praktikave mjedisore.

- **Mbajtja e dokumentacionit dhe e të dhënave:** Bizneset duhet të mbajnë dokumentacion të hollësishëm të praktikave të tyre bujqësore (plehrat, pesticidet, etj.) rotacionin e kulturave bujqësore, menaxhimin e tokës dhe praktika të tjera përkatëse. Ky dokumentacion ndihmon garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë.

- **Rishikimi i praktikave dhe procedurave:** Trupa certifikuese shqyrton praktikat e biznesit dhe i krahason ato me standardet organike. Kjo përfshin garantimin e mospërdorimit të substancave të ndaluara (si kimikate sintetike apo OMGJ) dhe që metodat e prodhimit mbështesin ruajtjen afatgjatë të një mjedisi të shëndetshëm.

- **Vendimi i certifikimit: Pas inspektimit dhe shqyrtimit, trupa certifikuese merr një vendim.** Në qoftë se biznesi konstatohet se i përmbush standardet organike, ai merr certifikatën organike.

- **Inspektime në vijimësi:** Certifikimi organik kërkon inspektime dhe auditime të përvitshme për vazhdimin e certifikimit. Bizneset duhet të vazhdojnë t'u përmbahen standardeve dhe çdo ndryshim në praktika duhet të dokumentohet dhe miratohet.

- **Procesi i certifikimit zakonisht zgjat 2-3 vjet,** sepse bizneset duhet të tregojnë se u janë përmbajtur praktikave organike për të paktën atë periudhë. Gjatë kësaj kohe, bizneseve u jepet statusi i ndërmjetëm "në proces certifikimi organik."

32. Ky ligj është pjesërisht i harmonizuar me Rregulloren e BE-së nr. 2018/848 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 30 maj 2018, mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, që shfuqizoi Rregulloren nr. 834/2007 të Këshillit. Për më shumë shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ligj-nr.-104-dt.-19.9.2024-prodhimi-organik.docx

## 2.3 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet, dhe intervistat e kryera me aktorë kyç në zinxhirin e vlerës, ndër të cilët prodhues dhe përpunues, si dhe specialistë të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, u identifikuan të dhënat e mëposhtme:

### Mundësitë:

- Rritja e kërkesës për BMA-të në të gjithë vendin. Ka pasur një rritje të ndjeshme të kërkesës për BMA në rajon dhe në të gjithë vendin, e nxitur nga kërkesa në treg. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt edhe me shumëllojshmërinë e madhe të produkteve të disponueshme, si edhe me periudhën pas Kovid-19 dhe me kërkesën në rritje nga tregjet ndërkombëtare.

- Kultivimi i BMA-ve duket se është një mundësi e mirë për t'i angazhuar fermerët, bazuar në progresin e nismave në vend deri tani. Aktualisht në Dibër kultivohen me BMA rreth 10 hektarë. Analiza të kryera më parë kanë treguar që zona ka të gjitha kushtet agroteknike të nevojshme për kultivimin e disa bimëve. Gratë theksuan se bimët e përhershme me një vjelje sezonale në vit janë më të përshtatshme për kushtet e tyre. Kultivimi mbi bazën e praktikave më të mira bujqësore shton sasinë e prodhimit dhe në të njëjtën kohë siguron cilësinë në përputhje me kërkesat e tregut ndërkombëtar.[33]

  - Përmes angazhimit në kultivim, gratë do të rrisin të ardhurat dhe do të përmirësojnë kushtet e punës. Kjo kërkon investime, duke filluar që nga farat/fidanët dhe trajnimet për praktikat e mira bujqësore.

- Plotësimi i kërkesave të standardeve dhe marrja e certifikatave të cilësisë do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit dhe rritjen e vlerës së produkteve, gjë që do të çojë në rritjen e kërkesës për produkte të BMA-ve, rritjen e çmimeve të shitjes dhe shtimin e të ardhurave për njësi.

  - Nevojiten më shumë njohuri, sidomos për zbatimin e standardeve, certifikimin dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha fazat e kultivimit.
  - Vëmendje i duhet kushtuar fazave të tharjes dhe të përpunimit fillestar, ku, sipas konsoliduesve të zonës, rreziku i kontaminimit dhe i humbjeve në cilësi është më i lartë.

- Organizimi i fermerëve, sidomos i grave, në grupe, ul kostot për sigurimin e inputeve, përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe kostot e tregut; unifikon dhe garanton cilësinë e produktit; mundëson rritjen e kapaciteteve të aktorëve në të gjithë hallkat e zinxhirit të vlerës dhe rrit rolin e tyre në zinxhirin e vlerës.[34]

- Mundësi për zgjerimin e përpunimit të vogël të BMA-ve për përdoruesit përfundimtarë në treg.

- Mundësi për zbatimin e praktikave të mira bujqësore në kultivimin e BMA-ve:
  - Përmirësimi i kushteve të punës të grave të angazhuara në ZV të BMA-ve.
  - Të gjitha punëtoret duhet të trajnohen, sidomos në lidhje me menaxhimin e kimikateve bujqësore/plehrave, higjienën dhe ndihmën e shpejtë.
  - Pajisje mbrojtëse personale, mbi të gjitha gjatë përdorimit të kimikateve bujqësore.
  - PMB në kultivim (historia e parcelës; inspektimi; analiza e dheut; rreziku i kontaminimit; përgatitja e fushës' fara/fidanë të certifikuar' mbjellja dhe transplantimi; plehrat organike dhe kimike; ujitja; kujdesi për bimët dhe mbrojtja e bimëve; proceset e vjeljes dhe pasvjeljes (përpunimi fillestar dhe tharja); paketimi; magazinimi dhe transporti; etj.)

### Kufizimet:

Sa u përket kufizimeve që hasen në zinxhirin e vlerës të bma-ve, ato mund të përmblidhen si më poshtë:

- Shumica e aktiviteteve janë informale, që do të thotë se punëtorët dhe prodhuesit (sidomos gratë) shpesh nuk janë të regjistruar në zyrat

33. Shih: https://tetratechintdev.exposure.co/womens-economic-empowerment-in-albania

34. *Development in Practice* (Zhvillimi në Praktikë) E. Oughton, 2020. Shih: https://www.academia.edu/86746380/Significance_of_farming_groups_for_resource_access_and_livelihood_improvement_of_rural_smallholder_women_farmers

ose organet tatimore. Si rezultat, ato humbin të drejtën të përfitojnë nga skemat e subvencioneve, të sigurimeve shëndetësore, pensioneve dhe nga programe dhe projekte të ndryshme.

- Vendet ku kryhen proceset e mbledhjes spontane të bimëve shpesh janë larg qendrave të banuara dhe, sidomos gjatë stinës së vjeljeve, përveç punës për mbledhjen e bimëve, gratë duhet të punojnë deri vonë për të pastruar produktin dhe për ta shtruar për tharje.

- Gjendja ekonomike e familjeve. Shpesh përfshirja në këtë aktivitet është burimi kryesor i të ardhurave për pjesën më të madhe të familjeve. Për shkak të informalitetit, banorët janë të përjashtuar edhe nga skemat e subvencioneve dhe mundësitë financiare.

- Nivel i ulët i proceseve të pasvjeljes, përfshirë mjedise të papërshtatshme dhe kapacitete të pamjaftueshme të fermerëve.

- Cilësia e ulët e produktit, që çon në çmime të ulëta të shitjes. Mungesa e aftësive profesionale dhe e certifikimit të cilësisë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e prodhimeve. Ka raste kur produkti i vjelë/kultivuar humbet cilësinë gjatë procesit të tharjes ose për shkak të paketimit të papërshtatshëm për ruajtje dhe transport.

- Mungesë e të rinjve dhe të rejave të interesuar në bujqësi që, së bashku me shkallën e lartë të migracionit, kufizon numrin e forcave të punës.

Më poshtë paraqiten problemet kryesore të identifikuara në kultivimin e BMA-ve në Dibër. Më konkretisht, problemet (kufizimet) lidhen me:

- Fazën e garantimit të inputeve:
  - Certifikimi 'organik' dhe i fidanëve
  - Analiza e tokës – e certifikuar
  - Pronësia e tokës – aksesi në financim/ regjistrim (ndihmë tjetër)

- Fazën e kultivimit:
  - Aftësitë e kultivimit dhe vjeljes, sidomos për bimët tradicionale (si, kur, pse, çfarë)
  - Mjete dhe pajisje pune të përshtatshme për gratë
  - Mungesa e ofruesve të shërbimeve për zbatimin e praktikave të mira bujqësore
  - Infrastruktura (pajisjet) dhe kualifikimet për procesin pas vjeljes në fermat e vogla

- Fazën e pasvjeljes dhe të tharjes:
  - Mungesë e kontrollit të cilësisë
  - Mungesë e mjediseve të përshtatshme dhe pajisje të pamjaftueshme për proceset pas vjeljes dhe përpunim në fermat e vogla
  - Mungesë paketimi cilësor
  - Njohuri të kufizuara për proceset e mësipërme

- Fazën e tregtimit:
  - Mungesë e brandit, etiketimit dhe paketimit sipas kërkesave ligjore (përpunim në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë në treg, me fokus grupin e grave të Reçit)
  - Kapacitete të përshtatshme për ruajtjen e produktit final
  - Lidhjet në treg
  - Njohuri për zhvillimet në treg dhe kërkesat e tregut
  - Promovimi

**Në lidhje me çështjet e pabarazisë gjinore dhe të përfshirjes së grave** në zinxhirin e vlerës, informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat tregon se gratë janë të përfshira në pjesën më të madhe të aktiviteteve të punës, sidomos në proceset e vjeljes dhe të tharjes, ndërkohë që kontribuojnë edhe në punët e shtëpisë. Kjo do të thotë se gratë që merren me mbledhjen e bimëve të egra larg nga shtëpia dhe/ose angazhohen edhe në punët e fazave të pasvjeljes deri në orët e vona, kanë ngarkesë pune të dyfishtë. Ekzistojnë mundësi për kultivimin e bimëve më afër shtëpisë, që mund të çojë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së produktit, t'u sigurojë grave më shumë kontroll mbi burimet, dhe të krijojë mundësi për kultivimin e bimëve me vlerë të lartë dhe për të cilat ka shumë kërkesa në treg. Gratë që merren me kultivimin, vjeljen dhe tharjen e bimëve ndikojnë drejtpërdrejt në zinxhirin e vlerës, duke i bërë konsoliduesit të varur nga aftësitë e tyre për sigurimin e cilësisë së produktit. Gratë rrallë përfshihen në proceset e vendimmarrjes, ku burrat (sidomos konsoliduesit të cilëve gratë u shesin produktet e tyre) janë autoritetet vendimmarrëse në lidhje me çmimet, proceset e menaxhimit të biznesit, mundësitë e financimit, etj.

**Në lidhje me mundësitë e financimit,** ky lloj aktiviteti është i vetmi burim për fitimin e të ardhurave për shumë familje. Zakonisht fitimet merren pasi sasia e mbledhur është çuar në qendrën e grumbullimit. Aktualisht, duke qenë se zinxhiri i vlerës bazohet vetëm në mbledhjen spontane të bimëve, mundësitë e financimit janë shumë të ulëta, për të mos thënë inekzistente.

## 2.4 NDËRHYRJE TË REKOMANDUARA PËR ZINXHIRIN E VLERËS TË BMA-VE NË DIBËR

Në vijim jepen disa rekomandime të përgjithshme për zhvillimin e zinxhirit të vlerës së BMA-ve në Bashkinë Dibër, kategorizuar sipas impaktit:

### 1. Mbështetje e kultivimit:

- **Forcimi i praktikave të mira bujqësore (PMB):** është shumë e rëndësishme të përmirësohen praktikat e kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike duke u fokusuar në praktikat e mira bujqësore. Këtu përfshihet trajnimi për aspekte si analiza e tokës, vlerësimi i rrezikut të kontaminimit, përgatitja e arave, përdorimi i farave dhe fidanëve të certifikuar, mbjellja, transplantimi, plehërimi, ujitja, mirëmbajtja dhe mbrojtja e bimëve. Përveç kësaj, praktikat e vjeljes efikase, trajtimit pas vjeljes, tharjes, ruajtjes, dhe transportimit duhet të forcohen për të ruajtur cilësinë dhe vlerën e tregut të produkteve. Këtu duhet të përfshihen edhe trajnime të specializuara për agrokimikate, menaxhim të plehrave, higjienën dhe ndihmën e parë, për përmirësimin e këtyre praktikave në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

### 2. Asistenca teknike:

- **Analiza e tokës dhe material shumëzues i certifikuar:** Ndihma për kryerjen e analizave të tokës është thelbësore për të siguruar kushte optimale për kultivimin e BMA-ve. Po kështu edhe mbështetja në zgjedhjen e bimëve për kultivim bazuar në kërkesat agroteknike të zonës, kërkesat në treg, dhe kushtet dhe nevojat e grave. Sigurimi i aksesit në material shumëzues të certifikuar (fara dhe fidanë) dhe mbështetja për replikimin e fidanëve në fermë do të shtojë mundësitë e zgjerimit të aktivitetit dhe të sigurojë furnizim të qëndrueshëm afatgjatë, për garantimin e suksesit dhe zgjerimit të kultivimit të BMA-ve.

- **Grante të vogla për përmirësime në proceset e vjeljes dhe pasvjeljes:** Duhet të sigurohen grante të vogla për të përmirësuar praktikat e vjeljes dhe të pasvjeljes në ferma. Këtu mund të përfshihen grante për pajisje si thasë për ruajtje dhe transport, pajisje tharëse që nuk dëmtojnë mjedisin, si edhe pajisje të vogla për përpunim dhe paketim për tregun lokal. Këto investime do të ndihmojnë ruajtjen e cilësisë së produkteve nga vjelja deri në treg dhe duhet të zbatohen në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Mjete pune personale dhe mbrojtëse:** Sigurimi i mjeteve mbrojtëse personale për punëtorët, sidomos për përdorimin e agrokimikateve, është me rëndësi thelbësore për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e personave të përfshirë në kultivimin e BMA-ve. Kjo mbështetje duhet të jetë e vazhdueshme, në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

### 3. Certifikimi i cilësisë dhe standardet e sigurisë:

- **Vetëdijesimi për certifikimin:** është e rëndësishme që prodhuesit të ndërgjegjësohen për vlerën e certifikimeve dhe se si ndihmojnë ato për të pasur akses në treg. Procesi i marrjes së certifikatave, si për shembull i certifikatave të produkteve organike, duhet të shpjegohen qartë për të siguruar që prodhuesit i kuptojnë hapat që duhet të bëjnë. Ky proces ndërgjegjësimit duhet të kryhet në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe të vazhdojë të kryhet sipas kërkesave të tregut.

- **Mbështetja për marrjen e certifikimit organik:** Prodhuesit duhet të ndihmohen për marrjen e certifikimit organik, duke siguruar që prodhimet e tyre të përmbushin standardet e kërkuara. Kjo ndihmë duhet të fillojë në periudhën afatmesme dhe të vazhdojë në periudhën afatgjatë për t'i ndihmuar prodhuesit e BMA-ve të mbeten konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

- **Këshillimi dhe mentorimi:** Ofrimi i këshillimit dhe mentorimit për prodhuesit në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë do të mbështesë rritjen e biznesit të tyre dhe do t'i ndihmojë që të orientohen më mirë nëpër problematikat e zinxhirit të vlerës të BMA-ve. Kjo do të sigurojë që ata të përmirësohen vazhdimisht dhe t'u përmbahen kërkesave të tregut.

### 4. Mbështetja për grupet e prodhuesve:

- Organizimi i grave në grupe: Organizimi i grave në grupe është një strategji kyçe për përmirësimin e përfaqësimit dhe rolit të tyre në zinxhirin e vlerës

të BMA-ve. Këto grupe do t'i fuqizojnë gratë që të kenë një zë më të fuqishëm në treg dhe do të jenë të rëndësishme për krijimin e një sektori më të shëndoshë dhe konkurrues. Kjo nismë duhet të ndiqet në periudhën afatmesme dhe të vazhdohet edhe në afat të gjatë.

- Ndërtimi i kapaciteteve të grave fermere: Pajisja e grave fermere me njohuri për planifikimin e biznesit, krijimin e lidhjeve të biznesit, marketing, dhe identifikimi i mundësive të financimit janë thelbësore për fuqizimin e grave që ato të kenë sukses në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Trajnimi në këto fusha duhet të zbatohet në periudhën afatmesme, me mbështetje të vazhdueshme edhe në periudhën afatgjatë.

- Lidhje të qëndrueshme me konsoliduesit: Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme midis grupeve prodhuese dhe konsoliduesve vendorë, rajonalë dhe kombëtarë do të ndihmojë stabilizimin e tregut dhe do të sigurojë që prodhuesit të kenë blerës të sigurt. Marrëveshjet paraprake mund të nxisin prodhimin dhe të garantojnë akses në treg. Këto marrëdhënie duhen ushqyer në periudhën afatmesme dhe të vazhdojnë edhe më tej në periudhën afatgjatë, për të siguruar suksesin në vijimësi të zinxhirit të vlerës të BMA-ve.

- Akses në tregje të reja me fokus konsumatorin përfundimtar në treg: Kjo do t'u mundësojë grave të zgjerojnë rolin e tyre horizontalisht në zinxhirin e vlerës, nga kultivimi në tregun përfundimtar, si edhe të shtojnë të ardhurat e tyre duke shtuar vlerën me aktivitete si përpunime, krijim brandi dhe paketim në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë.

- Këto rekomandime ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse për forcimin e zinxhirit të vlerës të BMA-ve, me fokus mbi ndihmën teknike, certifikimin, fuqizimin e grave dhe përmirësimin e aksesit në treg përmes partneriteteve të forta. Këto veprime do të ndihmojnë krijimin e një zinxhiri vlere më të qëndrueshëm dhe me fitim për prodhuesit e BMA-ve në Dibër.

**Tabela 7.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të BMA-ve

| Nr. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 1 | Mbështetja e kultivimit | | | |
| 1.1 | Forcimi i praktikave të mira bujqësore (PMB) në kultivimin e BMA-ve, duke përmirësuar teknikat e vjeljes dhe trajtimin pas vjeljes, përfshirë tharjen, ruajtjen dhe transportimin në mënyrën e duhur. Fushat kryesore për t'u fokusuar janë:<br>• Menaxhimi i parcelës: historia, inspektimi, analiza e tokës, dhe vlerësimi i rrezikut të kontaminimit.<br>• Mbështetje me përzgjedhjen e bimëve për kultivim, bazuar në kërkesat agroteknike të zonës, kërkesave të tregut dhe kushteve dhe nevojave të grave<br>• Praktikat e kultivimit: Përgatitja e arës, përdorimi i farave/fidanëve, mbjellja, transplantimi, plehërimi, ujitja, kujdesi për bimët, dhe mbrojtja e bimëve.<br>• Vjelja dhe pasvjelja: vjelje, përpunim fillestar, tharje, paketim, ruajtje, transportim efikas për ruajtjen e cilësisë dhe vlerës në treg.<br>• Trajnime, sidomos për menaxhimin e agrokimikateve/plehrave, higjienën dhe ndihmën e parë. | X | X | X |
| 2 | Asistenca teknike | | | |
| 2.1 | • Analiza e tokës/dheut<br>• Parcela demonstrimi për bimë të caktuara<br>• Mbështetje me material shumëzues të certifikuar<br>• Mbështetje me replikimin e fidanëve për të zgjeruar prodhimin dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm për zgjerim të aktivitetit në të ardhmen | X | X | X |

| Nr. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 2.2 | Grante të vogla për përmirësimin e proceseve të vjeljes dhe pasvjeljes në ferma (për pajisje si thasët për ruajtje dhe transport, pajisje tharëse që nuk dëmtojnë mjedisin, përfshirë pajisje të vogla për përpunim dhe paketim për tregun lokal, vënien e brandit, etiketim, dhe paketim) | X | X | X |
| 2.3 | Mjete pune personale dhe mjete mbrojtëse, sidomos për përdorimin e agrokimikateve. | X | X | X |
| 3 | Certifikimi i cilësisë dhe standardet e sigurisë | | | |
| 3.1 | Seanca ndërgjegjësimi për rëndësinë e certifikimit për të pasur akses në tregjet e mëdha dhe hapat e nevojshëm për certifikim. | X | X | X |
| 3.2 | Ofrimi i mbështetjes për prodhuesit që të marrin certifikim organik, duke siguruar përmbushjen e standardeve. | | X | X |
| 3.3 | Këshillimi dhe mentorimi. | X | X | X |
| 4 | Mbështetja për grupet prodhuese | | | |
| 4.1 | Organizimi i grave në grupe për rritjen e përfaqësimit dhe rolit të tyre në zinxhirin e vlerës. | | X | X |
| 4.2 | Ndërtimi i kapaciteteve të grave fermere lidhur me njohuritë bazë për planifikimin e biznesit, marrëdhëniet e biznesit, marketing, mundësitë e financimit, etj. | | X | X |
| 4.3 | Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme midis grupeve prodhuese dhe konsoliduesve lokalë/rajonale dhe/ose kombëtarë për promovimin e prodhimit bazuar në marrëveshje paraprake. | X | X | X |
| 4.4 | Mbështetje në tregje të reja me fokus tregjet e konsumatorëve përfundimtarë | | | |

**Partnerët/bashkëpunimi në nivel vendor: shoqatat kombëtare të BMA-ve;** bashkia, drejtoria e bujqësisë, konsoliduesit vendorë, pikat e shitjes. Këto rekomandime kanë për qëllim të trajtojnë fushat kryesore të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, me fokus rritjen e efikasitetit të prodhimit, garantimin e cilësisë dhe të standardeve të sigurisë, shtimin e aksesit në treg dhe fuqizimin e grave. Me zbatimin e këtyre aktiviteteve, zinxhiri i vlerës mund të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke u sjellë fermerëve (sidomos grave) përfitime në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë dhe duke përmirësuar kontributin e përgjithshëm ekonomik të BMA-ve në ekonomitë e komuniteteve të zonës.

Pjesa 3

# Analizë e Zinxhirit të Vlerës të Bulmetit dhe Produkteve të Qumështit

# 1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës të Bulmetit/Produkteve të Qumështit

Në vitin 2023, në sektorin e blegtorisë në Shqipëri mbizotëronin bagëtitë e qumështit të të gjitha kategorive. Numri total i gjedhëve arriti në 263.385 krerë, ku lopët përbënin shumicën, me 88,24% të të gjitha tufave.

Mbarështimi i dhenve vazhdoi të ishte pjesë e rëndësishme e sektorit, me një total prej 1.206.206 dhensh, nga të cilat 83,43% ishin dele qumështi. Në mënyrë të ngjashme, numri total i dhive ishte 640.242, ku dhitë e qumështit përbënin 79,96% të numrit të përgjithshëm të krerëve. Numri i derrave në vitin 2023 ishte 114.833, me dosat që pjellëse përbënin 9,18% të totalit të tufave. Këto shifra vënë në pah theksin që i vihet në vijimësi prodhimit të bulmetit në sektorin blegtoral të vendit, ku lopët, delet, dhe dhitë rriten kryesisht për qumësht.[35]
Industria e qumështit pësoi rënie të ndjeshme të volumit të qumështit nga të gjitha kategoritë në vitin 2023. Në atë vit u mblodhën gjithsej 101 mijë ton qumësht, që përfaqëson një rënie prej 8% krahasuar me vitin pararendës. Kjo tendencë në rënie ishte e dukshme në qumështin e lopës, ku u prodhuan 80 mijë ton, duke shënuar një rënie prej 7,6%. Po kështu, edhe qumështi i deleve pati një rënie prej 106%, me 13 mijë ton qumësht delesh gjithsej, ndërsa prodhimi i qumështit të dhive ra me 8,2%, duke arritur në 8 mijë ton. Nga sasia e gjithsejtë e qumështit të mbledhur, 13 mijë ton shkuan për konsum të drejtpërdrejtë nga konsumatorët, ndërsa pjesa tjetër për përpunim. Pjesa më e madhe e qumështit të prodhuar për konsum ishte qumësht me yndyrë të plotë (88,2%), ndjekur nga qumështi gjysmë i skremuar (8,1%), qumështi i papërpunuar (3,2%), dhe qumështi i skremuar (0,5%). Në tërësi, u vu re rënie e përgjithshme në grumbullimin e qumështit, që sugjeron ekzistencën e vështirësive potenciale në sektorin e bulmetit. Megjithatë, industria e përpunimit vazhdon të jetë mbizotëruese dhe pjesa më e madhe e qumështit kalon në proces përpunimi para se të shkojë tek konsumatorët.[36]

**Gratë luajnë rol të rëndësishëm në të gjithë zinxhirin e vlerës të blegtorisë, që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja, deri tek transporti në baxho.**

Blegtoria është një sektor shumë i rëndësishëm agroushqimor në Shqipëri – rreth gjysma e fermerëve merren me blegtori, përfshirë edhe sektorin e prodhimit të bulmetit. Produktet e bulmetit përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të shportës së mallrave të konsumit të familjeve shqiptare. Në prodhimin e qumështit mbizotëron në masë shumë të madhe qumështi i lopës (më shumë se katër të pestat e totalit).

Në përgjithësi, produktet e bulmetit shiten në tregun e brendshëm dhe, për këtë arsye, rritja e prodhimit e merr shtysën kryesore nga rritja e kërkesës në treg, ndërsa në bilancin tregtar të bulmetit ka deficit strukturor. Zinxhiri i vlerës i produkteve të qumështit konsiderohet sektor prioritar duke marrë parasysh potencialin e tij për zëvendësimin e importit.[37]

Rritja e bagëtive të imta bëhet në disa mënyra: a) me sistem ekstensiv dhe verim të bagëtive për 6 - 8 muaj (të gjitha zonat); b) sistem gjysmë ekstensiv, me verim 5 deri 6 muaj; c) sistem i kullotjes në kullota të

35. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/media/13520/statistikat-e-blegtoris%C3%AB-2023.pdf
36. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/al/temat/buj%C3%ABsia-dhe-peshkimi/blegtoria/
37. Studim i sektorit të qumështit, AASF, 2019. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/8Milkcover-EN.pdf

përhershme afër fermës; d) kullota natyrore ku mund të shkohet në këmbë dhe bagëtitë të kthehen në fermë në mbrëmje. Megjithatë, aktualisht, prodhimi i qumështit të deleve dhe dhive kryhet pothuaj tërësisht në kuadër të sistemit ekstensiv; po kështu, edhe prodhimi i qumështit për dele, me rreth 58 litra në vit, dhe për dhi, me rreth 112 litra në vit, është i ulët.

Krahasimi i produktivitetit të bagëtive të imta në Shqipëri me atë në shtetet anëtare të BE-së është më i vështirë të bëhet, sepse prodhimet janë shumë të ndryshme edhe në rajone me strukturë prodhimi dhe kushte natyrore të ngjashme, por mund të thuhet pa frikë se të dhënat e disponueshme tregojnë për një sasi prodhimi që varion nga 30% deri në 70% të prodhimit mesatar në rajone të krahasueshme në shtetet anëtare të BE-së.[38]

Eficienca e prodhimit blegtoral ndikohet nga njohuritë e kufizuara të fermerëve për metodat moderne të menaxhimit të fermave. Përmirësimi i njohurive ët fermerëve duhet të fillojë me forcimin e rolit dhe performancës së shërbimeve publike të ekstensionit, motivimin e këshilluesve dhe mbështetjen financiare të këtij shërbimit. Në procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian, vendi po kërkon të rrisë aftësinë konkurruese dhe standardet ushqimore.[39]

## 1.1 SITUATA E ZINXHIRIT TË VLERËS NË PRODUKTEVE TË BULMETIT/ QUMËSHTIT NË ZONËN E DIBRËS

Sektori i bulmetit në bashkinë e Dibrës luan rol të rëndësishëm në ekonominë vendore, duke pasur parasysh traditën e fortë të zonës në blegtori dhe prodhimin e bulmetit. Terreni malor dhe kullotat e pasura krijojnë kushte të favorshme për rritjen e lopëve, deleve dhe dhive, që janë burimi primar i qumështit në Dibër.

Në vitin 2023, sektori i blegtorisë në Dibër – me 8.200 gjedhë (7.710 lopë), 35.200 dhen (29.000 dele qumështi), dhe 12.640 dhi (11.000 dhi qumështi) – ishte fort i fokusuar në prodhimet e bulmetit, së bashku me produktet e tjera si mishi apo produkte të tjera shtazore. Prodhimi total i qumështit arriti në 26.094 ton, ku qumështi i lopës kontribuoi sasinë më të madhe, me 23.147 ton.

Qumështi i deleve dhe i dhive u prodhua në sasi më të vogla, me përkatësisht 1.682 ton dhe 1,265 ton.

Në bashki janë gjashtë baxho për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e bulmetit. Nga këto, dy funksionojnë tërë vitin (në Melan dhe Maqellarë), ndërsa katër kanë funksionim sezonal (në Muhurr, Kastriot, dhe dy në Kala të Dodës).

Ky rrjet i strukturuar i prodhimeve të qumështit luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e fermerëve të zonës, duke siguruar mbledhjen dhe përpunimin e qumështit dhe furnizimin e tregut; megjithatë ka ende probleme si luhatjet sezonale në prodhim dhe kufizimet në furnizimin me qumësht.

38. Raport i studimit të sektorit të qumështit. MBZHR, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf

39. Po aty.

40. Informacioni i mbledhur gjatë vizitave dhe intervistave në terren me fermerët dhe baxhon në Muhurr tregon për një numër më ët madhe bagëtish të imta në zonë.

# Konstatime

**Konstatim I** Blegtoria, sidomos rritja e ripërtypësve të vegjël (dhen dhe dhi) është aktivitet ekonomik kyç në njësinë administrative të Muhurrit, ku rreth 20-25 ferma merren me rritjen e bagëtive të imta ndërsa 20 ferma janë të specializuara në rritjen e gjedhëve, dhe ku mbi 60% e personave të përfshirë në këto veprimtari blegtorale janë gra. Sipas INSTAT-it, në vitin 2023, Muhurri kishte 618 krerë gjedhë, nga të cilët 588 ishin lopë. Përveç tyre, në zonë kishte 620 dhi dhe 830 dhen, duke kontribuar në një sektor blegtoral të diversifikuar.[40] Me gjithë rëndësinë e sektorit, ka disa vështirësi që ndikojnë produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tij.

**Konstatim II** Gratë luajnë rol të rëndësishëm në të gjithë zinxhirin e vlerës të blegtorisë, që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja, deri tek transporti në baxho. Megjithatë, ato nuk kanë kontroll mbi asetet, nuk kanë njohuri për praktikat më të mira dhe nuk kanë akses në vegla dhe pajisje moderne, që ua shton ngarkesën dhe ul efikasitetin e punës së tyre. Mjelja ende bëhet me dorë, ku zakonisht përdoren bidonë plastikë dhe të vjetër, që shkakton rënie të cilësisë së qumështit dhe rrit rrezikun e kontaminimit. Blegtorët kanë njohuri minimale për menaxhimin e fermës dhe shërbimet aktive të ekstensionit – aq të rëndësishme për praktikat e mira blegtorale – janë të kufizuara.

**Konstatim III** Baxhoja "Bjeshkët e Runjës" në Muhurr, përballet me probleme në furnizimin me qumësht, që e kufizon sasinë e djathit të prodhuar aty në një maksimum prej 5 ton. Baxhoja ka prani të fuqishme në treg dhe kërkesa në rritje, por mungesa e lëndës së parë e pengon të zgjerohet. Në përpjekje për të siguruar më shumë furnizim me qumësht, baxhoja ka rritur çmimin me të cilin blen qumështin e dhisë, për t'i nxitur blegtorët të vazhdojnë ta furnizojnë me qumësht. Baxhoja, në pronësi të Lilianës dhe Selmanit, ka treguar mjaft bashkëpunim dhe angazhim për forcimin e zinxhirit të vlerës të bulmetit. Kjo qasje nxitet nga besimi se "sa më shumë qumësht dhe sa më i mirë qumështi, aq më e lartë cilësia e prodhimit." Duke njohur potencialin për zhvillim të mëtejshëm, baxhoja planifikon të zgjerojë aktivitetin me prodhimin e djathit kaçkavall i cili bëhet me qumësht lope, si edhe të vendosë partneritet me më shumë blegtorë të zonës për të shtuar furnizimin me qumësht.

**Tabela 8.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qumështit

| Anët e Forta | Dobësitë |
|---|---|
| **Blegtoria, sidomos ajo e ripërtypësve të vegjël,** është veprimtari e përhapur në NJA Muhurr (20-25 ferma bagëtish të imta dhe 20 ferma gjedhësh). | **Mungesë e burimeve financiare.** Blegtorët e vegjël (me më pak se dhjetë gjedhë ose 100 bagëti të imta) janë të përjashtuar nga skema e mbështetjes për bujqësinë dhe blegtorinë për vitin 2025. |
| **Gratë, që përbëjnë mbi 60% të forcës së punës,** janë të përfshira aktivisht në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës, që nga kujdesi për bagëtitë, mjelja, dhe dorëzimi në baxho. | **Mungesa e një laboratori** analizash në baxho. |
| **Gratë kanë aftësi dhe njohuri** tradicionale për bagëtitë. | **Sistem i papërshtatshëm për monitorimin e qumështit të papërpunuar:** regjistrat e produkteve të fermës dhe të qumështit shpesh janë të paplotë; kontrolli i cilësisë së qumështit të papërpunuar shpesh nuk bëhet me përdorim të sistemit të duhur të kampionëve. |
| **Ekzistenca e shembujve të praktikave të mira** në blegtorinë për qumësht dhe stallave moderne në zonë dhe në vend. | **Njohuri të kufizuara të fermerëve** dhe fermereve për praktikat e mira të blegtorisë për prodhimin e qumështit. |
| **Kushte të favorshme klimatike** dhe tradita në mbarështimin e bagëtive. | **Sisteme të pazhvilluara për mbledhjen e qumështit** të papërpunuar dhe infrastrukturë e dobët për mbledhjen e qumështit në zonat malore. |
| **Numër i konsiderueshëm i racave të ripërtypësve** të vegjël që janë përshtatur mirë me kushtet e zonës. | **Mjelja bëhet kryesisht me dorë** dhe shumica e fermerëve përdorin bidonë plastikë dhe të vjetër, që çon në cilësi të ulët që qumështit dhe rrezik të lartë kontaminimi. |
| **Gatishmëria e baxhos** për të bashkëpunuar me fermerët që prodhojnë qumësht. | **Nivel i ulët i përmbushjes së standardeve shëndetësore** dhe të higjienës së qumështit të papërpunuar. |
| **Angazhimi i aktorëve kyç** të zinxhirit të vlerës për të rritur sasinë dhe përmirësuar cilësinë. | **Nivel i ulët i njohurive të grave fermere** për standardet minimale të qumështit, higjienën në mbledhjen e qumështit, mbarështimin e bagëtive, menaxhimin e jashtëqitjeve të kafshëve dhe të mbetjeve. |
| **Kërkesa e lartë për qumësht** nga baxhot lokale dhe për produkte përfundimtare në treg. | **Numri i madh i fermave të paspecializuara,** me numër shumë të vogël krerësh. |
| **Kërkesa në rritje e tregut** për nënprodukte bulmeti. | **Vështirësia e marrjes së qumështit cilësor** nga fermerët e vegjël (higjiena). |
| | **Shumica e fermave blegtorale nuk përdorin pajisje mjelëse** dhe kazanë ftohës, që përbën rrezik për sigurinë ushqimore. |
| | **Prodhim i ulët qumështi** nga bagëtitë e imta. |
| | **Vëmendje e kufizuar** për mirëqenien e kafshëve. |
| | **Nivel i ulët i shërbimeve** të ekstensionit. |
| | **Niveli i administrimit të zinxhirit të prodhimit** dhe i zbatimit të ligjit është ende i ulët, sidomos për sa i përket gjurmueshmërisë së qumështit. |
| | **Largësia e fermave** të qumështit në zonat e thella (malore) nga baxho. |
| | **Informaliteti i lartë** në zinxhirin e furnizimit me qumësht. |
| | **Luhatje të mëdha sezonale** në prodhimin e qumështit. |
| | **Punë e rëndë dhe kushte pune të vështira,** sidomos për gratë, si për shembull: mjelja bëhet kryesisht me dorë, pastrimi i stallave, ushqimi i kafshëve, menaxhimi i jashtëqitjeve të kafshëve – që të gjitha tejet të lodhshme fizikisht – bëhen me punë krahu. |
| | **Gratë nuk kanë kontroll mbi asetet,** nuk kanë njohuri për praktikat më të mira në mbarështimin e bagëtive, dhe atyre u mungojnë veglat dhe pajisjet për të pakësuar ngarkesën e punës dhe për të shtuar produktivitetin. |
| | **Mungesat në furnizimin me qumësht** kufizojnë prodhimin (deri në 5 ton djathë) të baxhos "Bjeshkët e Runjës" në Muhurr. |
| | **Mungesa e interesit të të rinjve** në blegtori dhe shkalla e lartë e migracionit ndikojnë në numrin e forcave të punës. |

| Mundësitë | Kërcënimet |
|---|---|
| **Ekzistenca e shembujve të praktikave** të mira blegtorale dhe stallave moderne në rajon dhe në vend. | **Luhatjet e mëdha sezonale** në prodhimin e qumështit mund të ndikojnë negativisht në zinxhirin furnizues. |
| **Kuadri ligjor në përgjithësi po përafrohet me acquis-in e BE-së,** i cili përmban edhe dispozita për barazinë gjinore. Kjo ofron mundësi për përfshirjen e konsideratave gjinore në politikat kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë. [41] | **Problemet e pazgjidhura në lidhje me menaxhimin e të drejtave pronësore** mund të ndikojnë investimet në stalla dhe bimë foragjere të përhershme; ato prekin veçanërisht gratë që hasin pengesa ligjore dhe zakonore sa i përket pronësisë dhe kontrollit mbi tokën. |
| **Rritja e sasisë së qumështit** që furnizohet nga fermat blegtorale, sidomos ato të menaxhuara nga gratë, mund të shtojë kapacitetin e përgjithshëm prodhues të baxhove, duke mbështetur njëkohësisht fitimin e të ardhurave nga gratë dhe fuqizimin ekonomik të tyre. | **Ndotja e mjedisit** për shkak të blegtorisë dhe sektorit në përgjithësi. |
| **Mundësi për vijimësi** edhe pas projektit, përmes baxhos lokale. | **Monitorim i pamjaftueshëm** i produkteve mbrojtëse, aditivëve dhe mbetjeve reziduale të antibiotikëve. |
| **Preferenca e përgjithshme** e konsumatorëve për produkte bulmeti të vendit. | **Rritjet e çmimeve të ushqimeve për kafshët** dhe inputeve. |
| **Blegtorët e vegjël,** sidomos gratë, mund të shtojnë produktivitetin përmes zbatimit të praktikave të mira blegtorale, me trajnime të posaçme për kujdesin për kafshët, higjienën e qumështit, standardet mjedisore dhe menaxhimin social-ekonomik të fermës, që do të ndihmojë ngushtimin e hendekut gjinor sa u përket njohurive dhe aksesit në burime. | **Shkalla e lartë e emigracionit** ndikon në forcat e punës dhe shkakton rritje të ngarkesës së punës së grave që qëndrojnë në zonat rurale, sepse ato marrin përsipër përgjegjësi shtesë në punët e fermës. |
| | **Përfaqësimi i ulët i interesave të blegtorëve të vegjël** (sidomos të grave blegtore) nga grupet e prodhuesve dhe grupet e advokacisë në sektorin bujqësor. Gratë janë shumë më pak të përfaqësuara në këto struktura, që e bën edhe më kritike nevojën për forcimin e zërit dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe në diskutimet për hartimin e politikave. |
| | **Ndryshimet klimatike** përbëjnë një rrezik potencial të konsiderueshëm; sidomos sepse ndryshimet e motit mund të ndikojnë kultivimin e bimëve foragjere. |

41. Përafrimi i Kapitullit 11 me treguesit e GAP III të BE-së, treguesit gjinorë të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së, dhe me treguesit e OZHQ-ve. UN Women, 2023. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

# 2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Qumështit në NJA Muhurr

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistë. Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

**Figura 3.** Diagram i zinxhirit të vlerës të qumështit



## 2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më lart, zinxhiri i vlerës i qumështit në Dibër është organizuar në këto nivele kyçe:

- Inputet
- Mbarështimi i bagëtive
- Mjelja dhe ruajtja e qumështit
- Transporti dhe dorëzimi i qumështit (në baxho)

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga inputet deri tek shpërndarja në treg.

**Furnizuesit e inputeve:** Në inputet dhe shërbimet për prodhimet e qumështit përfshihen aksesi në material gjenetik, ushqim (si foragjeret, ashtu edhe koncentratet), farat, plehrat dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, veglat dhe pajisjet, barnat veterinare, vaksinat, dhe shërbimet veterinare. Përveç vënies në dispozicion të këtyre inputeve dhe shërbimeve, është gjithashtu e rëndësishme që të sigurohet aksesueshmëria dhe volitshmëria e tyre për të gjithë prodhuesit që kanë nevojë për to. Prodhimit bujqësor në Shqipëri i nevojiten produkte agrokimike, fara, plehra, pesticide, spermë, dhe një pjesë e konsiderueshme e ushqimit ose ingredientëve të ushqimit për kafshë, që e bën sektorin të jetë në mëshirën e luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare. Ashtu si në vende të tjera në zhvillim, fermerët dhe tregtuesit e inputeve në Shqipëri kanë mjaft vështirësi në sigurimin e furnizimeve konstante dhe me cilësi të lartë. Kjo shkaktohet nga kufizimet financiare, cilësia e ulët e inputeve, si dhe nga shkalla e kufizuar e informacionit dhe njohurive teknike. Inputet relativisht të kushtueshme mund të sigurohen vetëm nëse për to paguhet me para në dorë, kështu që fuqia e ulët blerëse e fermerëve e kufizon përdorimin e tyre. Shpesh fermerët ankohen për cilësinë e ulët të farave foragjere, pesticideve, të ushqimit për kafshë, barnave dhe spermës së buajve. Zakonisht, këto inpute sigurohen përmes furnizuesve vendorë të inputeve, të cilët janë: i) importues/shitës me shumicë dhe me pakicë të farave dhe pesticideve; ii) impiante prodhuese ose importues të ushqimit për bagëtinë; iii) farmaci veterinare për barnat, dhe iv) importues të bagëtive ose inseminuesve për spermën e buajve. Shumë fermerë të vegjël kanë tendencën të blejnë inputet më të lira, për të ulur koston e prodhimit, por në shumicën e rasteve ata dalin me humbje për shkak të performancës së dobët në prodhim. Fermerët e vegjël nuk kanë informacion për inputet dhe e kanë të vështirë të gjejnë informacion, sepse shërbimet publike të ekstensionit nuk kanë kapacitet për të ndihmuar të gjithë fermerët. Fermerët nuk kanë njohuri dhe fonde për përdorimin e ushqimit për kafshë në sasinë dhe cilësinë e duhur; si rezultat, përmirësimet e shënuara në potencialin gjenetik të bagëtive të rritura për qumësht nuk përkthehen në përmirësim të prodhimit të qumështit, sepse bagëtitë e paushqyera mirë nuk mund të shprehin potencialin e plotë gjenetik të tyre. Si rezultat, prodhimi i qumështit është një nga më të ulëtit në rajon. Shumica e fermave të vogla blegtorale kanë informacion shumë të paktë për inputet dhe e kanë të vështirë ta gjejnë atë informacion. Disa nga shitësit me pakicë të inputeve në zonat rurale nuk janë kompetentë në atë që mund t'u këshillojnë fermerëve.[42]

**Blegtorët:** Prodhimi blegtoral i ripërtypësve të vegjël është përshtatur përgjithësisht mirë me kushtet gjeografike dhe klimatike në Shqipëri. Ripërtypësit e vegjël u japin vlerë kullotave natyrore dhe performanca e prodhimit përputhet me nivelin (e dobët) të ushqyerjes. Blegtorët kanë mundësi të përdorin burime të kufizuara ushqimore gjatë dimrit ose periudhave të thata gjatë verës; bagëtitë zhvendosen në largësi të mëdha në kohën e verimit (transhumancave) dhe janë rezistente ndaj sëmundjeve dhe parazitëve. Shumë blegtorë preferojnë racat e vendit. Nga ana tjetër, produktiviteti i racave të vendit është i ulët dhe potenciali i tyre i kufizuar, ndonëse ende i pashfrytëzuar plotësisht.

Në zonat kodrinore dhe malore në Shqipëri mbizotëron sistemi blegtoral ekstensiv. Menaxhimi i ripërtypësve të vegjël bëhet mbi bazat e rritjes tradicionale dhe teknologjitë e reja pak njihen nga fermerët Përzgjedhja e riprodhuesve bëhet nga vetë fermerët, bazuar në përvojën e tyre dhe në informacion empirik. Ushqyerja e kafshëve bazohet kryesisht në përdorimin e rezervave pastorale, sepse ripërtypësit e vegjël mbahen në kullotat verore për rreth pesë deri gjashtë muaj (që nga prilli deri në tetor). Fermerët

42. Raport studimi i sektorit të qumështit. MBZHR, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf

që kanë shumë pak krerë nuk i verojnë bagëtitë dhe përdorin kullota të përbashkëta. Proceset më të rënda të punës me delet/dhitë, për shembull mjelja, kryhen me dorë. Ka pak ndërgjegjësim ose njohuri për kriteret, standardet minimale dhe praktikat e mira në aspekte të ndryshme të mirërritjes së kafshëve, përdorimit të inputeve dhe praktikave të mjeljes.

Zhvillimi i prodhimit primar të qumështit është penguar për vite me radhë nga një numër faktorësh, më kryesorët nga të cilët janë: i) fragmentimi i prodhimit dhe madhësia e vogël e fermave, ii) praktika të dobëta të menaxhimit të fermave, sidomos për sa i përket ushqyerjes, iii) akses i kufizuar në inpute të cilësisë së lartë, iv) moshimi i pronarëve të fermave, që ngadalëson procesin e ndryshimit dhe pakëson mundësitë për investime, v) ofrim i pamjaftueshëm i shërbimeve (shërbimit veterinar, shërbimit të ekstensionit, ndërzimit natyror dhe/ose riprodhimit) dhe, vi) mungesa e organizatave të fermerëve dhe koordinim i pamjaftueshëm në zinxhirin e vlerës. Këta faktorë çojnë në produktivitet dhe efikasitet më të ulët të fermës; aspektet specifike të problemeve më të rëndësishme përshkruhen më poshtë. Intensiteti i ulët kapital i prodhimit – si në fermat e gjedhëve ashtu edhe në ato të bagëtive të imta që rriten për qumësht – rezultojnë në produktivitet të ulët, kosto relativisht të larta të prodhimit dhe fitim të ulët, i cili nga ana tij pengon akumulimin e kapitalit për investime të reja, dhe kështu prodhimi dhe rendimenti në shumë ferma të qumështit janë ende të ulët.

Fermat e vogla gjenden aktualisht në udhëkryq: atyre u duhet të marrin një vendim nëse duan të rriten dhe zhvillohen duke përmbushur standardet, apo të mbyllin aktivitetin e tyre komercial. Si rast specifik, fermat me tufa të vogla vështirë se e mund ta shohin veten si ferma në të ardhmen. Në përgjithësi, këta fermerë kanë tendencën ta lënë këtë aktivitet sapo gjejnë një mundësi tjetër. Shumë prej problemeve – si cilësia e ulët e qumështit, prodhimet mesatare të ulëta dhe shkalla e lartë e sezonalitetit – lidhen me shkallën e vogël të veprimtarisë së fermës. Investimet në pajisjet për mjeljen dhe ruajtjen e ftohtë të qumështit, përmirësimet e praktikave të ushqyerjes së bagëtive dhe atyre foragjere, futja e racave të specializuara të qumështit dhe teknikat e përparuara të mirërritjes së bagëtive janë me rëndësi kyçe për kapërcimin e vështirësive. Megjithatë, investime dhe përmirësime të tilla janë të pagjasa, madje të pamundura, të bëhen në fermat e vogla që janë mbizotëruese në sektorin e blegtorisë për qumësht.[43]

*Blegtoria është veprimtari ekonomike me rëndësi kyçe në njësinë administrative të Muhurrit, ku janë rreth 20-25 ferma bagëtish të imta dhe 20 ferma të specializuara për rritjen e gjedhëve. Sipas INSTAT-it, në vitin 2023, në Muhurr kishte 618 gjedhë, nga të cilët 588 ishin lopë. Krahas këtyre në zonë ka edhe 620 dhi dhe 830 dele, që kontribuojnë në sektorin e diversifikuar të blegtorisë në zonë. Me gjithë rëndësinë e këtij sektori, ka disa vështirësi që ndikojnë në produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tij. Blegtoria në Muhurr kategorizohet në: i) tufa të vogla të përziera (dhi dhe dele) me më pak se 50 krerë dhe jo më shumë se 7-10 lopë, që për kullotje përdorin kryesisht tokën e punueshme ose tokat e përbashkëta, afër shtëpive të blegtorëve, dhe ii) tufa më të mëdha (me 200-300 krerë) kryesisht me dhi, që kullosin në male. Fermerët kanë njohuri minimale për praktikat e mira blegtorale dhe menaxhimin e fermave, dhe shërbimi aktiv i ekstensionit – aq i rëndësishëm për praktikat blegtorale – është minimal.*

*Baxhoja e zonës organizon grumbullimin e qumështit me makinat e veta ndërsa fermerët më të vegjël, që banojnë afër, e dorëzojnë qumështin drejtpërdrejt në baxho. Mjelja ende bëhet me dorë, me përdorim të zakonshëm të bidonëve plastikë dhe të vjetër, që ul cilësinë e qumështit dhe rrit rrezikun e kontaminimit. Gratë luajnë rol kyç në të gjithë zinxhirin e vlerës, që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja, deri tek transportimi i qumështit në baxho. Megjithatë, ato nuk kanë kontroll mbi asetet, nuk kanë njohuri për praktikat më të mira dhe nuk kanë akses në vegla dhe pajisje moderne, që ua shton ngarkesën e punës dhe ul efikasitetin e punës së tyre.*

**Baxhot:** Industria e përpunimit të qumështit në Shqipëri karakterizohet nga një numër i madh i njësive të vogla për përpunimin e qumështit, të quajtura baxho, shumë prej të cilave janë biznese gjysmëformale ose informale. Baxhot me madhësi mesatare dhe ato të mëdha janë shumë më të pakta në numër; ato bëjnë përpjekje dhe investime për t'u rritur si biznese dhe

43. Raport studimi i sektorit të qumështit. AGT & DSA, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf

për të përmbushur më mirë standardet, dhe përbëjnë bazën e industrisë së përpunimit të qumështit. Njësitë e vogla gjenden në zona rurale dhe të thella. Pjesa më e madhe e tyre në zonat malore janë sezonale, sepse përpunojnë kryesisht qumësht deleje dhe dhie; gjatë stinës së prodhimit ato përpunojnë edhe sasi të vogla qumështi lope. Ato përdorin metoda/teknologji të vjetruar dhe zbatojnë standarde të pamjaftueshme të sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Higjiena është problem në shumicën e këtyre njësive. Ato nuk kanë kapacitetet të përshtatshme për ruajtjen e qumështit dhe ai përpunohet sipas kapacitetit të njësisë. Ato kanë gjithashtu probleme të tregtimit të produkteve. Klientët e tyre janë dyqane të vogla në zonat urbane, por jo në rrethet e mëdha. Ato zakonisht i paguajnë fermerët me disa muaj vonesë dhe rrjedhimisht, fermerët nuk kanë mundësi të blejnë ushqim dhe materiale të tjera për bagëtitë e tyre.

Gjithashtu, ato kanë shumë më pak kërkesa për cilësinë e qumështit të papërpunuar, krahasuar me baxhot më të mëdha dhe të formalizuara: ato masin vetëm dendësinë dhe përmbajtjen yndyrore të qumështit, por nuk e analizojnë qumështin për ngarkesën e qelizave somatike dhe mikrobiologjike; për të garantuar sigurinë ushqimore ato bëjnë pasterizim për disa minuta, që ndikon cilësinë; uji i përdorur për përpunimin e qumështit nuk trajtohet paraprakisht; inputet dhe menaxhimi teknologjik bëhen me hamendje. Nuk bëhet menaxhim i mbetjeve ujore.[44]

*Baxhoja modeste "Bjeshkët e Runjës" në Muhurr menaxhohet nga Liliana dhe Selman Boka. Gjatë viteve të fundit, baxhoja ka rritur prodhimin e djathit të dhisë nga 2 në 5 ton. Duka pasur një klientelë solide, në pjesën më të madhe konsumatorë të drejtpërdrejtë dhe restorante, baxhoja e ka të vështirë të zgjerojë aktivitetin e vet, kryesisht për shkak të sasive të kufizuara të furnizimit me qumësht.*

*Baxhoja ka vënë edhe çmime të favorshme për fermerët, me qëllim që ata të ruajnë sasinë e qumështit. Megjithëse kanë vështirësi për zgjerimin e prodhimit të djathit të dhisë, pronarët e baxhos po planifikojnë të bashkëpunojnë me blegtorët e gjedhëve (20) dhe të zgjerojnë gamën e prodhimeve të tyre me djathin kaçkavall që prodhohet me qumësht lope.*

*Baxhoja u përmbahet të gjitha standardeve dhe rregullave, bën paketimin e duhur, me një brand dhe etiketim solid, dhe djathi i dhisë "Bjeshkët e Runjës" ka marrë certifikimin "Produkt Tipik". Djathi i dhisë nga bjeshkët e Runjës prodhohet nga kooperativa e blegtorëve "Dhia Autoktone e Bulaçit" (gjashtë burra dhe një grua) në Muhurr dhe bëhet me qumësht të freskët të mjelë nga dhitë e Bulaçit, nga barinjtë që i kullosin dhitë e tyre në bjeshkët e Runjës. Kjo i jep djathit aromën e veçantë të malit, si rezultat i sistemit të kullotave ku përfshihen lisat, shkurret e kulumbrisë, kullotat alpine, si edhe i metodave tradicionale të përpunimit të qumështit.*

44. Po aty.

## 2.2 KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet blegtoria dhe fermat e qumështit në Shqipëri përbëhet nga një grup ligjesh kombëtare, rregulloresh qeveritare dhe procesesh të përafrimit me BE-në. Korniza ligjore fokusohet në zhvillimin bujqësor, mirëqenien e bagëtive, sigurinë ushqimore dhe praktika të qëndrueshme bujqësore dhe blegtorale. Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit është politikë kombëtare me qasje shumësektoriale. Korniza kohore e strategjisë është shtatë vjet, nga viti 2021 deri në vitin 2027. Qëllimet e kësaj strategjie janë që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor për të plotësuar nevojat e njerëzve që përballen me sfida afatmesme dhe afatgjata në lidhje me sigurimin e ushqimit, fitimin e jetesës, ndryshimet klimatike, dhe humbjen e biodiversitetit, si dhe të për zhvilluar dhe për t'i bërë më konkurruese njësitë ekonomike familjare në zonat rurale, bazuar në politika që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin efikas të inputeve bujqësore dhe të peshkimit, dhe të njohurive bujqësore dhe inovacionit.[45]

**Ligji nr. 9441, datë 11.11.2005,** "Për *prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi*". Objektivat kryesore të këtij ligji janë të sigurojë prodhimin e duhur të qumështit në ferma, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit të papërpunuar dhe të përpunuar, si dhe të produkteve me bazë qumështin.

Ky ligj synon të sigurojë procese prodhimi dhe tregtimi me cilësi të kontrolluar sipas kërkesave të tregut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Ai fokusohet gjithashtu në rregullimin me ligj të licencimit të fermave të prodhimit të qumështit dhe qendrave të grumbullimit, standardizimit dhe përpunimit të qumështit. Një objektiv tjetër i rëndësishëm është garantimi i sigurisë së konsumatorit, duke siguruar që qumështi dhe nënproduktet e tij përmbushin standardet e rrepta të sigurisë ushqimore, për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e publikut.[46]

**Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011,** *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*. Ligji përcakton kuadrin për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve sipas standardeve të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OBSHK) dhe BE-së dhe organizimin, funksionimin dhe financimin e shërbimit dhe inspektoratit veterinar, si dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të transmetuara nga kafshët.[47]

**Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008,** *"Për ushqimin"*. Ky ligj synon të sigurojë nivele të larta të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorëve për sa i përket produkteve ushqimore. Ai përcakton rregullat që drejtojnë higjienën e ushqimeve, përgjegjësitë e operatorëve të bizneseve, standardet e cilësisë së ushqimeve, regjistrimin e treguesve gjeografikë të origjinës, etiketimin e ushqimeve dhe standardet e tregtimit. Ligji përcakton gjithashtu sistemin e inspektimit të ushqimeve dhe krijon Agjencinë Kombëtare të Ushqimit. Dispozitat përfundimtare trajtojnë shkeljet dhe dënimet përkatëse.

**Ligji nr. 38/2013,** *me të cilin u ndryshua Ligji nr. 9693, "Për fondin kullosor"*. Ky ligj ka të bëjë me administrimin dhe mbrojtjen e kullotave dhe livadheve. Ai përcakton detyrat dhe detyrimet e organeve të pushtetit qendror dhe vendor në këtë sektor dhe parashikon institucione kërkimore të specializuara.[48]

**Ligji nr. 10431/2011,** *"Për mbrojtjen e mjedisit"*. Ky ligj mbron mjedisin dhe biodiversitetin në Shqipëri, rregullon përdorimin e tokës për bujqësi dhe siguron që kullotat që përdoren për bagëtitë të mos ndikojnë negativisht në zonat e mbrojtura dhe habitatet natyrore. Ligji përcakton kornizën për sigurimin e mbrojtjes me nivel të lartë të mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.[49]

45. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb211951.pdf
46. Shih: http://aku.gov.al/wp-content/uploads/2016/06/LIGJI-Nr.9441-per-qumshtin.pdf
47. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb113038.pdf
48. Shih:https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC132117/#:~:text=Law%20No.%2038/2013%20amending%20Law%20No.%209693%20on%20the%20Pasture%20Fund
49. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb112561.pdf

Me përparimin drejt anëtarësimit në BE, Shqipëria po përafron legjislacionin e saj bujqësor dhe blegtoral me rregulloret e BE-së për të siguruar akses në tregjet evropiane. Kjo përfshin miratimin e standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore, mirëqenien e kafshëve, praktikat e qëndrueshme bujqësore, dhe aksesin në treg. Ligjet shqiptare për produktet e qumështit dhe produktet blegtorale janë gjithnjë e më shumë në përputhje me ligjet e BE-së për shëndetin e kafshëve, kontrollet veterinare, gjurmueshmërinë, dhe standardet higjienike. Ndryshimet kryesore fokusohen në përmirësimin e sigurisë ushqimore, sigurimin e trajtimit human të kafshëve, nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme, dhe zbatimin e kontrolleve më të rrepta për shëndetin e kafshëve dhe inspektimet veterinare.

## 2.3 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

**Sektori i prodhimit blegtoral,** në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 95 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe në mbështetje të realizimit të programit të qeverisë, synon të analizojë, identifikojë dhe hartojë politika e strategji sektoriale për zhvillimin e blegtorisë.

Këtu përfshihet drejtimi dhe mbështetja e përpjekjeve në nivel vendi dhe nivel lokal për plotësimin e kërkesave të tregut për prodhime blegtorale përmes përdorimit racional të burimeve dhe futjes së teknikave dhe teknologjive të reja në prodhim.[50] Sektori fokusohet në:

- Harmonizimin e legjislacionit me standardet e BE-së në kontekstin e politikave të zhvillimit dhe integrimit, përmes propozimit, hartimit, dhe zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjor e në fushën e blegtorisë.
- Hartimin e politikave dhe programeve për përmirësimin e mbarështimit dhe kafshëve dhe të prodhimit blegtoral.
- Përgatitjen e kuadrit ligjor të duhur për zbatimin e politikave të zhvillimit në sektorin e blegtorisë.
- Forcimin e sistemeve të monitorimit dhe zbatimin e standardeve të mirërritjes së kafshëve.
- Nxitjen dhe konsolidimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit blegtoral me ferma të specializuara, komplekse industriale të prodhimit të vezëve dhe të mishit, si dhe të prodhimit të ushqimeve.
- Miradministrimin e burimeve gjenetike shtazore të kultivuara dhe autoktone në blegtori.
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit, cilësisë dhe të tregtimit të materialeve racore, në përputhje me standardet.
- Vlerësimin e tendencave në zhvillimin e blegtorisë nëpërmjet studimeve, analizave mbi strukturën dhe përcaktimin e prioriteteve për prodhimin blegtoral.

Sektori i prodhimit blegtoral e ushtron veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit nr. 9426, datë 6.10.2005, «Për mbarështimin e blegtorisë « (ndryshuar me ligjin nr. 9864, datë 28.01.2008) dhe disa ligje të tjera, ndër të cilët ligji nr. 10137, datë 11.05. 2009, që ka të bëjë me licencat, autorizimet dhe lejet dhe në Shqipëri, si dhe një varg aktesh nënligjore. Institucionet e përfshira në realizimin e objektivave në fushën e blegtorisë janë:

- Drejtoria e Përgjithshme të Politikave Bujqësore në MBZHR, është autoriteti kompetent për ushtrimin e veprimtarive në fushën e blegtorisë nëpërmjet:
  - Sektorit të prodhimit blegtoral
  - Specialistëve të blegtorisë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë.
  - Qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore
  - Shërbimit këshillimor publik dhe/ose privat

Sektori i Prodhimit Blegtoral është përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të Prodhimit Blegtoral në vend nëpërmjet

50. Shih: https://www.bujqesia.gov.al/bujqesia-dhe-blegtoria/

hartimit të legjislacionit, strategjive sektoriale, si dhe të politikave të zhvillimit dhe programeve të mbrojtjes, përmirësimit dhe ruajtjes së cilësive të burimeve gjenetike shtazore për të nxitur rritjen e prodhimeve blegtorale, krijimin dhe përhapjen e vlerave racore dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve të fermës:

- Zhvillimin e strategjisë dhe politikave për sektorin e blegtorisë;
- Monitorimin, vlerësimin dhe rinovimin sistematik të politikave dhe strategjive të prodhimit blegtoral;
- Analizat e nevojshme për zhvillimin e politikave dhe hartimin e programeve për zbatimin e politikave të zhvillimit të blegtorisë për mbarështimin e mirë të bagëtive;
- Hartimin dhe përafrimin e legjislacionit në fushën e blegtorisë me atë të BE-së;
- Vlerësimin e progresit gjenetik për caktimin e rentabilitetit të racave, përcaktimin e prioriteteve për strategjinë e punës racore;
- Identifikimin e burimeve gjenetike autoktone e të kultivuara dhe propozimin e masave mbrojtëse për to;
- Monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për mbarështimin e kafshëve dhe përmirësimin racor si dhe të mbrojtjes dhe zhvillimit të fondit gjenetik autokton si dhe zbatimit të masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të kafshëve.

**Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (DRB):** Në kuadër të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, specialistët e blegtorisë (zooteknikët) ushtrojnë aktivitetin e tyre për të siguruar:

- zbatimin e legjislacionit në fushën e blegtorisë;
- plotësimin e kushteve për mbarështimin e qëndrueshëm të kafshëve të fermës;
- përmirësimin racor;
- ushqimet dhe të ushqyerit e kafshëve;
- tregtimin e materialeve racore.

**Shërbimi zooteknik privat:** Shërbimi zooteknik privat i ushtron funksionet e tij në fushën e riprodhimit të bagëtive. Në kuadër të tij ushtrojnë aktivitetin 480 teknikë inseminatorë të kualifikuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (shërbimi publik). Shërbimi zootenik privat operon në ferma, biznese të tjera blegtorale, dhe në organizata të mbarështimit të kafshëve dhe programi i tij miratohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)**[51] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

51. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë dhe Korçë janë struktura për transferimin e teknologjive blegtorale në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (më parë MBUMK). QTTB-ja në Fushë-Krujë është qendër e referencës kombëtare (QRK) për:

- Kontrollin e ushqimit që përdoret në prodhim blegtoral;
- Kontrollin e materialeve racore (spermë, vezë, embrione);
- QTTB-të i kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me politikat për zhvillimin e prodhimit blegtoral.

**Shërbimi këshillimor:** Shërbimi këshillimor është pjesë e strukturave të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë (DRB), ku operojnë zooteknikë që ofrojnë këshilla dhe shërbime në nivel vendor (komune).

**Këshilli i Blegtorisë:** Këshilli i Blegtorisë është një organ këshillimor i caktuar nga Ministri për një mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje, në përputhje me nenin 73 3 të Ligjit Nr. 9864, datë 28.01.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06.10.2005, 'Për Mbarështimin e Blegtorisë'". Ndër detyrat e Këshillit të Blegtorisë përfshihen:

- Këshillimi i Ministrit për politikat që kanë lidhje me blegtorinë;
- Dhënia e mendimeve për:
  - Politikat bujqësore që rregullojnë sektorin e blegtorisë;
  - Programet e zhvillimit afatgjatë;
  - Programet racore të propozuara për miratim;
  - Raportet vjetore për veprimtaritë që lidhen me programet racore;
  - Rregulloret e rëndësishme në sektorin e blegtorisë;
  - Njohjen e racave autoktone;
  - Ushqimet dhe ushqyerjen e bagëtive;
- Ndryshimet në metodat ekzistuese ose futjen e metodave të reja për vlerësimin e potencialit racor dhe vlerësimin e bagëtive.

**Masat legjislative:** Sektori i Prodhimit Blegtoral, në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ka synuar të zbatojë një numër politikash që lidhen me miratimin e disa nismave legjislative që synojnë përafrimin e legjislacionit kombëtar me standardet e BE-së.

Në masat legjislative, procesi i harmonizimit të kuadrit ligjor është fokusuar në hartimin e legjislacionit bazë për prodhimin blegtoral që lidhet me standardet zooteknike të kafshëve me racë të pastër që përdoren për mbarështim. Këtu përfshihet edhe përcaktimi i kritereve për përdorimin e kafshëve me racë të pastër për qëllime riprodhimi, si edhe vendosjen e standardeve zooteknike dhe të kushteve për tregtimin e materialeve për riprodhim, si edhe kriteret për përdorimin e kafshëve me racë të pastër për riprodhim natyror dhe/ose inseminim artificial, si dhe për përdorimin e spermës së tyre.

Masat legjislative do të synojnë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar në sektorin e blegtorisë me atë komunitar si dhe përmirësimin e bashkërendimit ndërinstitucional për zbatimin e tij.

Politikat aktuale të sektorit të prodhimit blegtoral fokusohen kryesisht në rritjen e numrit të bagëtive (gjedhë dhe bagëti të imta) në fermat blegtorale, me qëllim konsolidimin e këtyre fermave dhe orientimin e tyre drejt tregut. Gjithashtu, mbështetja e prodhimit të bagëtive me racë të pastër synon të krijojë dhe nxisë shoqatat për mbarështimin e bagëtive dhe krijimin e një tregu të brendshëm për kafshë me vlerë gjenetike të identifikuar.

### Legjislacioni për prodhimin blegtoral

1. Ligji nr. 9426, datë 06.10.2005, "Për mbarështimin e blegtorisë", ndryshuar me Ligjin nr. 9864, datë 28.01.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë", dhe me ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 ,"Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë».

2. Urdhër i Ministrit nr. 4, datë 09.09.2008, për miratimin e rregullores mbi "Standardet minimum të mbarështimit të kafshëve shtëpiake (standardet minimum të mbarështimit të gjedhit-viçave)".

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1708, datë 29.12.2008, "Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta».

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 02.06.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1634, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave 'Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve'».

5. Urdhër i Ministrit nr. 3, datë 05.08.2008, për miratimin e rregullores "Për certifikimin e kafshëve racëpastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racëpastër dhe hibridë, spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre».

6. Urdhër i Ministrit nr. 1, datë 04.03.2009, për miratimin e rregullores "Për standardet për mbarështimin e derrave dhe pulave pjellëse».

7. Urdhër i Ministrit nr. 2 dt. 22. 07. 2008 për miratim rregullores "Për riprodhimin e kafshëve të fermës, prodhimin dhe tregtimin e materialeve racore"

8. Urdhër i Ministrit nr. 422, datë 17.12.2009, për miratimin e rregullores "Për kushtet për regjistrimin e riprodhuesve racëpastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racëpastër dhe hibridë në librin gjenealogjik».

9. Urdhër i Ministrit nr. 83, datë 16.03.2010, për miratimin e rregullores "Për organizatat e mbarështimit të kafshëve".

10. Urdhër i Ministrit nr. 300, datë 8.10.2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të species së gjedhit».

11. Urdhër i Ministrit nr. 333, datë 17.11.2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të dhenve dhe dhive».

12. Urdhër i Ministrit nr. 332, datë 17. 11. 2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të derrave dhe derrave hibridë"

13. Urdhër i Ministrit nr. 303, datë 04.11.2011, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racëpastër të species së gjedhit".

14. Urdhër i Ministrit nr. 318, datë 14.11.2011, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racëpastër të specieve dhen dhe dhi".

15. Urdhër i Ministrit nr. 6, datë 09. 01. 2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racëpastër të llojit gjedh për qëllime riprodhimi".

16. Urdhër i Ministrit nr. 360, datë 27. 12. 2011, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racëpastër të llojit dhen dhe dhi për qëllime riprodhimi".

17. Urdhër i Ministrit nr. 237 datë 26.07.2012, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të derrave racëpastër për riprodhim".

18. Urdhër i Ministrit nr. 298, datë 10.10.2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave racëpastër për qëllime riprodhimi".

19. Urdhër i Ministrit nr. 346, datë.13.12.2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave hibridë për qëllime riprodhimi".

**Shërbimi veterinar në Shqipëri** rregullohet me Ligjin nr. 10465, miratuar më 29.09.2011, i cili synon mbrojtjen e shëndetit dhe mirërritjes së kafshëve si dhe mbajtjen nën kontroll të sëmundjeve ngjitëse tek kafshët. Autoriteti kryesor në këtë fushë është Drejtoria e Shërbimit Veterinar (DSHV), në përgjegjësitë e së cilës përfshihen:

- Hartimi i politikave dhe strategjive për shëndetin e kafshëve përmes:
  - Krijimit të programeve për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse tek kafshët;
  - Propozimit të përmirësimeve në legjislacionin veterinar në përputhje me legjislacionin veterinar të Bashkimit Evropian;
  - Monitorimit të situatës epidemiologjike të sëmundjeve ngjitëse dhe informimit të institucioneve përkatëse.

- **Mbikëqyrja e veprimtarive veterinare përmes:**
  - Kontrollimit të kushteve sanitare veterinare dhe sigurisë ushqimore për kafshët;
  - Regjistrimit të fermave dhe stabilimenteve të bagëtive, enteve që tregtojnë kafshë, dhe personave që transportojnë kafshë;
  - Mbikëqyrjes së punës së veterinerëve zyrtarë dhe monitorimit të shëndetit të kafshëve në hapësirat rurale dhe publike.

- **Shërbimi Veterinar Rajonal:**
  - Shërbimi veterinar rajonal funksionon në varësi të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, dhe ka përfaqësues në secilin prej qarqeve të Shqipërisë. Ata kryejnë funksione si kontrollimi i kushteve sanitare, mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse, dhe monitorimi i kushteve të mbarështimit të kafshëve.

- **Sektori i identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve:**
  - Ky sektor është përgjegjës për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave blegtorale, si edhe për zbatimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me këto procese.

- **Kontrolli i tregtimit dhe transportimit të kafshëve:**
  - Shërbimi veterinar mbikëqyr tregtimin dhe transportimin e kafshëve dhe të produkteve embrionike, për të siguruar që ato plotësojnë kriteret e sigurisë dhe të mirëqenies së kafshëve.

- **Monitorimi dhe vënia nën kontroll e sëmundjeve ngjitëse:**
  - Shërbimi veterinar është përgjegjës për monitorimin e sëmundjeve parazitare dhe infektive dhe zbatimin e masave për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të tyre.

Në këtë kontekst, DSHV-ja është strukturë qendrore për garantimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit të publikut, si edhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të blegtorisë.

**Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)** është qendra kombëtare e referencës laboratorike veterinare (sipas Ligjit nr.10465). Varet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe është përgjegjës për hartimin në bashkëpunim me DSHK të strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, te ujit dhe shpendë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Veterinar (DSHV). Instituti kryen diagnoza veterinare dhe analiza profilaktike të shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen gjithashtu programe analizash për kontrollimin e sëmundjeve epizootike, barnave veterinare, si edhe diagnostikime të sëmundjeve të përgjithshme. Po ashtu, ai kryen analiza të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e shëndetit Publik. ISUV-ja bashkëpunon me FAO-n, OBSH-në dhe OBSHK-në, si dhe me laboratorë të tjerë reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektive.

Departamenti i Shëndetit të Kafshëve në ISUV, përfshin gjashtë sektorë: bakteriologji, virologji, parazitologji, mykologji, epidemiologji veterinare dhe kontrolli i barnave veterinare. Në këtë departament punësohen 28 persona, prej të cilëve 23 specialistë dhe pesë teknikë laborantë. Gjithashtu, pjesë e ISUV-së është edhe sektori i prodhimit të biopreparateve, me 11 punonjës, prej të cilëve tre specialistë dhe tetë teknikë laborante.

ISUV zbaton sistemin e menaxhimit të cilësisë mbështetur në standardin ISO 17025:2005. Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë në ISUV përbëhet nga pesë specialistë dhe 13 referente cilësie (nga një person për secilin sektor të ISUV). Aktualisht janë akreditуar gjashtë analiza nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (trupa kombëtare e akreditimit) si dhe është miratuar akreditimi i këtyre analizave edhe nga një trupë e huaj akreditimi (Accredia – trupa kombëtare akredituese në Itali).

**Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar (LSHKV)** është pjesë e shërbimit veterinar, që është përgjegjës për kontrollimin e produkteve mjekësore veterinare (barna dhe bioprodukte), të prodhuar në vend ose të importuara. Biopreparatet në vend prodhohen nga njësi të autorizuara nga ministria dhe përdoren pasi të jenë kontrolluar nga LSHKV-ja. Tarifat për kryerjen e analizave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.
Ligjet bazë në fushën e veterinarisë

## Ligjet kryesore të Veterinarisë

**Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011,** *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*:

- Ky ligj përcakton parimet bazë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve sipas standardeve ndërkombëtare të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OBSHK) dhe të Bashkimit Evropian.

- Rregullon dhe organizon shërbimet veterinare, duke përcaktuar përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.

- Garanton mbrojtjen e shëndetit publik në Shqipëri nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

**Ligji nr. 8702, datë 01.12.2000,** "*Për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve*»:

- Synon të rregullojë lëvizjet e bagëtive përmes identifikimit individual të tyre.

- Vendos regjistrimin e fermave blegtorale dhe u cakton atyre një numër unik regjistrimi.

- Siguron shkëmbimin e shpejtë dhe të saktë të të dhënave për vendndodhjen e kafshëve për qëllime veterinare, zooteknike dhe statistike.

- Rregullon marrëdhëniet midis institucionit shtetëror përgjegjës dhe pronarëve të fermave blegtorale.

### Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 646 i vitit 1995, «Për adaptimin e direktivave të EU në fushën e produkteve të detit «.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 19.03.2008, «Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 19.02.2009, «Për një ndryshim në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 831, datë 29.07.2009 «Për një shtesë në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 08.05.2013, «Për dëmshpërblimin për kafshët e eliminuara».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 20.03.2013, «Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore».

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 02.04.2013 « Për ngritjen e grupit ndërministror të punës për koordinimin dhe kontrollin e fushatës së vaksinimit oral kundër sëmundjes së tërbimit në Shqipëri».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore" (ndryshuar me VKM nr. 592, datë 01.07.2015; VKM nr. 956, datë 25.11.2015; VKM nr. 734, datë 20.10.2016; VKM nr. 373, datë 05.06.2024). Ky vendim përcakton kuadrin ligjor për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore. Ai përcakton llojet e objekteve të lejuara, duke specifikuar se cilat ndërtime lejohen brenda zonave bujqësore, rregullat dhe kriteret teknike për të siguruar qëndrueshmërinë e mjedisit, sigurinë ushqimore, dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së, si dhe procedurat për marrjen e lejeve dhe miratimeve nga autoritetet përkatëse.

Në kuadër të nenit 70 marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe nenit 95, «Bujqësia dhe sektori agro-industrial», janë miratuar një varg aktesh nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 9308, datë 04.11.2004, «Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar» dhe më vonë, pas shfuqizimit të tij, në zbatim të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 «Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë.» Këto akte synojnë përmirësimin e standardeve për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, sidomos ndaj sëmundjeve zoonotike që kanë ndikim negativ në shëndetin e njeriut, si edhe të forcojnë kontrollin zyrtar përmes rritjes së mbrojtjes së shëndetit publik dhe të interesave të konsumatorëve.

**Katër Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),**[52] në Lushnjë, Korçë, Tiranë, dhe Shkodër

52. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc

(që përfshin edhe Malësinë e Madhe) operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

**Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)**[53] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

- Shërbimet veterinare: Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.
- Mbrojtja e bimëve: Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.
- Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat: Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.
- Siguria ushqimore dhe inspektimi: Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- Kontrolli kufitar dhe biosiguria: Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.
- Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit: Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet: Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;

53. Shih: https://akvmb.gov.al/

- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;
- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**[54] është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) kështillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien e rreziqeve ndaj interesit publik.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për garantimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;
- garantimit i respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;
- kryerja e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;
- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;
- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;
- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;
- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

**Sektori i bujqësisë në Bashkinë Dibër** (i përbërë nga dhjetë burra dhe tri gra) aktualisht përqendrohet në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, por mbështetja që u ofron fermerëve përmes shërbimeve të ekstensionit është e kufizuar.[55]

**Certifikimi** HACCP[56] është një standard ndërkombëtar që bazohet në parimet e *FAO/WHO Codex Alimentarius Commission* (Komisioni *Codex Alimentarius* i FAO-s dhe OBSH-së), dhe përfshin një grup të plotë parimesh mbi higjienën dhe

54. Shih: https://aku.gov.al/
55. Konstatime nga takimet dhe intervistat në bashki.
56. Shih: https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Udhezim_Nr.20.pdf

sigurinë ushqimore. Ai është një sistem parandalues për menaxhimin e sigurisë ushqimore, që është i detyrueshëm për të gjitha bizneset ushqimore, në përputhje me Rregulloret Evropiane (EC) 178/2002[57] dhe 852/2004[58], si dhe me Udhëzimin Kombëtar nr. 2020, datë 25.11.2010, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.[59] Procesi i certifikimit HACCP zakonisht zgjat nga 14 deri 30 ditë, në varësi të kërkesave konkrete të biznesit përkatës, dhe përfshin:

- **Vizitë tek biznesi:** Biznesi vizitohet nga një kompani konsulente e specializuar për të vlerësuar proceset e punës dhe për të dhënë rekomandime për përmirësime dhe përshtatje për plotësimin e standardeve të HACCP-së.

- **Përgatitja e dokumentacionit:** Biznesi duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen evidenca, procedura dhe plane që lidhen me sigurinë dhe higjienën ushqimore.

- **Krijimi i sistemeve për mbajtjen e dokumentacionit:** Duhet të ngrihet një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave, për të garantuar që procedurat e sigurisë ushqimore të jenë të dokumentuara siç duhet dhe të gjurmueshme.

- **Inspektimi nga organi certifikues:** Organi certifikues inspekton biznesin për të siguruar plotësimin e të gjitha kritereve të HACCP-së dhe kontrollon si dokumentacionin, ashtu edhe praktikat e ndjekura.

- Lëshimi i certifikatës: Pas inspektimit të suksesshëm, trupa certifikuese lëshon certifikatën HACCP, që konfirmon se biznesi përmbush standardet e sigurisë ushqimore.

57. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002R0178
58. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004R0852
59. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb144203.pdf

## 2.4 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet e drejtpërdrejta dhe intervistat e kryera me aktorë kyç të zinxhirit të vlerës – përfshirë prodhues, përpunues, dhe specialistë teknikë në produktet e bulmetit – u identifikuan këto konstatime:

**Mundësitë:**

- Investimet në infrastrukturë, si në sisteme për grumbullimin e qumështit, cisterna ftohëse, dhe laboratorë për analiza në baxhon vendore të Muhurrit – do të siguronin një kontroll më të mirë të cilësisë së qumështit dhe garantonte sigurinë e ushqimeve.

- Forcimi i miradministrimit dhe vendosja e mekanizmave të gjurmueshmërisë mund të trajtojë problemet në zinxhirin e furnizimit të qumështit dhe të përmirësojnë zbatimin e standardeve të cilësisë, duke ndihmuar që sektori i qumështit/ bulmetit të rritet në mënyrë të qëndrueshme.

- Rritja e sasisë së furnizimit me qumësht nga blegtorët e zonës mund të shtojë në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e prodhimit përfundimtar të baxhos, që merr shtysë nga kërkesat e tregut lokal dhe preferencat e konsumatorëve për produkte bulmeti të vendit. Për të siguruar rritje me përfshirje më të gjerë, është e rëndësishme që blegtorët dhe blegtoret të mbështeten për të shtuar prodhimin, sidomos duke adresuar barrierat specifike gjinore, si aksesi i kufizuar në burime, trajnime dhe shërbime. Krahas kësaj, ekziston mundësia për vijueshmëri pas projektit, përmes baxhos lokale, që mund të forcohet duke nxitur pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e fermës.

- Ekzistenca e shembujve të praktikave të mira blegtorale dhe stallave moderne në rajon dhe në vend, që mund të shërbejnë si modele të mira për t'u ndjekur dhe zbatuar në Muhurr.

- Gratë janë të përfshira në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës, që nga kujdesi për bagëtitë, mjelja dhe dorëzimi i qumështit në baxho. Megjithatë, ato nuk kanë kontroll mbi asetet, nuk kanë njohuri për praktikat më të mira në mbarështimin e bagëtive dhe, çka është më e rëndësishme, nuk kanë akses në vegla dhe pajisje që mund të lehtësojë ngarkesën e punës dhe të shtojë produktivitetin e tyre. Ato kanë aftësitë bazë, por mund ta zhvillojnë më tej ekspertizën e tyre përmes trajnimeve të posaçme dhe mbështetjes me pajisjet e nevojshme, që do t'i ndihmojnë të rrisin produktivitetin, të kenë më shumë kontroll mbi asetet, dhe njëkohësisht të ulin ngarkesën e punës.

- Blegtorët e vegjël mund të shtojnë produktivitetin përmes zbatimit të praktikave të mira blegtorale, sidomos sa i përket kujdesit për kafshët, higjienës së mjeljes, menaxhimit të mjedisit, dhe aspekteve social-ekonomike. Duke i zbatuar këto praktika, blegtorët mund të përmirësojnë cilësinë e qumështit, të sigurojnë blegtori të qëndrueshme dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre ekonomike.

- Ekzistojnë mundësi të konsiderueshme për zbatimin e praktikave të mira blegtorale, sidomos në fusha si:

  - **Kujdesi për bagëtitë** – sigurimi i ushqimit të duhur, shëndetit dhe mirëqenies së bagëtive, duke njohur dhe forcuar njëkohësisht rolin e grave në punët e përditshme për mbarështimin e bagëtive. Trajnimet e posaçme për gratë mund të përmirësojnë standardet e kujdesit për bagëtitë dhe t'i fuqizojnë ato si menaxhere blegtorale që zotërojnë njohuritë përkatëse.

  - **Higjiena e mjeljes** – mbajtja e pastërtisë në procesin e mjeljes për përmirësimin e cilësisë dhe të sigurisë së qumështit, me fokus në mbështetjen e grave që shpesh janë ato që bëjnë mjeljen, duke u mundësuar akses në pajisje, infrastrukturë dhe njohuri teknike të përshtatshme.

  - **Mjedisi** – zbatimi i metodave blegtorale të qëndrueshme për të mbrojtur burimet natyrore dhe mjedisin, duke siguruar që gratë të përfshihen në vendimmarrje dhe të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga novacionet që favorizojnë ruajtjen e mjedisit, si për shembull menaxhimi më i mirë i mbetjeve.

- **Menaxhimi social-ekonomik** – forcimi i aftësive të biznesit, menaxhimit të burimeve dhe aksesit në treg për sigurimin e aktivitetit të suksesshëm afatgjatë të fermave, me përpjekje të veçanta për ndërtimin e kapaciteteve të grave në njohuri financiare, drejtimin e kooperativave, dhe zhvillimin e tyre si sipërmarrëse, përmes mundësimit të pjesëmarrjes dhe përfitimit të barabartë të tyre nga zinxhiri i vlerës i qumështit/bulmetit.

**Kufizimet:**

Sa u përket kufizimeve që ndeshen në zinxhirin e vlerës, ato mund të përmblidhen si vijon:

- Shumica e aktiviteteve blegtorale janë informale, që do të thotë se punëtorët dhe prodhuesit (sidomos gratë) nuk janë të regjistruara në zyrat ose autoritetet tatimore. Si rezultat, ato humbin të drejtën për të përfituar nga skemat e subvencioneve, të sigurimeve shëndetësore, të pensioneve, dhe programe e projekte të ndryshme.

- Fermerët e vegjël (më pak se dhjetë gjedhë, ose më pak se 100 bagëti të imta), nuk përfshihen në skemën e mbështetjes së bujqësisë për vitin 2025, që kufizon aksesin e tyre në burime financiare dhe mundësi investimi. Ky përjashtim ndikon në mënyrë disproporcionale tek gratë fermere, të cilat kanë më shumë gjasa të kenë ferma të vogla, për shkak të aksesit të kufizuar në tokë, kredi, dhe asete prodhuese. Krahas kësaj, informaliteti i lartë në zinxhirin e furnizimit me qumësht i pengon gratë të formalizojnë bizneset e tyre, të kenë akses në shërbime mbështetëse, dhe të përfitojnë nga lidhjet në treg. Situata përkeqësohet më tej nga shërbimet e pamjaftueshme të ekstensionit, të cilat shpesh nuk arrijnë deri tek gratë për shkak të tendencioziteteve strukturore, mundësive të kufizuara të lëvizjes, dhe mungesës së qasjeve të posaçme për to. Për më tepër, mungesa e administrimit të mirë në zinxhirin e vlerës së qumështit/bulmetit – sidomos për sa i përket gjurmueshmërisë së qumështit dhe zbatimit të ligjit – pakëson llogaridhënien dhe sigurinë, me pasoja për shëndetin e konsumatorëve dhe për rolet e grave në përkujdes dhe në administrimin e familjes.

- Kontrolli i cilësisë së qumështit të papërpunuar është i pamjaftueshëm; regjistrat e fermave janë të paplotë dhe metodat e kampionimit të papërshtatshme. Në baxho nuk ka një laborator për kryerjen e analizave të qumështit, dhe mjelja kryhet më së shumti me dorë dhe nga gratë, me pajisje të vjetra, që çon në rrezik kontaminimi. Sistemet e grumbullimit të qumështit janë të pazhvilluara dhe shumë ferma nuk kanë kazanë ftohës dhe pajisjet e duhura, që vë në rrezik sigurinë ushqimore. Luhatjet sezonale në prodhim dhe furnizimi jokonsistent me qumësht kufizojnë më tej kapacitetet prodhuese, sidomos në baxhon lokale në Muhurr, e cila me shtimin sasisë së qumështit të furnizuar mund të shtojë prodhimin e nënprodukteve.

- Blegtorët kanë njohuri të kufizuara për praktikat e mira blegtorale, sidomos në lidhje me kujdesin për kafshët, higjienën e mjeljes dhe menaxhimin e mjedisit. Shumë prej tyre nuk janë të ndërgjegjësuar për standardet minimale të qumështit, higjienën e duhur në grumbullimin e qumështit, dhe menaxhimin efektiv të mbetjeve. Gjithashtu, në fermat e ripërtypësve të vegjël prodhimi i qumështit është i ulët për shkak të praktikave të dobëta të punës.

- Gratë punojnë në kushte të vështira, nuk kanë kontroll mbi asetet, dhe kanë akses të kufizuar në vegla dhe pajisje për përmirësimin e produktivitetit. Mungesa e të rinjve në blegtori, e përkeqësuar nga shifrat e larta të emigracionit, kufizojnë numrin e forcave të punës dhe kërcënojnë qëndrueshmërinë e zinxhirit të vlerës.

**Në lidhje me çështjet e pabarazisë gjinore dhe të përfshirjes së grave** në zinxhirin e vlerës, informacioni i marrë nga takimet dhe intervistat tregon se gratë janë të përfshira në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës, që nga kujdesi për bagëtitë dhe mjelja, deri tek transportimi i qumështit në baxho. Megjithatë, ato nuk kanë kontroll mbi asetet, dhe u mungojnë njohuritë për praktikat e mira të mbarështimit të bagëtive dhe, çka është më e rëndësishme, nuk kanë akses në vegla dhe pajisje që mund të lehtësojnë ngarkesën e punës dhe të shtojnë produktivitetin. Ato kanë aftësitë bazë, por mund ta zhvillojnë më tej ekspertizën e tyre përmes trajnimeve të posaçme dhe mbështetjes me pajisjet e nevojshme, që do t'i ndihmojnë të rrisin produktivitetin, të kenë më shumë kontroll mbi asetet, dhe njëkohësisht të lehtësojnë ngarkesën e punës së tyre. Gratë rrallë

përfshihen në proceset e vendimmarrjes, ku burrat (veçanërisht konsoliduesit të cilëve gratë u shesin produktet e tyre) janë autoriteti vendimmarrës për çmimet, proceset e menaxhimit të biznesit, mundësitë e financimit, etj. Gratë punojnë në kushte të vështira, nuk kanë kontroll mbi asetet, dhe kanë akses të kufizuar në vegla dhe pajisje për përmirësimin e produktivitetit. Mungesa e të rinjve në blegtori, e përkeqësuar nga shifrat e larta të migracionit, kufizojnë numrin e forcave të punës dhe kërcënojnë qëndrueshmërinë e zinxhirit të vlerës.

**Në lidhje me mundësitë e financimit,** për shumë familje, blegtoria është burimi kryesor i të ardhurave dhe fitimet merren pasi sasia e qumështit të mbledhur çohet në baxho. Megjithatë, fermerët e vegjël (me më pak se dhjetë gjedhë ose më pak se 100 ripërtypës të vegjël) kanë vështirësi të mëdha financiare. Këto vështirësi përkeqësohen nga përjashtimi i tyre prej skemës kombëtare të mbështetjes së bujqësisë për vitin 2025, që kufizon aksesin e tyre në burime financiare.

Përveç kësaj, zinxhiri i furnizimit të qumështit vazhdon të jetë në pjesën më të madhe informal, sidomos për sa i përket gjurmueshmërisë së qumështit dhe zbatimit të ligjit, që ndërlikon më tej mundësitë për akses në financim. Fermerët e vegjël, sidomos gratë, shpesh nuk kanë kontrata formale dhe sisteme transparente, që ua bën të vështirë të demonstrojnë qëndrueshmërinë e biznesit të tyre dhe të sigurojnë mbështetje financiare.

Mikrokredia përfaqëson një instrument të rëndësishëm financimi për fermerët e vegjël në Shqipëri, sidomos për ata që janë të përjashtuar nga sistemi bankar tradicional për shkak të aksesit të kufizuar në kolateral, mungesës së strukturave formale të biznesit, dhe riskut të lartë. Institucionet e mikrokredisë ofrojnë kredi të vogla që janë më të aksesueshme dhe shpesh nuk kanë kushte aq të rrepta sa kreditë që merren nga bankat tradicionale. Këto kredi mund t'i ndihmojnë fermerët e vegjël të investojnë në pajisje, të përmirësojnë infrastrukturën, ose të rrisin produktivitetin. Megjithatë, marrja e mikrokredive paraqet disa vështirësi për fermerët e vegjël në Shqipëri.

Ndonëse mikrokreditë janë të disponueshme për zonat rurale, aksesi në këto produkte financiare është ende i kufizuar, sidomos në zonat e thella ku fermerët mund të mos kenë dijeni për shërbimet e disponueshme, ose mund të kenë vështirësi të plotësojnë kriteret për marrjen e këtyre kredive. Institucionet e mikrokredisë mund të kenë norma interesi më të larta krahasuar me institucionet financiare tradicionale dhe mund të shtojnë ngarkesën financiare të fermerëve të vegjël, duke ua bërë më të vështirë që të shlyejnë kredinë. Shumë fermerë të vegjël, sidomos gratë, kanë njohuri të kufizuara për menaxhimin e financave, aplikimin për kredi, ose për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e marrjes së borxhit, që mund të çojë në vendime jo të mira dhe vështirësi në shlyerjen e mikrokredive.[60]

### Mundësitë për përmirësimin e aksesit në mikrokredi

- Ndërgjegjësimi për opsionet e disponueshme për mikrokredi dhe rritja e njohurive financiare mund t'i ndihmojë gratë dhe blegtorët që të kuptojnë më mirë dhe të kenë më shumë akses në këto burime. Dhënia e udhëzimeve se si të aplikohet për kredi, dhe si të menaxhohet pagimi i kësteve, do t'u mundësonte fermerëve që t'i përdorin mikrokreditë më me efikasitet.

- Krijimi i produkteve të posaçme të kreditit për nevojat të grave fermere (p.sh., kredi me normë interesi të ulët për blerjen e pajisjeve për mjelje ose për ndërtimin e objekteve për ruajtjen e qumështit) mund të pakësojë ngarkesën financiare dhe të përmirësojë produktivitetin.

- Mundësimi i programeve të marrjes së kredive në grup, ku gratë dhe fermerët e vegjël mund të aplikojnë bashkërisht për kredi si kooperativë, mund të pakësojë riskun dhe të përmirësojë aksesin në kredi.

- Forcimi i partneritetit midis institucioneve të mikrokredisë dhe i skemave mbështetëse shtetërore mund të shtojë aksesin në kredi dhe produkte të tjera financiare me normë interesi të ulët, duke u mundësuar fermerëve të vegjël, veçanërisht grave, që të investojnë në përmirësime afatgjata në veprimtarinë e tyre.

60. Udhëzues me ndjeshmëri gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

## 2.5 REKOMANDIME PËR ZINXHIRIN E VLERËS TË QUMËSHTIT

Plani i ndërhyrjes shtjellon një varg veprimesh që synojnë përmirësimin e zinxhirit të vlerës të qumështit/ bulmetit, ku vëmendje e veçantë i kushtohet rritjes së produktivitetit, cilësisë së produkteve, barazisë gjinore, aksesit në financim, dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të zinxhirit të vlerës.

### 1. Rritja e njohurive dhe forcimi i zbatimit të praktikave të mira blegtorale nga gratë në njësinë administrative të Muhurrit për të shtuar produktivitetin dhe për të siguruar cilësi më të mirë të produkteve të qumështit dhe bulmetit

- **Trajnim dhe ndërtim kapacitetesh:** Organizimi i seminareve të rregullta trajnimi për blegtorët, sidomos gratë blegtore, për përmirësimin e njohurive të tyre për praktikat e mira blegtorale. Këtu duhet të përfshihen tema si kujdesi për kafshët, higjiena e mjeljes dhe menaxhimi social-ekonomik. Duhet të ofrohen gjithashtu edhe trajnime të specializuara për mbarështimin e bagëtive, menaxhimin e mbetjeve dhe mirëqenien e kafshëve.

**Impakti:** Përmirësim i produktivitetit dhe produkte qumështi me cilësi më të lartë në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Programe pilot për praktikat e mira blegtorale:** Organizimi i programeve pilot në disa ferma të përzgjedhura të drejtuara nga gratë, ku të demonstrohen praktikat moderne. Këto ferma pilot mund të demonstrojnë gjithashtu edhe përdorimin e stallave moderne dhe të cisternave ftohëse, duke shërbyer si shembull për komunitetin më të gjerë.

**Impakti:** Demonstrim i suksesshëm i praktikave blegtorale dhe rritje e përdorimit të tyre në zonë me kalimin e kohës.

- **Mbështetje me pajisje dhe vegla:** Rritje e aksesit të grave në pajisje të nevojshme, si makineri për mjelje, kazanë ftohës, dhe bidonë higjienikë, përmes skemave të mikrokredisë, partneriteteve dhe granteve vendore. Gratë blegtore kanë nevojë të mbështeten me mjete pune bazë (si doreza dhe bidonë të përshtatshëm) për të ulur rrezikun e kontaminimit.

**Impakti:** Rritje e produktivitetit dhe cilësi ë e mirë e produkteve, me përfitime të vazhdueshme në periudhën afatgjatë.

### 2. Përmirësimi i infrastrukturës dhe sisteme të monitorimit të cilësisë për rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe cilësinë e produkteve

- **Mbështetje për krijimin e një laboratori analizash:** Është e nevojshme ngritja e një laboratori analizash në baxho për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së qumështit të papërpunuar përpara se të përpunohet, dhe për këtë duhet të trajnohen gratë që punojnë aty. Ky është hap kritik në ruajtjen e standardeve të qumështit dhe sigurimin e produkteve të cilësisë së lartë.

**Impakti:** Përmirësim i cilësisë dhe sigurisë së produkteve në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Krijimi i një sistemi për monitorimin e qumështit të papërpunuar:** Duhen bërë përmirësime në infrastrukturën e mbledhjes së qumështit të papërpunuar, sidomos në zonat malore. Duhet të zhvillohet një sistem i ri transporti për dorëzimin në kohë të qumështit në baxho.

**Impakti:** Cilësi dhe sasi më e lartë e qumështit, dhe ruajtje e tij në periudhën afatgjatë.

### 3. Përmirësim i aksesit të blegtorëve në burime financiare për të rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre

- **Promovimi i skemave financiare:** Duhet bërë punë me institucionet e mikrokredisë për dhënien e kredive me normë të ulët interesi për gratë dhe fermerët e vegjël, për t'i ndihmuar që të blejnë pajise dhe të përmirësojnë fermat e tyre. Po kështu, duhet të organizohen edhe trajnime për njohuri financiare për të siguruar që fermerët të kuptojnë si funksionon sistemi i mikrokredisë dhe aplikimet për kredi.

**Impakti:** Më shumë akses në financim, që çon në rritje të produktivitetit në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Të avokohet për përfshirje në skemën e mbështetjes për bujqësinë:** Do të bëhen përpjekje

për përfshirjen e fermerëve të vegjël sidomos të grave, në skemën kombëtare të mbështetjes në bujqësi për vitin 2025, për t'u dhënë atyre ndihmën e nevojshme financiare.

**Impakti:** Përmirësim i aksesit në financim dhe qëndrueshmërisë së fermerëve të vegjël, sidomos të grave, me përfitime afatgjata.

### 4. Fuqizimi i grave dhe forcimi i barazisë gjinore

- **Promovimi i rolit udhëheqës të grave në vendimmarrje:** Duhet të ndërmerren nisma për përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse, si në menaxhimin e fermave, ashtu edhe në menaxhimin e baxhove. Duhet të krijohen grupe të grave për të nxitur shkëmbimin e njohurive, vendimmarrje të përbashkët dhe investime të përbashkëta.

**Impakti:** Pjesëmarrje më e madhe e grave në vendimmarrje, që çon në praktika më gjithëpërfshirëse në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Zhvillimi i seancave të trajnimit vetëm për gratë:** Programe specifike për gratë, me fokus në teknikat e avancuara në blegtori/bujqësi, menaxhimin e aseteve, dhe sipërmarrjet. Këto seanca i pajisin gratë me aftësitë e nevojshme për të menaxhuar cilësinë e qumështit, financat dhe strategjitë e biznesit.

**Impakti**: Rritje e aftësive dhe e rolit drejtues të grave, që kontribuon në qëndrueshmërinë afatgjatë të bizneseve të tyre.

- **Mbështetje e aksesit të grave në vegla dhe pajisje pune:** Mbështetje e grave me vegla dhe pajisje, si makineri për mjelje dhe cisterna ftohëse, përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e ngarkesës së punës.

**Impakti:** Rritje e produktivitetit, efikasitetit dhe cilësisë së punës së grave në sektorin e blegtorisë.

### 5. Ndërtimi i kapaciteteve vendore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe të aftësisë për përballimin e situatave në blegtori

**Forcimi i shërbimeve të ekstensionit dhe rritja e bashkëpunimit me palët e interesit:** Duhet të forcohen shërbimet e ekstensionit bujqësor në zonë për t'u dhënë ndihmë në vijimësi blegtorëve, sidomos grave blegtore, dhe sidomos atyre në zona të thella. Duhet të organizohen vizita në terren, demonstrime dhe programe shkëmbimi për blegtorët, për të nxitur shkëmbimin e njohurive. Gjithashtu duhet të nxitet bashkëpunimi mes blegtorëve, baxhos, autoriteteve bujqësore dhe institucioneve financiare.

**Impakti:** Më shumë mbështetje dhe bashkëpunim që çon në rritje të qëndrueshme në sektorin e blegtorisë.

### 6. Forcimi i aftësisë përballuese të sfidave mjedisore dhe ulje e impaktit të blegtorisë në mjedis

- **Nxitja e praktikave blegtorale të qëndrueshme ndaj klimës:** Trajnime për vaditje me përdorim efikas të ujit, përmirësimin e menaxhimit të ushqimit për bagëtitë, dhe për kulturat bujqësore rezistente ndaj klimës, për t'i ndihmuar fermerët që t'u përshtaten ndryshimeve klimatike. Këto praktika ulin cenueshmërinë nga ndryshimet e motit dhe përmirësojnë qëndrueshmërinë afatgjatë.

**Impakti:** Rritje e qëndrueshmërisë ndaj klimës në praktikat bujqësore, me qëndrueshmëri afatmesme deri afatgjatë.

- **Nxitja e praktikave mjedisore të qëndrueshme:** Në ferma duhet të futen sistemet e menaxhimit të mbetjeve dhe të riciklimit, për të pakësuar ndotjen. Duhet të promovohen teknika bujqësore që mbrojnë mjedisin, përfshirë përdorimin e plehrave organike dhe ushqim organik për bagëtitë, për të reduktuar ndikimin në mjedis.

**Impakti:** Më pak dëm në mjedis nga blegtoria, që promovon qëndrueshmëri afatgjatë.

### 7. 7. Sigurimi i forcave të qëndrueshme të punës përmes trajtimit të migracionit dhe përmirësimit të kushteve të punës

- **Tërheqja e rinisë në blegtori:** Do të krijohen stimuj, si bursa, programe mentorimi dhe mundësi për zhvillimin e karrierës në bujqësi për të tërhequr të rinjtë në sektorin e blegtorisë. Fushatat ndërgjegjësuese gjithashtu theksojnë mundësitë që ekzistojnë në blegtori.

**Impakti:** Pjesëmarrje më e madhe e rinisë në blegtori, duke siguruar një forcë pune të qëndrueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Përmirësimi i kushteve të punës të grave:** Duhet të futen teknologji dhe praktika që kursejnë punën fizike dhe ngarkesën e grave, duke përmirësuar kushtet e punës së tyre. Gjithashtu, duhet të bëhen

përpjekje për të siguruar shpërblim të drejtë dhe më shumë të drejta për gratë në sektorin e blegtorisë.

**Impakti:** Përmirësim i kushteve të punës dhe praktika pune dhe praktika pune të drejta, nga të cilat përfitojnë veçanërisht gratë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Ky plan ndërhyrjesh përbën një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e problematikave në zinxhirin e vlerës të qumështit/bulmetit, ndërkohë që shfrytëzon anët e forta dhe mundësitë ekzistuese. Veprimtaritë e renditura synojnë të përmirësojnë produktivitetin, cilësinë, barazinë gjinore, aksesin në financim, qëndrueshmëri mjedisore dhe kushte pune. Secila veprimtari kontribuon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë e sektorit për të gjeneruar fitim, duke siguruar një të ardhme të qëndrueshme për blegtorinë në zonë.

**Tabela 9.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të qumështit

| Nr | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 1 | **Rritja e njohurive dhe forcimi i zbatimit të praktikave të mira blegtorale nga gratë në njësitë administrative për të shtuar produktivitetin dhe për të siguruar cilësi më të mirë të produkteve të qumështit dhe bulmetit.** | | | |
| 1.1 | Trajnim dhe ndërtim kapacitetesh<br>o Të organizohen seminare të rregullta trajnimi për blegtorët, sidomos gratë blegtore, për përmirësimin e njohurive të tyre për praktikat e mira blegtorale, që përfshijnë tema si kujdesi për kafshët, higjiena e mjeljes dhe menaxhimi social-ekonomik.<br>o Të ofrohen trajnime për teknika moderne të mjeljes dhe për rëndësinë e zbatimit të standardeve të higjienës në blegtori.<br>o Të ofrohen trajnime të specializuara për mbarështimin e bagëtive, menaxhimin e mbetjeve dhe mirëqenien e kafshëve. | X | X | X |
| 1.2 | Programe pilot për praktikat e mira blegtorale<br>o Të zbatohen programe pilot në ferma të përzgjedhura, ku fermerët mund të demonstrojnë praktika moderne dhe të shërbejnë si model për komunitetin.<br>o Të prezantohen stalla moderne dhe cisterna ftohëse në fermat pilot, për të demonstruar efektivitetin e tyre. | | | |
| 1.3 | Mbështetje me pajisje dhe vegla<br>o Të mbështetet aksesi në pajisje për mjelje, cisterna ftohëse dhe bidonë higjienikë përmes skemave të mikrokredisë, partneriteteve me bashkinë, projekteve dhe granteve lokale.<br>o Të mbështeten gratë blegtore me mjete bazë (si doreza, bidonë të përshtatshëm, etj.) për të pakësuar rrezikun e kontaminimit. | | | |
| 2 | Përmirësimi i infrastrukturës dhe krijimi i sistemeve të monitorimit të cilësisë për rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe cilësinë e produkteve | | | |
| 2.1 | Mbështetje për ngritjen e një laboratori analizash për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së qumështit të papërpunuar përpara përpunimit | X | X | X |
| 2.2 | Krijimi i sistemit për monitorimin e qumështit të papërpunuar<br>o Të përmirësohet infrastruktura e mbledhjes së qumështit, sidomos në zonat malore, për të siguruar më shumë akses dhe për të pakësuar prishjen e qumështit.<br>o Të mbështetet krijimi i një sistemi transporti për dorëzimin në kohë dhe në kushte higjienike të qumështit në baxho. | | X | X |

| N: | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 3 | **Përmirësim i aksesit të blegtorëve në burime financiare për të rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë** | | | |
| 3.1 | Promovimi i skemave financiare:<br>o Të punohet me institucionet e mikrokredisë për t'u ofruar fermerëve të vegjël produkte financiare që u përgjigjen nevojave të tyre, si kredi me interes të ulët për blerjen e pajisjeve dhe për përmirësimin e fermave të tyre.<br>o Të organizohen edhe trajnime financiare për të siguruar që fermerët të kuptojnë si funksionon sistemi i mikrokredisë, aplikimet për kredi, dhe planet për shlyerjen e kredisë. | X | X | X |
| 3.2 | Të avokohet për përfshirjen e blegtorëve të vegjël, sidomos të grave blegtore, në skemën e mbështetjes për bujqësinë, për t'i ndihmuar që të kenë akses në ndihmën financiare të nevojshme | | X | X |
| 4 | **Fuqizimi i grave dhe forcimi i barazisë gjinore** | | | |
| 4.1 | Promovimi i rolit udhëheqës të grave në vendimmarrje<br>o Të mundësohet përfshirja e grave në proceset e vendimmarrjes, si në menaxhimin e fermave, ashtu edhe në menaxhimin e baxhove.<br>o Të krijohen grupe të grave për të nxitur shkëmbimin e njohurive, vendimmarrje dhe investime të përbashkëta. | | X | X |
| 4.2 | o Të zhvillohen seanca trajnimi vetëm për gratë mbi teknikat e avancuara në blegtori/bujqësi, menaxhimin e aseteve, dhe sipërmarrjen.<br>o Të pajisen gratë me aftësitë për menaxhimin e cilësisë së qumështit, financave strategjive të biznesit. | | X | X |
| 4.3 | Mbështetje e aksesit të grave në vegla dhe pajisje<br>o Të sigurohet që gratë të kenë akses në veglat dhe pajisjet që u duhen për përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e ngarkesës së punës, si makineri për mjelje, bidonë të përshtatshëm dhe cisterna ftohëse. | X | X | X |
| 5 | **Ndërtimi i kapacitetve vendore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe të aftësisë për përballimin e situatave në blegtori** | | | |
| 5.1 | Forcimi i shërbimeve të ekstensionit dhe rritja e bashkëpunimit me palët e interesit<br>o Të forcohet infrastruktura e shërbimeve të ekstensionit në zonë për t'u dhënë ndihmë dhe këshilla në vijimësi blegtorëve, sidomos në zonat e thella.<br>o Të organizohen vizita të rregullta në terren, demonstrime dhe programe shkëmbimi për blegtorët, për të nxitur shkëmbimin e njohurive.<br>o të nxitet bashkëpunimi mes blegtorëve, baxhos, autoriteteve bujqësore dhe institucioneve financiare për të siguruar sukses dhe qëndrueshmëri afatgjatë.<br>o Të avokohet për qeverisje më të mirë në sistemin e furnizimit me qumësht për të forcuar gjurmueshmërinë dhe kontrollin e cilësisë. | X | X | X |
| 6 | Forcimi i aftësisë përballuese të sfidave mjedisore dhe ulje e impaktit të blegtorisë në mjedis | | | |
| 6.1 | Nxitja e praktikave blegtorale të qëndrueshme ndaj klimës<br>o Të prezantohen praktika që ndihmojnë fermerët t'u përshtaten ndryshimeve klimatike, si vaditje me përdorim efikas të ujit, përmirësimin e menaxhimit të ushqimit për bagëtitë, dhe kultura bujqësore rezistente ndaj klimës.<br>o Të ofrohet trajnim mbi teknikat e qëndrueshme bujqësore për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike në kultivimin e foragjereve. | | X | X |

| N: | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 6.2 | Nxitja e praktikave mjedisore të qëndrueshme<br>o Të mbështetet ngritja e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe të riciklimit në fermë, për pakësimin e ndotjeve.<br>o Të nxitet përdorimi i plehrave dhe ushqimit organik dhe të qëndrueshëm të bagëtive për të reduktuar ndikimet në mjedis. | | X | X |
| 7 | Sigurimi i forcave të qëndrueshme të punës përmes trajtimit të çështjeve e migracionit dhe përmirësimit të kushteve të punës | | | |
| 7.1 | Tërheqja e rinisë në blegtori<br>o të krijohen stimuj, si bursa, programe mentorimi dhe mundësi për zhvillimin e karrierës në bujqësi për të tërhequr të rinjtë në sektorin e blegtorisë.<br>o Të promovohet sektori i blegtorisë si një mundësi për karrierë për të rinjtë dhe të rejat, përmes organizimit të fushatave ndërgjegjësuese për mundësitë në blegtori. | | X | X |
| 7.2 | Përmirësimi i kushteve të punës të grave:<br>o Të zbatohen teknologji dhe praktika që kursejnë punën fizike, sidomos për gratë, për të ulur ngarkesën e punës së tyre dhe për të përmirësuar kushtet e punës.<br>o Të avokohet për më shumë të drejta dhe shpërblim të drejtë për gratë që punojnë në sektorin e blegtorisë. | | X | X |

**Partnerët/bashkëpunimi në nivel vendor:** bashkia, drejtoria e bujqësisë, baxhoja lokale, shoqatat e blegtorëve. Plani i ndërhyrjes synon të trajtojë problemet e ndryshme me të cilat përballen fermerët e vegjël në NJA Muhurr, duke shfrytëzuar në të njëjtën kohë anët e forta dhe mundësitë ekzistuese. Duke u fokusuar në përmirësimin e praktikave bujqësore/blegtorale, infrastrukturë, akses në financim, barazi gjinore dhe qëndrueshmëri mjedisore, plani synon të krijojë një sektor blegtoral dhe të nënprodukteve të qumështit të qëndrueshëm dhe fitimprurës. Përfshirja e të gjithë gupeve të interesit, përfshirë gratë, të rinjtë dhe institucionet vendore, do të jetë kyç për garantimin e suksesit afatgjatë të kësaj ndërhyrjeje.

Pjesa 4
**Shtojcat**

# Shtojca 1. Bashkia Dibër: Informacion i përgjithshëm

Bashkia Dibër ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë dhe kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut në lindje. Bashkia ka një sipërfaqe prej rreth 1.822 kilometra katrorë, që e bën atë një prej rretheve më të mëdha në Shqipëri.

Ky territor karakterizohet nga një topografi e shumëllojshme; përmes tij kalon lumi Drini i Zi. Bashkia rrethohet nga vargmali Korab-Deshat, që është më i larti në Shqipëri, si dhe vargmali Lurë-Selishtë. Këto vargmale janë pjesë e disa parqeve natyrore të rëndësishme: Parku Natyror Korab-Korritnik dhe Parku Natyror i Lurës. Kjo zonë njihet për bukuritë e tij natyrore, me 23 liqene akullnajore. Rreth 90% e territorit është zonë rurale e përbërë nga 141 fshatra, ndërsa pjesa tjetër, prej 10%, është zonë urbane e përqendruar rreth qytetit të Peshkopisë, që është qendra administrative e bashkisë.

Bashkia Dibër përbëhet nga 15 njësi administrative: Peshkopia, Tomini, Melani, Kastrioti, Lura, Maqellara, Muhurri, Luznia, Selishta, Sllova, Kalaja e Dodës, Zall-Dardha, Zall-Reçi, Fushë Çidhëni, dhe Arrasi. Popullsia e Bashkisë Dibër në vitin 2023 ishte 50.775 banorë, me një shpërndarje gati të barabartë të meshkujve (25.547) dhe femrave (25.228).

**Figure 4.** Bashkia Dibër




Ekonomia e Dibrës mbizotërohet nga Bujqësia, me toka pjellore në luginën e Drinit të Zi ku kultivohen drithëra, perime dhe fruta. Blegtoria është gjithashtu sektor thelbësor i ekonomisë lokale dhe ripërtypësit e vegjël janë të zakonshëm në zonë. Rajoni njihet gjithashtu edhe për burimet natyrore, si pyjet dhe produktet jodrunore të pyllit.

Qendra urbane e Dibrës ndodhet në Peshkopi, e cila shërben si qendër ekonomike dhe administrative. Ndërsa në zonën urbane ekziston infrastruktura bazë si rrugë, shkolla, dhe institucione shëndetësore, popullsia e zonës rurale – që përbën 90% të bashkisë – ka vështirësi për të pasur akses në shërbime dhe infrastrukturë të përparuar. Dibra ka një trashëgimi të pasur kulturore, e ndikuar nga elemente tradicionale, sepse ajo ka qenë historikisht në udhëkryqet e qytetërimeve të ndryshme. Bashkia njihet për folklorin, muzikën tradicionale, dhe festivalet e saj. Në peizazhin arkitektonik të zonës janë karakteristike shtëpitë e vjetra prej guri, disa prej të cilave janë shekullore.
Mjedisi natyror i Dibrës është me rëndësi të veçantë. Në bashki ka shumë zona të mbrojtura, ndër të cilat vargmalet Korab-Deshat dhe Lurë-Selishtë, që janë pjesë e nismave më të gjera konservuese në Shqipëri. Këto rajone ofrojnë habitate për shumë specie indigjene dhe kontribuojnë në angazhimin e bashkisë për ruajtjen e mjedisit.

## Popullsia

Grupi më i madh i popullsisë përbëhet nga grupmosha 20-24 vjeç, me një total prej 3.941 personash, nga të cilët 1.819 janë meshkuj dhe 2.122 janë femra. Grupmosha me numrin më të vogël është ajo e moshës 85 vjeç e lart, me vetëm 514 persona, nga të cilët 222 janë meshkuj dhe 292 janë femra.

Në pjesën më të madhe të grupmoshave numri i femrave është më i madh se i meshkujve, veçanërisht në grupmoshat më të reja dhe më të vjetra. Për shembull, në grupmoshën 20-24 vjeç, numri i femrave është ndjeshëm më i madh (2.122) sesa i meshkujve (1.819). Kjo tendencë shihet edhe në grupmoshat më të rritura, ku popullsia femërore është më e madhe se ajo mashkullore, veçanërisht në grupmoshat mbi 75 vjeç.
Numri i banorëve në grupmoshën 0-34 vjeç përbën një pjesë të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të popullsisë, ku grupin më të madh e përbëjnë personat me moshë 20-24 vjeç. Kjo tregon për një popullatë të re dhe potencialisht ekonomikisht aktive, që është me rëndësi vitale për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e fuqisë punëtore në të ardhmen.
Numri i të moshuarve (65+) është i konsiderueshëm, me 2.880 persona në grupmoshën 65-69 dhe 3.877 persona në grupmoshën 60-64. Numri i individëve të moshuar rritet në grupmoshat më të larta, ndërsa në grupmoshën 85+ janë 514 persona.

**Figura 5.** Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë




Burimi: INSTAT 2024.

Të dhënat në vijim ofrojnë informacion për strukturën familjare dhe organizimin e familjeve në Bashkinë Dibër në vitin 2023.

Çifte të martuara (21.842): Shumica e njësive familjare në Dibër përbëhen nga çifte të martuara. Ndërhyrjet me ndjeshmëri gjinore mund të përqendrohen në sigurimin e aksesit të barabartë në burime, të drejta dhe shërbime si për bashkëshortët ashtu edhe për bashkëshortet në këto familje.

Partnerë që bashkëjetojnë (104): Një numër relativisht i vogël çiftesh jetojnë në bashkëjetesë pa martesë zyrtare. Ky grup mund të hasë vështirësi që lidhen me njohjen ligjore, veçanërisht sa i përket trashëgimisë, mbrojtjes sociale, aksesit në asistencë sociale. Politikat mund të synojnë përmirësimin e të drejtave ligjore dhe njohjen e çifteve që bashkëjetojnë.

Fëmijë që jetojnë me prindër të martuar (13.779): Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve në Dibër jetojnë në struktura tradicionale familjare, me prindër të martuar. Mbështetja me ndjeshmëri gjinore në këto familje mund të përqendrohet në informacione për prindërimin, arsimin, dhe nxitjen e barazisë gjinore në rolet e përkujdesjes.

Fëmijë që jetojnë me prindër të pamartuar (56): Numri i fëmijëve në familje ku prindërit nuk janë të martuar është relativisht i ulët; sidoqoftë ai mund të jetë tregues i nevojës për politika që ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje shtesë për fëmijët dhe prindërit që në familje jotradicionale.

Baballarë të vetëm (136) dhe nëna të vetme (772): Familjet me një prind, veçanërisht ato me kryefamiljare gra, shpesh kanë vështirësi që lidhen me qëndrueshmërinë financiare, mbështetjen sociale dhe aksesin në shërbime. Politikat me ndjeshmëri gjinore duhet të përqendrohen në ofrimin e një mbështetjeje të fokusuar, si ndihma financiare, shërbime të përkujdesit për fëmijët dhe mundësi punësimi për prindërit e vetëm.

Fëmijët që jetojnë me një prind (1.481): Ka një numër të madh fëmijësh që jetojnë me njërin prind, zakonisht me nënën. Këta fëmijë mund të kenë nevojë për shërbime sociale shtesë, si mbështetje për shkollim, kujdes shëndetësor dhe mirëqenie emocionale.

Të dhënat tregojnë për një numër të konsiderueshëm nënash të vetme që mund të përfitojnë nga mekanizma mbështetës shtesë në Bashkinë Dibër, si asistencë financiare, strehim dhe përkujdes për fëmijët.

**Tabela 10.** Popullsia sipas statusit familjar, 2023

| Popullsia totale | 50,775 |
|---|---|
| Anëtarë të familjeve | 38,170 |
| Çifte të martuara | 21,842 |
| Partnerë që bashkëjetojnë | 104 |
| Fëmijë që jetojnë me prindër të martuar | 13,779 |
| Fëmijë që jetojnë me prindër të pamartuar | 56 |
| Baba i vetëm | 136 |
| Nënë e vetme | 772 |
| Fëmijë që jetojnë me një prind | 1,481 |

Burimi: INSTAT 2024.

Përqendrimi më i lartë i anëtarëve të familjeve është në Peshkopi (14.710), qendra urbane e bashkisë, ndërsa njësi më të vogla si Lura (501) dhe Zall Reçi (335) kanë më pak anëtarë.

**Tabela 11.** Numri i anëtarëve të familjes, 2023

| Njësia administrative | Numri i anëtarëve të familjes |
|---|---|
| **Totali** | **50,775** |
| Zall Reç | 335 |
| Zall Dardhë | 419 |
| Lurë | 501 |
| Selishtë | 847 |
| Kala e Dodës | 1.045 |
| Fushë Muhur | 1.652 |
| Sllovë | 1.761 |
| Luzni | 1.811 |
| Arras | 1.866 |
| Fushë Çidhën | 2.378 |
| Melan | 2.992 |
| Kastriot | 5.222 |
| Qendër Tomin | 6.531 |
| Maqellarë | 8.705 |

Burimi: Bashkia Dibër, 2024.

## Infrastruktura: Toka, Uji, Energjia Elektrike, Jeta Sociale

Bashkia Dibër shtrihet në një sipërfaqe totale prej 93.787,60 hektarësh (ha), ku përfshihen kategori të ndryshme të përdorimit të tokës dhe burimeve natyrore. Shpërndarja e tokës është si më poshtë:

**Tabela 12.** Shpërndarja e tokës

| Kategoria e tokës | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|
| **Total zonë urbane** | **2,00 ha** |
| Tokë bujqësore | 15.639 ha |
| Territor natyror | 74.389 ha |
| Trupa ujorë | 532 ha |
| Zonë infrastrukturore | 1.211 ha |
| Zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore | 26.637 ha |

Burimi: Plani i zhvillimit territorial.[61]

61. Plani i zhvillimit të territorit, Plani i përgjithshëm vendor, Dibër, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/plani-strategjik-i-zhvillimit-te-bashkise/

Të dhënat tregojnë se në peizazhin e territorit të Dibrës mbizotërojnë zonat natyrore, që përbëjnë rreth 79% të të gjithë zonës (74.389 ha). Kjo pasqyron biodiversitetin e pasur të rajonit, pyjet natyrore dhe terrenin malor, me rol kritik në mbështetjen e shërbimeve të ekosistemit, të turizmit dhe jetesën e banorëve të zonës. Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore (26.637 ha) përbëjnë një pjesë të rëndësishme të territorit, që tregojnë për angazhimin e rajonit për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.Toka bujqësore përbën 16,6% të të gjithë sipërfaqes (15.639 ha) dhe ka rëndësi jetësore për ekonominë lokale sepse mbështet kultivimin e kulturave bujqësore, blegtorinë dhe jetesën në zonat rurale. Zona urbane e Dibrës është veçanërisht e vogël, vetëm 2 ha, që tregon se zhvillimi urban është minimal krahasuar me përmasat e përgjithshme të rajonit. Sipërfaqja e zënë me infrastrukturë (1.211 ha) përbëhet nga rrjete rrugore, shërbime publike dhe shërbime të rëndësishme transporti, logjistikë dhe mirëqenien e komunitetit.

## Shërbimet Komunale: Furnizimi me Ujë dhe Energji Elektrike

Në zonat rurale të Dibrës banorët përballen me probleme të furnizimit me ujë, veçanërisht kur bën mot i keq. Organet e pushtetit vendor kanë ndërmarrë hapa për të menaxhuar dhe përmirësuar sistemin e furnizimit me ujë dhe sistemin e ujërave të zeza në fshatrat e Dibrës, për t'u siguruar banorëve akses më të sigurt në ujë të pijshëm. Shqipëria varet gati plotësisht nga hidrocentralet për nevojat për energji elektrike. Në Dibër, hidrocentrali i Gjoricës kontribuon në prodhimin lokal të energjisë. Ky hidrocentral, i ndërtuar në vitet 2014-2015, ishte projekt i *ATB Riva Calzoni Rinnovabili*.[62]

**Tabela 13.** Njësitë e banimit dhe sistemet e furnizimit me ujë, 2023

| Kategoria | Njësitë e banimit | Njësitë ekonomike familjare (NjEF) |
|---|---|---|
| Totali | 10,074 | 10,455 |
| Rrjeti i furnizimit me ujë (brenda shtëpisë) | 8,180 | 8,483 |
| Rrjeti i furnizimit me ujë (jashtë shtëpisë por brenda ndërtesës) | 901 | 941 |
| Rrjeti i furnizimit me ujë (jashtë ndërtesës) | 579 | 607 |
| Sistem tjetër i furnizimit me ujë | 284 | 287 |
| Pa sistem furnizimi me ujë | 130 | 137 |

Burimi: INSTAT, 2024

Dibra ka 10.074 njësi banimi të banuara dhe 10.455 njësi ekonomike familjare. Disponueshmëria e sistemeve të furnizimit me ujë ndikon drejtpërdrejt në përdorimin e kohës nga gratë, shëndetin e tyre dhe mundësinë për arsimim, punësim dhe angazhim në komunitet. Rreth 81,2% e njësive të banimit (8.180 nga 10.074) dhe 81,1% e njësive ekonomike familjare (8.483 nga 10.455) kanë ujë brenda shtëpisë.Sa u përket familjeve që e kanë ujin jashtë shtëpisë, por brenda ndërtesës, 8,9% e njësive të banimit (901 nga 10.074 familje) dhe 9% e njësive ekonomike familjare (941 nga 10.455 familje) kanë ndërprerje të kufizuara por të menaxhueshme. Kurse në 5,7% të njësive të banimit (579 nga 10.074) dhe 5,8% të njësive ekonomike familjare (607 nga 10.455) që e furnizohen me ujë jashtë ndërtesës, ndikimi mbi veprimtaritë e përditshme të grave është më i konsiderueshëm. Familjet që kanë sisteme të tjera furnizimi me ujë, si puset apo mbledhja e ujërave të shiut, përbëjnë 2,8% të njësive të banimit (284 nga 10.074) dhe 2,7% të njësive ekonomike familjare (287 nga 10.455). Këto sisteme janë më pak të sigurta dhe gjatë periudhave të thatësirës nevoja e për të siguruar ujin shpesh shton punën e papaguar të grave dhe vajzave. Familjet më të cenueshme në Dibër jetojnë në 1,3% e njësive të banimit (130 nga 10.074) dhe 1,3% e njësive ekonomike familjare (137 nga 10.455) që nuk kanë asnjë sistem furnizimi me ujë. Gratë dhe vajzat në këto familje detyrohen shpesh të bëjnë distanca të gjata në këmbë për të marrë ujë.

62. Strategjia e zhvillimit të territorit, Bashkia Dibër. http://dibra.gov.al/wp-content/uploads/2019/10/Plani-i-Zhvillimit_PPV-Diber.pdf

## Infrastruktura Publike dhe Jeta Sociale

Planimetria urbane e Dibrës krijon vështirësi të konsiderueshme për angazhim social, veçanërisht për gratë. Në zonë mungojnë hapësirat dhe mjediset kulturore me përdorim të përbashkët, ku gratë mund të mblidhen, të krijojnë lidhje dhe rrjete, dhe të marrin pjesë në jetën publike. Kjo mungesë kufizon mundësitë për ndërveprim social, angazhim në komunitet dhe akses në shërbimet mbështetëse.

Hapësirat publike të pamirëmbajtura, ndriçimi i pamjaftueshëm dhe rrugët e rrugicat jo të sigurta, kufizojnë më tej aftësinë e grave për të lëvizur lirisht dhe të sigurta në komunitetet e tyre, gjë që ndikon në mundësitë e lëvizjes dhe veprimtaritë e tyre të përditshme. Në zonat rurale, problemi është edhe më i theksuar, ku gratë përjetojnë izolim social më të madh dhe akses të kufizuar në shërbime bazë, që përkeqëson cenueshmërinë ekonomike dhe kufizon rolin e tyre në proceset e vendimmarrjes në komunitetet e tyre.

## Shërbimet Sociale dhe Ndihma Ekonomike

Ofrimi i shërbimeve sociale në Dibër synon kryesisht mbështetjen e familjeve në nevojë, promovimin e mirëqenies së fëmijëve, përmirësimin e cilësisë së jetës për grupet e rrezikuara të popullsisë. Ndër shërbimet kyçe përfshihen ndihma në përkujdesin për fëmijët, aksesi në arsim, shërbimet shëndetësore dhe programet e mirëqenies sociale.

**Figura 6.** Familjet që përfitojnë asistencë ekonomike.




Burimi: MTBP 2022-2024, Bashkia Dibër.

Të dhënat tregojnë për një rritje të qëndrueshme të numrit të familjeve që marrin ndihmë ekonomike në rajonin e Dibrës.

**Tabela 14.** Kërkesa për strehim social

| Bashkia | Numri i familjeve të pastreha | Numri mesatar i anëtarëve për familje | Gjithsej banorë të pastrehë (n) | % e banorëve të pastrehë |
|---|---|---|---|---|
| Dibër (fillestare) | 750 | 5,08 | 3.810 | 6,18% |
| Dibër (e ponderuar) | 715 | 5,08 | 3.632 | 5,89% |
| **Totali** | **1,465** | **5,08** | **7.442** | **12,07%** |

Burimi: Bashkia Dibër

Sipas të dhënave, në vitin 2023, në Bashkinë Dibër kishte 2.568 me aftësi të kufizuara. Ata kanë aftësi të kufizuara të ndryshme, si në shikim, dëgjim, ecje, kujtesë, kujdesin e përditshëm për veten dhe komunikim. Më poshtë jepen të dhëna të detajuara sipas aftësisë së kufizuar:

**Tabela 15.** Personat me aftësi të kufizuara sipas gjinisë

| Kategoria | Totali (Dibër) | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| **Totali i personave me aftësi të kufizuara** | **2.568** | **1.207** | **1.361** |
| Me aftësi të kufizuara në shikim | 863 | 384 | 479 |
| Me aftësi të kufizuara në dëgjim | 740 | 353 | 387 |
| Me aftësi të kufizuara në ecje | 1.653 | 734 | 919 |
| Me aftësi të kufizuara në kujtesë | 779 | 361 | 418 |
| Vështirësi në kujdesin e përditshëm për veten | 809 | 401 | 408 |
| Vështirësi në komunikim | 630 | 296 | 334 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2022, në bashki u paraqitën dhjetë kërkesa për përfaqësim si palë e tretë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër lidhur me padi për urdhra mbrojtës.[63]

## Arsimi

Për sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, Dibra ka nivel relativisht të lartë regjistrimi, ndonëse përqindjet e përfundimit të shkollës në nivelet më të larta, si ai pas shkollës së mesme, tregojnë se ka vend për përmirësim. Megjithëse arsimi ka rol kyç në zhvillimin socio-ekonomik të rajonit, pabarazitë gjinore në arritjet arsimore vazhdojnë dhe, në disa zona të caktuara, numri i vajzave që përfundojnë arsimin e lartë është më i madh krahasuar me meshkujt. Tabela e mëposhtme paraqet një ndarje të hollësishme të arritjeve arsimore dhe të strukturës së frekuentimit të shkollës në Dibër në vitin 2023, që ofron informacion për gjendjen aktuale të arsimit në bashki dhe ndihmon për identifikimin e fushave ku mund të nevojiten ndërhyrje të fokusuara me politika.

**Tabela 16.** Arritjet në arsim sipas gjinisë, 2023

| Niveli arsimor | Totali | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| **Totali** | **41.538** | **20.762** | **20.776** |
| Nuk ka përfunduar asnjë nivel arsimor | 210 | 77 | 133 |
| Arsim fillor | 2.518 | 1.088 | 1.430 |
| Shkolla 7/8/9-vjeçare | 20.185 | 9.756 | 10.429 |
| Shkolla e ulët teknike | 92 | 74 | 18 |
| Arsim i mesëm | 11.285 | 6.659 | 4.626 |
| Pas arsimit të mesëm por jo më tej | 267 | 141 | 126 |
| Arsim i lartë i shkurtuar | 516 | 276 | 240 |
| Diplomë universitare | 2.221 | 866 | 1.355 |
| Master ose Doktoraturë | 2.709 | 1.144 | 1.565 |
| Nuk ka frekuentuar asnjëherë shkollën | 1.535 | 681 | 854 |

Burimi: INSTAT 2024.

63. Bashkia Dibër, Sektori i shërbimeve sociale.

Ndonëse në ndjekjen e shkollës dhe arritjet arsimore përgjithësisht ka barazi gjinore, vihen re tendenca të dallueshme specifike gjinore: Vajzat kanë pak më shumë gjasë të kenë përfunduar arsimin fillor (1.430 femra kundrejt 1.088 meshkuj), dhe numri i tyre është më i lartë edhe në përfundimin e arsimit të lartë, veçanërisht në nivelet Master dhe Doktoraturë. Meshkujt kanë tendencë pak më të lartë të përfundojnë arsimin e mesëm dhe 7/8/9-vjeçar, që tregon se mund të nevojiten më shumë ndërhyrje për meshkujt në lidhje me nivelet e arsimit të lartë.

2.518 persona kanë përfunduar arsimin fillor, me një numër më të lartë femrash (1.430) krahasuar me meshkujt (1.088).

11.285 persona kanë përfunduar arsimin e mesëm, me më shumë meshkuj (6.659) sesa femra (4.626).
5.446 persona janë me arsim të lartë – me diplomë universitare, Master dhe Doktoraturë. Numri i meshkujve (2.286) e kalon fare pak atë të femrave (2.160) në këtë kategori. Diplomat e niveleve Master dhe Doktoraturë janë më të zakonshme tek femrat (1.565) krahasuar me meshkujt (1.144).

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve (1.535 persona) nuk kanë frekuentuar asnjëherë shkollën, dhe numri i femrave (854) është pak më i lartë se i meshkujve (681). Kjo mund të jetë tregues se për vështirësi potenciale të këtyre personave për të pasur akses në arsim, veçanërisht në zonat rurale.

**Tabela 17.** Numri i çerdheve dhe kopshteve

| Numri i çerdheve | Numri i kopshteve | Numri i edukatoreve |
|---|---|---|
| 3 (në Peshkopi) | 74 | 267 |

Burimi: Bashkia Dibër

Numri i kopshteve dhe edukatoreve në zonën e Dibrës, veçanërisht prania e çerdheve në Peshkopi, tregon për shërbime të disponueshme të arsimit parashkollor, me 267 edukatore në 74 kopshte. Bashkia Dibër ka 96 shkolla 9-vjeçare (vetëm 1 shkollë private) dhe 9 shkolla të mesme.

**Tabela 18.** Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas gjinisë

| Totali (F+M) | Femra | Meshkuj | Totali (%) (F+M) | Femra (%) | Meshkuj (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| 8.866 | 4.031 | 4.835 | 99,2% | 99,3% | 99,1% |

Burimi: Bashkia Dibër

Për sa i përket përfundimit të arsimit fillor në vitin akademik 2015-2016, Dibra kishte një nivel mbresëlënës të përfundimit të arsimit fillor, me 99,2% si për djemtë ashtu edhe për vajzat, me një dallim fare të vogël gjinor. Vajzat (99,3%) kishin një nivel përfundimi pak më të lartë se djemtë (99.1%), që flet për ekzistencën e barazisë gjinore në akses në arsim dhe arritje shkollore, që thekson rezultatet pozitive në garantimin e përfundimit të arsimit fillor si nga djemtë, ashtu edhe nga vajzat.

## Shëndetësia

Sistemi shëndetësor në Dibër përbëhet kryesisht nga shërbimet e kujdesit parësor dhe infermierët e mjekët përbëjnë shtyllën e kujdesit shëndetësor si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale.

**Tabela 19.** Treguesit e shëndetit

| Bashkia/NJA | Infermierë (nr.) | % infermierë për numër banorësh | Mjekë (nr.) | % mjekë për numër banorësh |
|---|---|---|---|---|
| Peshkopi | 29 | 0.15% | 6 | 0.03% |
| Arras | 14 | 0.37% | 1 | 0.03% |
| Fushë Çidhën | 10 | 0.28% | 1 | 0.03% |
| Fushë Muhurr | 13 | 0.38% | 1 | 0.03% |
| Kala e Dodës | 9 | 0.30% | 1 | 0.03% |
| Kastriot | 20 | 0.27% | 2 | 0.03% |
| Lurë | 8 | 0.54% | 1 | 0.07% |
| Luzni | 9 | 0.28% | 1 | 0.03% |
| Maqellarë | 42 | 0.31% | 3 | 0.02% |
| Melan | 19 | 0.43% | 1 | 0.02% |
| Tomin | 29 | 0.34% | 3 | 0.04% |
| Selishtë | 8 | 0.41% | 1 | 0.05% |
| Sllovë | 14 | 0.45% | 1 | 0.03% |
| Zall Dardhë–Zall Rec | 13 | 0.54% | 2 | 0.08% |
| Dibër | 237 | 0.30% | 25 | 0.03% |

Burimi: Bashkia Dibër, 2022.

Të dhënat pasqyrojnë një shpërndarje të ndryshme të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Bashkinë Dibër dhe njësitë administrative. Raporti i përgjithshëm i infermierëve (0,30%) dhe mjekëve (0,03%) për numër banorësh në zonë është relativisht i ulët, që sugjeron për vështirësi potenciale për të pasur akses në kujdes shëndetësor, veçanërisht në komunat në zonat më të thella.

## Konteksti Shoqëror Ekonomik

Dibra ka një ekonomi të diversifikuar dhe në zhvillim, e karakterizuar nga veprimtaritë bujqësore, industriale dhe ato të orientuara nga shërbimet. Në qendër të strukturës ekonomike të zonës janë kryesisht bujqësia dhe shërbimet, me përqendrim të konsiderueshëm të njësive ekonomike në sektorët e tregtisë, akomodimit dhe shërbimeve ushqimore. Bujqësia mbetet bosht qendror i ekonomisë, por edhe zhvillimi industrial dhe sektori i shërbimeve janë bërë më të spikatur vitet e fundit. Me gjithë varësinë e zonës nga sektorët tradicionalë, ka një tendencë në rritje drejt bizneseve dhe ndërmarrjeve të vogla, veçanërisht në sektorët e tregtisë me pakicë dhe mikpritjes. Megjithatë, ekonomia ende përballet me sfida, si aksesi i kufizuar në kapital, kufizimet në infrastrukturë, dhe pabarazitë gjinore në sektorë të ndryshëm.[64]

## Bizneset Aktive

Skena e biznesit në Bashkinë e Dibrës përbëhet nga biznese të shumëllojshme, që nga prodhuesit e të mirave deri tek ofruesit e shërbimeve. Sektori i prodhimit të të mirave, që përfshin industrinë prodhuese, bujqësinë dhe ndërtimin, ka pësuar rritje të ndjeshme duke kontribuar ndjeshëm në prodhimin ekonomik të zonës.

64. *USAID PLGP "GSVCA Dibër"* (Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës në Dibër, Projekti PLGP i USAID), 2019.

**Tabela 20.** Bizneset aktive, vitet nga 2020 në 2023

| Viti | Totali i bizneseve | Prodhues të të mirave | Prodhues të shërbimeve |
|---|---|---|---|
| 2020 | 960 | 141 | 819 |
| 2021 | 955 | 129 | 826 |
| 2022 | 967 | 132 | 835 |
| 2023 | 990 | 147 | 843 |

Burimi: INSTAT 2024.

Numri i prodhuesve të të mirave pësoi rënie me 8,5% në vitin 2021, u rrit me 2,3% në vitin 2022, dhe pati një rritje të madhe me 11,4%, në vitin 2023, me rritje të konsiderueshme në sektorin e prodhimit të të mirave, veçanërisht vitin e kaluar. Numri i prodhuesve të shërbimeve u rrit në masë modeste, me 0,9% në vitin 2021, 1,1% në vitin 2022, dhe 1,0% në vitin 2023, që flet për një rritje të qëndrueshme, por më të ulët krahasuar me sektorin e prodhimit të mallrave.

**Tabela 21.** Bizneset aktive sipas gjinisë

| Viti | Totali i bizne-seve | Biznese të burrave | Biznese të grave | % Ndryshimi Total | % Ndryshimi meshkuj | % Ndryshimi femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2020 | 960 | 747 | 213 | - | - | - |
| 2021 | 955 | 738 | 217 | -0.5% | -1.2% | 1.9% |
| 2022 | 967 | 747 | 220 | 1.3% | 1.2% | 1.4% |
| 2023 | 990 | 756 | 234 | 2.4% | 1.2% | 6.4% |

Burimi: INSTAT 2024.

Numri i bizneseve të burrave ra pak në vitin 2021, me -1,2%, mbeti i qëndrueshëm në vitin 2022 (asnjë ndryshim), dhe u rrit me 1,2% në vitin 2023. Me gjithë luhatjet, bizneset e burrave vazhduan të përbënin shumicën e bizneseve gjatë gjithë kësaj periudhe.

Bizneset e grave kanë treguar rritje të qëndrueshme, me 1,9% në vitin 2021, 1,4% në vitin 2022, dhe 6,4% në vitin 2023, që flet për një tendencë pozitive dhe përfshirje gjithnjë e më të madhe të grave në biznes. Rritja më e madhe në bizneset e grave u shënua në vitin 2023, që flet për një zhvillim inkurajues.

**Tabela 22.** Numri i bizneseve të regjistruara sipas njësisë administrative dhe madhësisë

| Njësia administrative | Ndërmarrjet | Bizneset e vogla |
|---|---|---|
| Peshkopi | 56 | 580 |
| Maqellarë | 16 | 136 |
| Tomin | 9 | 23 |
| Kastriot | 1 | 17 |
| Melan | 6 | 12 |
| Sllovë | 2 | 9 |

| Njësia administrative | Ndërmarrjet | Bizneset e vogla |
|---|---|---|
| Muhurr | 2 | 8 |
| Arras | 2 | 6 |
| Fushë-Çidhën | 1 | 3 |
| Lure | | 7 |
| Kala e Dodës | | 4 |
| Zall-Dardhë | | 2 |
| Luzni | | 1 |
| Zall-Reç | | |
| Selishtë | | |
| **Gjithsej** | **95** | **808** |

Burimi: Bashkia Dibër, 2024.

## Tregu i Punës, Punësimi dhe Papunësia në Dibër

Shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është 61,9%, që tregon se pak më shumë se gjysma e popullsisë në moshë pune është e angazhuar në tregun e punës. Burrat kanë nivel më të lartë pjesëmarrjeje (67,2%) krahasuar me gratë (56,4%), që sugjeron se barrierat shoqërore dhe strukturore mund të kufizojnë përfshirjen e grave në veprimtari ekonomike.

**Tabela 23.** Treguesit e tregut të punës, 2023

| Gjinia | Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (%) | Shkalla e punësimit (%) | Shkalla e inaktivitetit (%) | Shkalla e papunësisë (%) |
|---|---|---|---|---|
| **Totali** | **61.9** | **51.0** | **38.1** | **17.6** |
| Burra | 67.2 | 50.4 | 32.8 | 24.9 |
| Gra | 56.4 | 51.7 | 43.6 | 8.3 |

Burimi: INSTAT, 2024.

Shkalla e përgjithshme e punësimit është 51,0%. Gratë kanë një shkallë pak më të lartë punësimi (51,7%) se sa burrat (50,4%). Kjo sugjeron se, megjithëse numri i grave pjesëmarrëse në fuqinë punëtore është më i ulët, ato që marrin pjesë kanë më shumë gjasa se burrat që të gjejnë punë. Shkalla e përgjithshme e inaktivitetit është 38,1%, që tregon se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë nuk është e angazhuar në fuqinë punëtore. Gratë kanë shkallë më të lartë inaktiviteti (43,6%) krahasuar me burrat (32,8%), me gjasë për shkak të përgjegjësive të përkujdesit, të mungesës së mundësive për punë, ose të normave kulturore.Shkalla e përgjithshme e papunësisë është 17,6%, që flet për vështirësi të konsiderueshme për të gjetur punë nga personat që kërkojnë punë aktivisht. Tabloja e punësimit në Dibër pasqyron pabarazitë sektoriale dhe me bazë gjinore, dhe thekson nevojën për ndërhyrje të fokusuara me ndjeshmëri gjinore. Mbizotërimi i bujqësisë dhe shërbimeve në ekonominë e zonës ofron mundësi të ndryshme punësimi, por në këta sektorë shihen dinamika gjinore të dallueshme. Gratë punësohen më së shumti në role përkujdesjeje dhe me pagë të ulët, veçanërisht në sektorë si arsimi, shëndetësia, dhe shërbime akomodimi dhe ushqimore.[65] Sektori i tregtisë, me pjesëmarrje relativisht më të lartë të femrave, përfaqëson një pikë hyrëse për gratë sipërmarrëse, që thekson nevojën për politika që shtojnë aksesin e tyre në kapital, në mundës për zhvillimin e aftësive dhe në rrjete mbështetëse për rritjen e bizneseve të tyre.

65. Bashkia Dibër.

## Bujqësia dhe Blegtoria

Numri i fermerëve të regjistruar[66] në Dibër është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit.

- Nga viti 2020 në vitin 2021, numri i fermerëve u rrit me 399 fermerë (një rritje prej 83,7%).
- Nga viti 2021 në vitin 2022, ky numër u rrit me 496 fermerë (një rritje prej 56,6%).
- Nga viti 2022 në vitin 2023, rritja ishte me 226 fermerë (një rritje prej 16,5%).

**Figura 7.** Numri i fermerëve të regjistruar




Burimi: INSTAT 2024

Bujqësia dhe blegtoria janë pjesë integrale të ekonomisë në Dibër dhe ofrojnë mundësi të shumëllojshme për komunitetet lokale, veçanërisht në zonat rurale. Peizazhi bujqësor i zonës karakterizohet nga veprimtari të shumëllojshme si kultivimi i kulturave bujqësore, blegtoria dhe sektorë të rinj, si bletaria, që së bashku formojnë një zinxhir vlere kompleks. Mbizotërimi i kulturave bujqësore si misri, gruri dhe patatet, së bashku me një prodhim të konsiderueshëm blegtoral, përfshirë bagëtitë e imta dhe gjedhët, është pasqyrim i traditave të forta bujqësore në zonë. Përveç kësaj, prodhimi i konsiderueshëm i bulmetit, mishit, vezëve dhe mjaltit tregon rëndësinë e mbarështimit të bagëtive në ekonominë rurale të Dibrës.

**Tabela 24.** Bagëtitë në shifra, 2023

| Njësia administrative | Gjedhë | | Ripërtypës të vegjël | | Shpendë | | Bletari |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Total | Lopë | Dele | Dhi | Totali | Pula pjellëse | Koshere |
| Maqellarë | 1,571 | 1,549 | 2,470 | 1,020 | 23,325 | 21,123 | 2,216 |
| Melan | 507 | 474 | 951 | 514 | 5,179 | 4,624 | 1,140 |
| Tomin | 1,094 | 1,069 | 1,516 | 300 | 34,052 | 30,850 | 1,135 |
| Kastriot | 698 | 660 | 2,630 | 336 | 7,547 | 6,824 | 1,073 |
| Fushë Çidhën | 461 | 426 | 1,431 | 156 | 4,934 | 4,462 | 378 |

66. Fermerët e regjistruar në NUIS.

| Njësia administrative | Gjedhë | | Ripërtypës të vegjël | | Shpendë | | Bletari |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Total | Lopë | Dele | Dhi | Totali | Pula pjellëse | Koshere |
| Kala E Dodës | 688 | 659 | 10,520 | 135 | 5,579 | 5,050 | 1,140 |
| Luzni | 447 | 414 | 697 | 890 | 5,298 | 4,793 | 849 |
| Muhurr | 618 | 588 | 620 | 830 | 4,932 | 4,460 | 1,201 |
| Selishtë | 359 | 315 | 890 | 762 | 5,116 | 4,629 | 716 |
| Arras | 460 | 427 | 2,127 | 1,927 | 6,981 | 6,324 | 2,450 |
| Zall Dardhë | 235 | 199 | 1,338 | 1,145 | 3,431 | 3,026 | 1,310 |
| Zall Reç | 190 | 157 | 1,230 | 1,187 | 2,779 | 2,430 | 1,227 |
| Lurë | 167 | 133 | 1,230 | 1,164 | 2,613 | 2,260 | 1,335 |
| Peshkopi | 109 | 67 | 0 | 0 | 0 | 0 | 692 |
| **Gjithsej** | **8,200** | **7,700** | **29,000** | **11,000** | **118,100** | **106,500** | **18,200** |

Burimi: Bashkia Dibër, 2024.

Në vitin 2023, nënproduktet blegtorale të prodhuara në Dibër përfshijnë një varg produktesh të qumështit, mishit, dhe produkte të tjera blegtorale. Prodhimi i qumështit është i konsiderueshëm, me një sasi totale prej 26.094 ton, kryesisht qumësht lope (23.147 ton), që është kontribuesi më i madh. Prodhohet gjithashtu edhe qumësht deleje dhe dhie, përkatësisht me 1.682 ton dhe 1.265 ton.Prodhimi i mishit arrin një sasi totale prej 3.217 ton, ku pjesën më të madhe e zënë mishi i lopës (1.927,5 ton) dhe mishi i qengjit (812 ton). Prodhohet gjithashtu edhe mish dhie (264 ton) dhe mish shpendësh (213 ton). Mishi i derrit mungonte nga blegtoria e zonës në vitin 2023, që është tregues i preferencave kulturore dhe fetare.Vlen të përmendet gjithashtu edhe prodhimi i vezëve, që arrin në 17.040.000 kokrra vezë gjithsej, që flet për një sektor të zhvilluar të rritjes së shpendëve. Po kështu, prodhimi i leshit arrin në 72,9 ton, që dëshmon për një për potencial të lartë në zinxhirin e vlerës së leshit. Mjalti është një produkt tjetër me vlerë, me 163,8 ton, që tregon se bletaria është vlerë e rëndësishme në zinxhirët e vlerës të veprimtarive bujqësore në Dibër.

**Tabela 25.** Produktet blegtorale në Dibër, 2023

| Lloji i produktit | Prodhimi në ton |
|---|---|
| **Qumësht në total** | **26.094** |
| - Qumësht lope | 23.147 |
| - Qumësht deleje | 1.682 |
| - Qumësht dhie | 1.265 |
| Mish në total | 3.217 |
| - Mish lope | 1.928 |
| - Mish qengji | 812 |
| - Mish dhie | 264 |
| - Mish shpendësh | 213 |
| Lesh | 72,9 |
| Mjaltë | 163,8 |
| Vezë (kokrra) | 17.040.000 kokrra |

Burimi: INSTAT 2024

Në Bashkinë Dibër ka gjashtë baxho. Dy prej tyre janë të përhershme (një në Melan dhe një në Maqellarë) dhe katër janë sezonale (një në Muhurr, një në Kastriot, dhe dy në Kala të Dodës).

Në vitin 2023, prodhimi bujqësor i Dibrës u përqendrua më së shumti në kultivimin e drithërave dhe të perimeve, me prodhim të konsiderueshëm në drithë, patate, dhe kultura foragjere.

Drithërat zënë një pjesë të madhe të sipërfaqes bujqësore me një total prej 4.675 ha. Misri është kultura dominuese ndër drithërat, me 3.380 ha dhe me 25.170 ton prodhim; gruri kultivohet në 1.140 ha me 5.315 ton prodhim; ndërsa elbi, tërshëra dhe thekra prodhohen në sipërfaqe më të vogla.

Perimet zënë 593 ha me një prodhim total prej 17.610 ton. Kultura e patates është veçanërisht e zhvilluar, me 310 ha dhe me rendiment të lartë prej 33 ton/ha, që flet për një sistem kultivimi efikas. Fasulet kultivohen në një sipërfaqe prej 140 ha, por kanë rendiment shumë të ulët, me 1,5 ton/ha, që tregon për ekzistencën e vështirësive në kultivim, veçanërisht për shkak të ndryshimeve klimatike.

Kulturat foragjere prodhohen në një sipërfaqe të konsiderueshme prej 11,853 ha, me 233.175 ton prodhim i cili përdoret kryesisht për ushqim në blegtori. Rendimenti për këtë kategori nuk specifikohet por sipërfaqja e madhe e kultivuar tregon për rëndësinë e saj në ekonominë bujqësore të zonës.

Bimët mjekësore rriten në një sipërfaqe prej 10 ha, me prodhim total 17 ton dhe rendiment 1.7 ton/ha, që përfaqëson një zinxhir vlere të ri në Dibër.

**Tabela 26.** Kulturat bujqësore të fushave, 2023

| Lloji i kulturës | Sipërfaqja (në ha) 2023 | Prodhimi (në ton) 2023 |
|---|---|---|
| Drithëra | 4.675 | 30.996 |
| - Grurë | 1.140 | 5.315 |
| - Misër | 3.380 | 25.170 |
| - Elb | 99 | 296 |
| - Tërshërë | 37 | 150 |
| - Thekër | 19 | 65 |
| Perime | 593 | 17.610 |
| - Patate | 310 | 10.220 |
| - Fasule | 140 | 2.420 |
| Kultura foragjere | 11.853 | 233.175 |
| Bimë mjekësore dhe aromatike | 10 | 17 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, prodhimi i perimeve në Dibër ndahej në disa kategori, ku përfshihen bimët e arave dhe ato të serrave:

Perimet kultivohen në 592,8 ha, si në fushë të hapur ashtu edhe në serra, me prodhim total 17.610 ton. Kjo tregon se kultivimi i perimeve zë një sipërfaqe e konsiderueshme, megjithëse të dhënat nuk specifikojnë se sa është rendimenti për hektar.

Perimet e freskëta në fusha dhe sera zënë 393,3 ha, me prodhim total 11.760 ton. Në këtë kategori mbizotërojnë perime shumë të kërkuara si domatet, kastravecët dhe specat, që shpesh rriten në serra, me sezone të gjata kultivimi.Perimet e thata rriten në 170,0 ha, me prodhim 4.700 ton. Perimet e thata përfshijnë kultura si fasulet, që zakonisht kultivohen në fushë, dhe jo në serra. Pjeprat dhe shalqinjtë zënë 29,5 ha, me prodhim deri në 1.150 ton.

**Tabela 27.** Sipërfaqja dhe prodhimi i perimeve

| Lloji i kulturës bujqësore | Sipërfaqja (ha) 2023 | Prodhimi (në ton) 2023 |
|---|---|---|
| Totali i perimeve (fushë + serrë) | 592,8 | 17.610 |
| Perime të freskëta (fushë + serrë) | 393,3 | 11.760 |
| Perime të thata (vetëm në fushë) | 170,0 | 4.700 |
| Pjepër dhe shalqi (fushë + serrë) | 29,5 | 1.150 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, prodhimi i perimeve të freskëta në Dibër përbëhej kryesisht nga domatet, kastravecët dhe specat, që prodhoheshin të gjitha në fushë (të dhënat nuk specifikojnë prodhimin në serrë për këto kultura).

Domatet u kultivuan në një sipërfaqe prej 48 ha, me prodhim total 1.680 ton, dhe rendiment 35 ton/ha. Kastravecët u kultivuan në 57 ha, me prodhim total 1.660 ton dhe rendiment 29,1 ton/ha. Specat u kultivuan në një sipërfaqe prej 30 ha, me prodhim total 540 kg dhe rendiment 18 ton/ha.

Në vitin 2023, Dibra kishte një sektor të shumëllojshëm pemësh frutore, të kultivuara në 1.263 hektarë të dedikuar për pemët frutore, nga të cilat 1.059 hektarë në prodhim aktiv, me prodhim total 14.888 ton fruta.

Fruta më i kultivuar ishin mollët, me një sipërfaqe totale 343 hektarë dhe prodhim 6.739 ton. Sipërfaqja në prodhim aktiv zinte 324 hektarë, që tregon se mollët kanë vend të rëndësishëm në prodhimin e frutave në Dibër. Pas tyre vinin kumbullat, me sipërfaqe të kultivuar 208 hektarë dhe prodhim 2.289 ton. Nga këta, 192 hektarë ishin në prodhim aktiv.

Qershitë zinin gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme, me 372 hektarë dhe prodhim total 1.920 ton nga 335 hektarë në prodhim aktiv.

Nektarinat/pjeshkat kultivoheshin në një sipërfaqe toke shumë më të vogël (7 hektarë), me prodhim 197 ton nga kjo sipërfaqe, që tregon se këto fruta janë më pak të përhapura, por ende pjesë e konfiguracionit bujqësor të Dibrës.

Gështenjat dhe arrat zinin së bashku një sipërfaqe të përgjithshme prej 236 hektarësh në prodhim, me prodhim total 1.997 ton. Nga këto, gështenjat zinin një sipërfaqe prej 64 hektarësh me prodhim total 884 ton, ndërsa arrat zinin një sipërfaqe prej 172 hektarësh, me prodhim total 1.113 ton. Arrat dhe gështenjat kanë shumë rëndësi në ekonominë bujqësore të Dibrës, ndonëse në shkallë më të ulët krahasuar me pemët frutore si mollët. Këto të dhëna për prodhimin e pemëve frutore ofrojnë një tablo të potencialit bujqësor të Dibrës, veçanërisht për pemët frutore si mollët dhe kumbullat që kultivohen më gjerësisht. Megjithatë, të njëjtat të dhëna sugjerojnë se mund të ketë vend për përmirësim në praktikat bujqësore, nëpërmjet sistemeve më të mira të ujitjes, të menaxhimit të kulturave bujqësore, apo kontrollit të dëmtuesve.

**Tabela 28.** Pemët frutore dhe prodhimi

| Lloji i frutës | Sipërfaqja totale (ha) | Sipërfaqja në prodhim (ha) | Prodhimi (ton) |
|---|---|---|---|
| Totali i pemëve frutore | 1.263 | 1.059 | 14.888 |
| Mollë | 343 | 324 | 6.739 |
| Kumbulla | 208 | 192 | 2.289 |
| Qershi | 372 | 335 | 1.920 |
| Nektarina/pjeshkë | 7 | 7 | 197 |
| Gështenja | 64 | 47 | 884 |
| Arra | 172 | 77 | 1.113 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Dibra kishte një sipërfaqe totale prej 64 hektarësh të dedikuar për vreshta, të cilat ishin të gjitha në prodhim aktiv, me një prodhim total 645 ton rrush.

## Turizmi, Trashëgimia Kulturore dhe Historike

Një simbol i rëndësishëm historik i Dibrës është lidhja e saj me vendlindjen e heroit kombëtar të Shqipërisë Gjergj Kastrioti Skënderbeu i cili bëri 24 beteja në këtë zonë. Në territorin e Dibrës ka gjithashtu rrënoja arkeologjike, shumë prej të cilave mbeten ende të paeksploruara. Këto rrënoja lidhen me qytetërimet ilire, bizantine, të krishtera dhe mesjetare, që pasqyrojnë rrënjët e thella historike të zonës.

Pasuritë natyrore të Dibrës përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për bashkinë. Në sajë të diversitetit morfologjik dhe morfogjenetik të saj, kjo zonë krenohet me një trashëgimi të pasur dhe unike.

Sikurse u përmend, zona e Dibrës është vend i shumë zbulimeve arkeologjike që dëshmojnë për historinë e pasur të rajonit. Këto zbulime janë prova të një zhvillimi të vazhdueshëm kulturor, me zanafillë nga periudhat parahistorike dhe protohistorike, që nga epoka e hershme e neolitit (kur u shfaqën qytetërimet e para të vërteta neolitike), deri në fundin e periudhës arkaike, që shënon fillimin e qytetërimit ilir. Disa nga vendet më të rëndësishme arkeologjike të shpallura si monumente të kategorisë I, janë Gradishta e Peshkopisë, Gradishta e Bellovës dhe Qyteti i Skënderbeut.

Dibra ofron mundësi turistike në të gjitha stinët e vitit, por këto mundësi janë më të mëdha gjatë verës, kur zona tërheq të apasionuarit pas ecjeve në natyrë, eksploruesit e shpellave, rrënojave të kalave dhe kishave të vjetra, si edhe vizitorë të liqeneve akullnajore të Lurës dhe Balgjajt.

Por megjithëse mundësi të tilla janë të pakufizuara dhe numri i turistëve vazhdon të rritet, kjo nuk ka mundur ta vërë në lëvizje ekonominë lokale, të ardhurat e së cilës mbeten në shifra minimale.

Sipas statistikave që mban zyra e turizmit, gjatë periudhës janar-tetor 2024, Bashkinë Dibër e vizituan 65.567 vizitorë. Zonat më të frekuentuara ishin liqenet e Lurës, Grama, mali i Korabit, Rabdishti, lugina e Drinit të Zi, Gryka e Setës. Në Dibër janë 22 bujtina të regjistruara që ofrojnë shërbime të mikpritjes dhe akomodimit.

**Tabela 29.** Bujtinat

| Vendndodhja | Bujtinat |
|---|---|
| Melan | 4 |
| Kala e Dodës | 5 |
| Tomin | 3 |
| Peshkopi | 2 |
| Maqellarë | 1 |
| Lurë | 2 |
| Selishtë | 2 |
| Kastriot | 1 |
| Arras | 2 |
| **Totali** | **22** |

Gjatë punës në terren u vu re se numri i bujtinave dhe BNB-ve informale është rritur dhe ky biznes po përhapet më shumë për shkak të numrit në rritje të vizitorëve në këtë zonë. Të dhënat për to janë inekzistente dhe roli i grave mbetet relativisht i padukshëm, duke marrë parasysh se shumica e personave të punësuar në këtë sektor janë gra dhe vajza, sepse veprimtaritë kryesore ku ato përfshihen janë veprimtaritë e gatimit dhe mirëmbajtjes.*Për sa i përket sektorit të turizmit kurativ, pothuaj 70% e banorëve në zonat e Llixhave përdorin shtëpitë e tyre për akomodim të turistëve dhe pjesa më e madhe e të punësuarve në këtë sektor janë gra. Të dhënat e bashkisë tregojnë se në këtë zonë ka mbi 30 bujtina me më shumë se 15 shtretër, 50 bujtina me 10 deri në 15 shtretër, dhe 170 bujtina me më pak se 10 shtretër.*[67]

**Tabela 30.** Monumentet në Dibër

| Monumentet natyrore në Bashkinë Dibër[68] | | |
|---|---|---|
| **Gjeomonumentet** | **Biomonumentet** | **Hidromonumentet** |
| Karsti i Malit të Bardhë Sllovë | Liqeni i Luleve | Krasta e Pocestit |
| Guri i Kuq | Liqeni i Zi | Pylli i Borovikut të Begjunecit |
| Shpella e Rusit | Liqeni i Madh | Pylli i Lurës |
| Shpella e Qytezës | Liqenet e Kacnisë | Rrapi i Kërçishtit |
| Shpella e Akullit | Ujëvara e Pocestit në Maqellarë | Rrapi i Blliçës, Polje |
| Pasqyra e Gramës | Burimi i Ujit të Ftohtë | Ahu i Blliçës |
| Gropa e Panairit | Burimi Karstik i Kërçinit | Lisi në fshatin Polje |
| Bjeshka e Zonjave në Gramë | Kroi i Mbretit | Lisi Kabë |
| Gryka e Madhe e Lurës | Burimi termomineral i Llixhave në Peshkopi | Vakëfi i Sinës së Epërme |
| Guri i Kripës i Kërçinit | Burimet e Bellovës | Lisi i Lurës |
| Guri i Kërçinit | Burimi dhe shpella e Sopanikës | Plepi i Zi, Çidhën |
| Rrafshi i Korabit | | |
| Morenat e Fushë Lurës | | |
| Cirku i Kurorës së Lurës | | |
| Kodra e Parave (Bllicë), fshati Kukaj | | |
| Fusha e Pelave | | |

67. *USAID PLGP "GSVCA Dibër"* (Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës në Dibër, Projekti PLGP i USAID), 2019.
68. Plani i Zhvillimit të Territorit, Bashkia Dibër.

### Ushqimi Tradicional

Ushqimi tradicional është një tjetër simbol i traditës së pasur të Dibrës që ruhet edhe sot. Pak ka ndryshuar, por është ende i shijshëm. Sekreti i shijes së tij është se ai është gatuar njëlloj për shekuj me radhë, me shumë dashuri. Klima relativisht e ngrohtë e zonës ofron kushte të shkëlqyera kultivimi për një numër frutash, erëzash dhe perimesh. Fasulet, mishi i pulës me jufka (makarona tradicionale), sarmat (gjethe lakre ose rrushi të përgatitura me mish dhe oriz), speca të mbushur me gjizë, gjellë me patate dhe sheqerpare (një ëmbëlsirë shumë e këndshme), konsiderohen si ushqimet më të famshme tradicionale. Dibra njihet gjithashtu si vendi ku rriten arra, gështenja dhe lajthi të shijshme, si edhe fruta si qershitë, mollët, dardhat, kumbullat që përdoren gjithashtu edhe për përgatitjen e prevedeve të shijshme.[69]

# Shtojca 2: Konteksti Kombëtar i Barazisë Gjinore

Korniza ligjore në Shqipëri, sidomos për sa i përket barazisë gjinore, është ndërtuar mbi dispozitat kushtetuese dhe ligjore që synojnë të sigurojnë të drejta të barabarta të burrave dhe grave.
Neni 18/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk duhet të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etniciteti, gjuha, bindjet politike, ose karakteristika të tjera.

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar kornizën e saj ligjore me standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe luftimin e diskriminimit, dhunës, dhe abuzimit në familje me bazë gjinore. Ndër ligjet kryesore që kontribuojnë në këtë kornizë ligjore përfshihen:

1. **Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri"** (Ligji nr. 9970/2008): Ky ligj trajton çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, për sigurimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre, që ata të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Ai gjithashtu parashikon masa të veçanta të përkohshme, ndër të cilat edhe kuota gjinore prej 30% për poste politike dhe vendimmarrëse.

2. **Kodi Zgjedhor (Ligji nr. 10019/2008):** Me ndryshimet që iu bënë në vitin 2012, në Kod u përfshinë kuotat gjinore në procesin zgjedhor, duke siguruar që asnjëra gjini të mos përfaqësohej nga më pak se 30% në listat e kandidatëve të partive politike për zgjedhjet parlamentare. Përpos kësaj, në vitin 2020 dhe vitin 2024 u përfshinë dispozita të specifike për garantimin e kuotave gjinore. Ndryshimet që iu bënë Kodit në 2015 dhe 2020 i zgjeruan më tej kuotat gjinore, ndër të cilat edhe kuota prej 50% meshkuj dhe 50% femra për zgjedhjet vendore.

3. **"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008** "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Ligji Nr. 57/2016), përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të të njëjtës natyrë.

4. **Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore"** (Ligji nr. 68/2017) ka krijuar mundësi për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

69. Shih: https://visitdiber.com/maps/guides/visit_diber_english.pdf

5. **Kodi i Punës (Ligji nr. 7961/1995):** Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim, kërkon akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe ndalon ngacmimin moral dhe seksual në vendin e punës. Ai përfshin gjithashtu edhe dispozita për promovimin e barazisë gjinore në punësim dhe të drejta profesionale.

6. **Ligji "Për personat me aftësi të kufizuara"** (Ligji nr. 93/2014): Ky ligj garanton mundësi dhe akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë garantimin që gratë me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi si burrat me aftësi të kufizuara për akses në të drejtat e garantuara nga ky ligj.

7. **Ligji "Për sigurimet shoqërore"** (Ligji nr. 104/2014): Ky ligj njeh të drejtën e nënave dhe të baballarëve për leje prindërore, përfshirë zgjatjen e lejes së barrëlindjes deri në 63 ditë dhe aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura.

8. **Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"** (Ligji nr. 9669/2006): Ky ligj synon parandalimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës, duke u ofruar mbrojtje viktimave përmes procedurave të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta. Me ndryshimet që iu bënë ligjit në vitet 2018 dhe 2020 u forcuan dispozitat që lidhen me parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

9. **Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, i ndryshuar (Ligji nr. 221, datë 04.02.2010). Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër. Edhe ky ligj u përmirësua me Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.

10. **Ligji 22/2018 "Për strehimin social"**, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

11. **Ligji 110/2018 "Për noterinë"**, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

12. **Ligji 111/2018 "Për kadastrën"**, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

13. **Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"**, ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të pafavorizuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

14. **Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"** ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

15. **Ligji 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara"**, ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ) përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipat dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.[70]

Në nivel vendor, promovimi i përfshirjes dhe barazisë gjinore është bërë pjesë e kornizave ligjore dhe të politikave që theksojnë detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore (UN Women, 2019). Për shembull, Ligji «Për barazinë gjinore» shtjellon nevojën për promovimin e barazisë gjinore në qeverisjen lokale dhe njësitë e veçanta që janë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës dhe shërbimit, përfshirë barazinë gjinore. Janë bërë përpjekje nga disa bashki për t'iu përmbajtur dispozitave të rregullores së e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) dhe standardeve e BE-së, me strukturë të qartë, prioritete, përgjegjësi dhe buxhete që u përgjigjen nevojave të grave, burrave, të rinjve e të rejave në mënyrë të barabartë (UN Women, 2018). Tetëmbëdhjetë njësi vetëqeverisëse vendore kanë nënshkruar "Kartën evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore" – një numër i tyre me ndihmën e UN Women, dhe 15 prej tyre kanë hartuar plan veprimi vendor për barazinë gjinore.

Si rezultat i këtyre, ligjeve, politikave dhe planeve, Shqipëria ka shënuar përmirësime në shumë aspekte të barazisë gjinore, për shembull, në rolin e grave në zhvillimin e sektorit privat. Përqindja e sipërmarrjeve me pronare ose administratore gra është rritur në të gjitha zonat e Shqipërisë. Megjithatë decentralizimi dhe zbatimi i suksesshëm i kornizave ligjore dhe të zhvillimit ende has në vështirësi dhe ritmi i ndryshimit në fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të sektorit privat është i ngadaltë, sidomos ndër gratë në zonat rurale. Normat, rolet dhe përgjegjësitë gjinore, dhe tendencioziteti gjinor në aksesin e grave në burimet prodhuese (si toka, financat, rrjetet, teknologjia dhe pajisjet) dhe në shërbimet e biznesit, bëjnë që ende të mos ketë barazi për gratë dhe burrat në sferat ekonomike dhe sociale.

Disa ndikime të tendenciozitetit gjinor që shihet në Shqipëri për sa i përket fuqizimit të grave përmes zhvillimit të sipërmarrjeve, janë:

- 31,2% e ndërmarrjeve drejtohen nga gra.[71] Në vitin 2022, përqindja e grave pronare dhe administratore u pakësua krahasuar me vitin 2021, si për sa u përket bizneseve që prodhojnë mallra, ashtu edhe ato në sektorin e shërbimeve. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në sektorin e shërbimeve se sa në sektorin e prodhimit të mallrave, me përkatësisht 33,4 % dhe 17,2 %.

- Shkalla e punësimit në vitin 2023 ishte 72,9 % për burrat dhe 58, 9 % për gratë në grupmoshën 15-64 vjeç. Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 23,5% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.[72]

70. VKM nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit"

71. NSTAT, Regjistrat e Biznesit, 2023. https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab3

72. Gra dhe burra në Shqipëri, 2022, https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-Treguesis/gender-equality/#tab3

- Në Shqipëri, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është 4 herë më i madh se i atyre me kryefamiljare gra. Grupmosha 55-64 vjeç ka numrin më të madh të familjeve me kryefamiljarë burra, dhe grupmosha 74+ vjeç, numrin më të madh të grave kryefamiljare. Për të gjitha grupmoshat, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është më i lartë.[73]

Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri, ku përbëjnë një pjesë të madhe të forcës punëtore në bujqësi, ndonëse në shumicën e rasteve në punësim informal. Në vitin 2023, 37,3 % e grave të punësuara ishin të punësuara në sektorin e bujqësisë, me një rritje prej 0,1 pikë përqindjeje krahasuar me vitin pararendës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale.

Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[74]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.[75] Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[76]

Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-)pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[77] Gratë luajnë rol kyç në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të komuniteteve rurale. Por ky rol i rëndësishëm i tyre – sidomos në prodhimin bujqësor – shpesh është "i padukshëm" dhe nuk njihet.[78]

73. Ligji .

74. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

75. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2024.

76. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

77. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

78. Ligji .

# Shtojca 3. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural: Çështje Gjinore Kyçe në Shqipëri

## Puna e grave në bujqësi kontribuon konsiderueshëm në ekonomi, por roli i tyre përgjithësisht vazhdon të mos njihet

Në vitin 2022 bujqësia përfaqësonte 17,7 për qind të PBB-së në Shqipëri.[79] Ajo vazhdon të jetë sektor kyç në ekonominë e vendit, ku angazhohen 33,9 për qind të forcave aktive të punës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale: ato përbëjnë 40,1 për qind të forcave të punës në bujqësi, krahasuar me 28,7 për qind të burrave.[80] Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punës për gratë që jetojnë në zonat rurale.

Ashtu si sektorë të tjerë të ekonomisë, sektori bujqësor karakterizohet nga segmentimi gjinor i tregut të punës. Gratë e punësuara në bujqësi kanë më tepër gjasa të kryejnë punë me paga të ulëta, me kohë të pjesshme ose sezonale, ndërsa burrat janë më së shumti të punësuar në vende pune të paguara më mirë dhe me kualifikim më të lartë.[81] Në përgjithësi, gratë janë të mbipërfaqësuara në punësim informal, punë të papaguar, dhe si kontribuese të punës në familje. Një analizë e strukturës së punësimit dhe statusit të aktiviteteve të personave të punësuar tregon se 23,5 për qind e grave punojnë në familje, ndërsa përqindja e burrave që punojnë në familje është shumë më e ulët, 13.2 për qind. Përpos kësaj, sektori karakterizohet nga një sasi e konsiderueshme pune të papaguar të grave.[82] Në punësimin informal, përqindja e grave që kontribuojnë si punëtore në familje është pothuaj dy herë më e madhe se e burrave (54 për qind kundrejt 28 për qind).[83] […] Megjithëse gratë mbajnë mbi shpatulla një pjesë të konsiderueshme të barrës së punës në bujqësi, kontributi i tyre mbetet në një shkallë të lartë i pavlerësuar nga pikëpamja ekonomike.[84] […][85]

## Stereotipat gjinorë dhe praktikat diskriminuese kufizojnë aksesin e grave në burimet thelbësore të prodhimit bujqësor bazë

Në themel të praktikave diskriminuese qëndron koncepti i rrënjosur thellë se puna e grave është plotësuese e punës së burrave, të cilët konsiderohen si fituesit kryesorë të jetesës në familjet shqiptare. Kështu, ndërkohë që kryefamiljarët meshkuj shpesh janë pronarë që zotërojnë dhe administrojnë pasuritë familjare dhe lëndët e para bujqësore (për shembull, farat, plehrat organike dhe kimike, makineritë bujqësore), gratë në të njëjtat familje shpesh nuk kanë lirinë t'i përdorin burimet ose të vendosin bashkërisht për varietetet e bimëve, llojet e plehrave dhe kimikateve që përdoren, ose kohën e përdorimit të tyre. Në këto raste, gratë nuk mund t'i vënë njohuritë dhe përvojat e tyre në shërbim të veprimtarive prodhuese. […] Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime

79. INSTAT [në internet]. Të dhënat e llogarive kombëtare (PPB) të vitit 2023. Shih: https://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/

80. INSTAT (2023). Gra dhe Burra. Shih: https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf. Ndërsa në vitin 2019, burrat përbënin 32,2 për qind, përqindja e grave ka mbetur pothuaj e pandryshuar.

81. FAO (2011). *The Role of Women in Agriculture* (Roli i grave në bujqësi). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/a605b688-83e0-4e3a-ad47-874f0d6f63b1

82. INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/labour-market-2022/

83. Përllogaritjet e ONP-së për vitin 2019 (ILOSTAT). Shih: ONP (2023). Women and Men in the Informal Economy: A Statistical Update (Gratë dhe burrat në ekonominë informale: përditësim statistikor). Gjendet në: https://www.ilo.org/publications/women-and-men-informal-economy-statistical-update

84. FAO (2016). Gender, Agriculture and Rural Development in Albania (Gjinia, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

85. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[86]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.

Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[87] […][88]

### Shërbimet këshillimore bujqësore janë kryesisht për burrat

Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) për këshillim bujqësor, një strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, operon nëpërmjet katër agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor (AREB) dhe, në nivel vendor, përmes qendrave të informacionit bujqësor. Shërbimi këshillimor publik përfshin gjithashtu pesë qendra të specializuara të transferimit të teknologjisë bujqësore. […] kapacitetet dhe aftësitë gjinore ende nuk janë pjesë e kualifikimeve të kërkuara për punonjësit dhe trajnimet në këtë drejtim mungojnë. Reagueshmëria e dobët gjinore e shërbimeve, së bashku me statusin social të grave dhe nivelet e ulëta të pronësisë së tyre mbi tokën, ka bërë që gratë të kenë akses të kufizuar në shërbime mbështetëse.[89] Shërbimet këshillimore bujqësore kanë si grup të synuar dhe ndihmojnë burrat: ndër 70.000 fermerët që u kontaktuan dhe ndihmuan nga shërbimet këshillimore në zona të ndryshme të vendit në vitin 2016, u konstatua se vetëm rreth 11 për qind ishin gra.[90] Që prej atëherë, numri i grave përfituese të shërbimeve këshillimore është tkurrur më tej, duke arritur në vetëm 8 për qind në vitin 2023.[91] Si rezultat i aksesit të kufizuar në informacione bujqësore dhe për tregun, niveli i produktivitetit të grave mbetet i ulët. […][92]

### Niveli i tanishëm i (bashkë-)regjistrimit të fermave kufizon aksesin e grave në mundësi ekonomike

Legjislacioni që garanton të drejta të barabarta të grave në pronësi dhe trashëgimi është përmirësuar ndjeshëm.[93] Megjithatë, ende nuk janë të disponueshme të dhëna në lidhje me (bashkë-)pronësinë e grave mbi tokën. Aktualisht, vetëm 10 për qind e titujve të pronësisë mbi tokën janë të regjistruar digjitalisht, 10 për qind nuk janë të regjistruar, ndërsa 80 për qind ekzistojnë të regjistruar vetëm në letër. […] Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-) pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në

86. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

87. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

88. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

89. FAO (2024). *Ensuring that rural advisory services are responsive to women: good practices from FAO experiences in Europe and Central Asia* (Sigurimi që shërbimet këshillimore rurale t'u përgjigjen nevojave të grave: praktika të mira nga përvojat e FAO-s në Evropë dhe Azinë Qendrore). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/c69ef2a6-4381-4e16-b624-a090e94b5710

90. UNDP dhe UN Women (2016). Dosja Gjinore Shqipëri. Shih: https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief

91. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

92. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023.. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

93. Ligji nr.111/2018 për Kadastrën, miratuar më 02/02/2019. Gjendet në: https://www.ashk.gov.al/2021/04/16/2066/. (versioni në gjuhën angleze gjendet në): https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC220473/); dhe Ligji nr.110/2018 për Noterinë, miratuar më 20/12/2018. Gjendet në: http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2021/04/Ligj-nr.-110-2018-Per-Noterine.pdf. (Një përkthim jozyrtar në anglishte gjendet në: https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=160&catid=25&m=0). Legjislacioni i ri synon të mbrojë gratë nga tjetërsimi, blerja dhe heqja dorë nga pronat e tyre të paluajtshme, përfshirë tokën. Ai parashikon zbatimin e një sistemi me një sportel, tek noteri publik, për transaksionet që lidhen me tokën si edhe krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për sigurimin e llogaridhënies nga noterët.

emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[94] […]Kjo i ka penguar gratë fermere që, për shembull, të përfitojnë shërbime këshillimore bujqësore, mbështetje financiare, dhe kontrata formale të rregullta me tregtarët, gjë që ka ndikuar negativisht në produktivitetin e tyre.[95] Krahas kësaj, gratë ndeshin vështirësi për të pasur akses në kredi nga bankat komerciale, kryesisht për shkak të kolateralit të pamjaftueshëm, situatë që rëndohet edhe më për shkak se të drejtat pronësore *de facto* janë të dobëta ose inekzistente. Arritja e një barazie më të madhe në të drejtat pronësore mbi tokën dhe aksesin në kredi do të shtonte ndjeshëm pjesëmarrjen fitimprurëse të grave në ekonominë bujqësore. Mungesa e pronësisë mbi tokën ndikon gjithashtu edhe në mundësitë e anëtarësimit të grave në organizatat e fermerëve, si shoqatat e përdoruesve të ujit dhe të ujitjes dhe shoqatat e prodhuesve. Duke qenë se për t'u anëtarësuar në këto organizata shpesh duhet të jesh pronar i tokës ose kryefamiljar, gratë e kanë të vështirë të bëhen anëtare të tyre. Kur shërbimet këshillimore bujqësore u drejtohen vetëm fermerëve të regjistruar ose anëtarëve të shoqatave, gratë automatikisht përjashtohen për shkak të mospërmbushjes së kushteve të anëtarësimit dhe, rrjedhimisht, nuk përfitojnë nga këto shërbime. […][96]

### Gratë kanë (bashkë-)pronësi të kufizuar në ferma dhe ndërmarrje bujqësore

Në vitin 2022, nga 84.369 fermerë të regjistruar zyrtarisht në zyrat tatimore në Shqipëri, vetëm 10,8 për qind ishin gra.[97] Pjesa më e madhe e kontributit të grave në sektorin bujqësor konsiston në punësim informal në familjen bujqësore.[98] Në këtë lloj aktiviteti bujqësor, burrat përgjithësisht identifikohen si drejtues dhe "kryefamiljarë" ndërsa gratë janë të regjistruara si "ndihmëse", nën kategorinë "punëtorë familjarë kontribues".[99] Zakonisht burrat janë ata që kanë nën kontroll asetet bujqësore, marrin vendime, administrojnë financat dhe kryejnë punët që kërkojnë lëvizshmëri, ndërsa gratë merren kryesisht me punë fizike bujqësore, si punët para dhe pas vjeljes/korrjes, përpunimet ushqimore dhe punët e shtëpisë. Kjo ndarje e pabarabartë e punës kufizon aksesin e grave në asete bujqësore. Ndërmarrjet që operojnë në kuadër të kategorisë ekonomike "Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi" përfaqësojnë vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive.[100] Në mbi 80 për qind të ndërmarrjeve bujqësore aktive, pronarët ose drejtuesit janë burra: në vitin 2022, gratë ishin (bashkë-)pronare të vetëm 18,5 për qind të ndërmarrjeve aktive në bujqësi, pylltari, dhe peshkim.[101] Që nga viti 2016, numri i përgjithshëm i grave pronare dhe drejtuese të bizneseve në Shqipëri është rritur. Megjithatë, niveli dhe ritmi i përfshirjes ekonomike të grave përmes zhvillimit të sektorit privat vazhdojnë të jenë të ulëta, sidomos për sa u përket grave në zonat rurale. Ndikimi i normave gjinore kufizuese që çojnë në diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të grave është i dukshëm në të gjitha nivelet e ekonomisë rurale […][102]

### Gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në burimet e nevojshme për t'u marrë me biznes

Shumë gra në Shqipëri përballen me vështirësi për të pasur akses në burime biznesi. Gratë që nuk kanë llogari bankare apo nuk zotërojnë tokë për ta ofruar si kolateral, kanë akses të kufizuar në shërbime financiare, gjë që ua bën të vështirë të krijojnë, menaxhojnë, ose zgjerojnë bizneset e tyre.

94. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

95. UN Women (2016). Studim kombëtar: Diversifikimi ekonomik për gratë që jetojnë në zonat rurale në Shqipëri. Gjendet në: https://albania.un.org/en/46581-economic-diversification-women-living-albanian-rural-areas

96. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

97. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

98. Ligji .

99. FAO (2016). *Gender, Agriculture, and Rural Development in Albania* (Gjinia, bujqësia dhe zhvillimi rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

100. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

101. Ligji .

102. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Për përfitimin e shërbimeve financiare zakonisht është kusht që të kesh llogari bankare. Megjithatë, ekziston një vijë e qartë ndarëse midis zonave rurale dhe urbane: në vitin 2017, vetëm 31 për qind e banorëve të zonave rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 52 për qind të banorëve në zona urbane.[103] Përveç kësaj, shihet qartë edhe një hendek i konsiderueshëm gjinor: në grupmoshën 15-45 vjeç, vetëm 17 për qind e grave dhe 25,9 për qind e burrave që jetonin në zona rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 44,7 për qind të grave dhe 48,2 për qind të burrave në zonat urbane.[104] Këto rezultate ilustrojnë disavantazhet për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si rezultat i karakteristikave gjinore (domethënë, të qenit grua) dhe atyre të vendbanimit (domethënë, banimi në zone rurale).
Krahas kësaj, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në trajnime që ofrojnë njohuri dhe aftësi biznesi, si ato për përpunimin dhe marketimin e produkteve. Për marketimin e duhur të biznesit, është e rëndësishme të merret në kohë informacion i saktë përmes telefonit celular, radios, apo përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Zotërimi ose jo i këtyre mjeteve dhe burimeve nga gratë mund të ndikojë në suksesin e biznesit të tyre.

Ndonëse përgjithësisht janë bërë përparime në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në marketim, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në internet dhe në TIK. Në përgjithësi, infrastruktura e teknologjisë së informacionit është mjaft e zhvilluar në qendrat urbane. Kurse në zonat rurale, ku mbulimi me infrastrukturën e energjisë elektrike dhe internetit me bandë të gjerë nuk është aq i zhvilluar, kostot e këtyre shërbimeve janë të larta dhe depërtimi i ulët – dhe numri i personave që kanë akses në internet dhe që përdorin atë është më i vogël. Në zonat rurale, më pak se 10 për qind e familjeve kanë akses në internet dhe vetëm 28 për qind e tyre kanë kompjuter.[105] Mungesa e konektivitetit të zonave rurale në Shqipëri është evidentuari si një prej mangësive që pengon rritjen ekonomike në vend.[106] Për më tepër, kur në familje ka vetëm një telefon celular, ai shpesh përdoret vetëm nga kryefamiljari, ndërsa gratë dhe vajzat në familje nuk mund ta përdorin atë lirisht. Aktualisht nuk ka studime mbi aksesin e grave në zonat rurale në internet dhe në TIK.

### Gratë fermere kanë përfaqësim të ulët në organizata, shoqata dhe organe vendimmarrëse në zonat rurale

Me gjithë rolin e rëndësishëm të grave të zonave rurale në prodhimin bujqësor në Shqipëri, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në nivel të familjes, komunitetit dhe administrativ është përgjithësisht e kufizuar. Gratë rrallë janë anëtare apo përfaqësohen në shoqata apo komitete zyrtare dhe ato vazhdojnë të jenë tejet të nënpërfaqësuara në poste vendimmarrëse dhe drejtuese.[107] Në nivel komuniteti, burrat janë drejtues të grupeve prodhuese dhe kooperativave, ndërsa gratë janë të përjashtuara, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga marrja e vendimeve. Në organizatat e fermerëve, numri i grave anëtare është zakonisht i ulët, sepse në ato organizata pranohen si anëtarë kryesisht kryefamiljarët. Rrjedhimisht, gratë rrallë janë të pranishme në diskutime dhe vendimet që merren në grup nuk pasqyrojnë njohuritë, pikëpamjet, nevojat dhe të drejtat e tyre. Shqetësim është gjithashtu mospjesëmarrja e grave në proceset e menaxhimit të burimeve natyrore, si menaxhimi i integruar i ujit, si dhe niveli i ulët i përfshirjes së grave rurale në nismat lidhur me ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore.[108]
[…] Gjithashtu, gratë nuk kanë pushtet ekonomik, influencë politike, apo informacion mbi proceset e vendimmarrjes. Së fundi, për shkak të kufizimeve në mundësitë e lëvizjes, largësia fizike nga qendrat administrative ku merren vendimet i kufizon më tej mundësitë e pjesëmarrjes së grave. […][109]

103. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik, dhe ICF (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Gjendet në: http://www.instat.gov.al/media/5050/adhs-2017-18-pdf.pdf
104. Ligji .
105. Ligji .
106. ITU (2022). *Albania – Digital Development Country Profile* (Shqipëria – Profili i zhvillimit digjital të vendit. Shih: https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Publications/2022/Digital%20Development/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf
107. UN Women (2020). Dosja e Barazisë Gjinore, Shqipëri 2020. Shih: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0
108. Ligji .
109. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

### Ofrimi i shërbimeve dhe infrastruktura rurale nuk plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave

Në Shqipëri vazhdon të jetë shqetësim aksesi i kufizuar – sidomos i grave dhe vajzave - në shërbime bazë si shëndetësia, kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues dhe mbrojtja sociale në zonat rurale dhe të thella.[110] Krahas kësaj, infrastruktura e dobët e furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza, mungesa e pajisjeve teknologjike që kursejnë kohë, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël, infrastruktura e pasigurt e transportit dhe mungesa e transportit publik me kosto të përballueshme - që të gjitha ndikojnë negativisht në mundësitë e grave për t'i kushtuar kohë punës produktive dhe të paguar dhe për të pasur akses në tregje.

### Formimi profesional bujqësor nuk mbështet perspektivat e grave dhe vajzave për të pasur karrierë në këtë sektor

Në kuadër të aspiratës së Shqipërisë për të hyrë në tregun e përbashkët të BE-së, të rinjtë e të rejat duhet të kenë nivele të reja të përgatitjes profesionale që të mund të angazhohen si punëtorë fermash, teknikë, sipërmarrës biznesesh bujqësore apo vendimmarrës në fushën e zhvillimit rural. Shkollat profesionale luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara dhe pajisjen e të rejave dhe të rinjve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kërkon tregu. Por me gjithë veprimtaritë promovuese dhe mbështetjen për nxitjen e nxënësve nga zonat rurale të Shqipërisë për të marrë pjesë në arsim dhe formim profesional (AFP), numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale ka rënë. Kjo rënie ka qenë veçanërisht e ndjeshme në regjistrimet nga radhët e grupeve vulnerabël (një rënie me 30 për qind).[111] Në Shqipëri ka tetë shkolla të mesme bujqësore dhe nxënësit në to vazhdojnë të jenë pothuaj tërësisht djem. Numri i vajzave është i ulët (afërsisht 16 për qind) dhe pjesëmarrja e vajzave nga zonat rurale është pothuaj e papërfillshme. […][112]

### Politikat, programet, buxhetet dhe skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë nuk u përgjigjen mjaftueshëm nevojave të grave

Në përgjithësi, politikat, planet, programet dhe buxhetet në Shqipëri hartohen mbi bazën e premisës se të gjithë individët që merren me bujqësi dhe blegtori janë burra. Sikurse shihet edhe në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027,[113] vëmendja e dokumenteve strategjike përqendrohet tek fermerët burra. Edhe zyrtarët dhe punonjësit e këshillimit bujqësor që shpërndajnë teknologji, politika, informacion dhe risi bujqësore ndër fermerët, janë kryesisht burra. Ndonëse në periudhën 2018-2023 numri i përgjithshëm i grave që përfituan nga skemat kombëtare të mbështetjes pati rritje në vlerë absolute, përqindja e grave në raport me numrin e gjithsejtë të përfituesve ra nga 22 për qind në vitin 2018 në 16 për qind në vitin 2023.[114] Për të nxitur pjesëmarrjen e grave, Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (FBZHR) u jep pikë shtesë ("bonus") grave që aplikojnë. Megjithatë, përqindja e grave që aplikojnë dhe përfitojnë nga programet e FBZHR-së mbetet jashtëzakonisht e ulët.[115] […]

110. KEGJFDG E OKB-SË (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en

111. Komisioni Evropian (2023). Raporti për Shqipërinë 2023. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

112. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

113. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, miratuar me Vendimin nr.460, datë 29 qershor 2022. Gjendet në: https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/100/6dea9d2c-c264-48a8-a9e1-d041781a823c;q=strategjia%20e%20bujqesise%20dhe%20zhvillimit%20rural

114. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

115. Në vitin 2018, në skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi aplikuan 779 gra, nga të cilat 627 i përfituan ato. Pesë gra përfituan nga "mbështetja për investime në agroturizëm", "inkubator për mbështetjen e prodhimeve vendore tradicionale" dhe "mbështetje për ndërtimin ose rindërtimin e mjediseve të akomodimit në turizmin rural me të paktën 6 deri në 10 dhoma". Në vitin 2019, përqindja e grave që aplikuan për subvencione nga AZHBR ishte 19 për qind. Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2019; dhe: Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë (2020). Raport alternativ mbi zbatimin e Konventës KEGJFDG në Shqipëri 2016-2020. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/alternative-report-on-the-implementation-of-the-cedaw-convention-in-albania

Programi i Zhvillimit Rural në kuadër të Instrumentit të Asistencës Para Anëtarësimit (IPA) i Republikës së Shqipërisë 2021-2027 (IPA-ZHR III) përmend shprehimisht detyrimet dhe objektivat e barazisë gjinore.[116] Në të përmendet *Aide-Mémoire* e kornizës ndërkombëtare përkatëse[117] për përfshirjen e perspektivës gjinore në Planin e Veprimit për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë të OKB-së, detyrimet në kuadër të Planit të Tretë të Veprimit Gjinor të BE-së[118], dhe aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2021-2030), Objektivi 3.1, "Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale".[119] Qëllimi i përgjithshëm i IPA-ZHR III është rritja e punësimit dhe të ardhurave "të gjeneruara nga gratë dhe sipërmarrësit e rinj në zonat rurale". Në dokument jepen rregullat për aksesimin e fondeve të IPA-ZHR III, ku përfshihen:

- respektim i shprehur i standardeve të BE-së lidhur me kërkesat e barazisë gjinore, pra, integrim i perspektivës gjinore në të gjitha programet;
- kryerja e analizës gjinore;
- të dhëna të ndara sipas gjinisë;
- përdorimi dhe monitorimi i treguesve gjinorë;
- trajnimi për integrimin gjinor në strukturat operative;
- bashkëpunimi me organizatat/shoqatat e grave;
- pjesëmarrja e barabartë e grave në grupet dhe organet zyrtare (si Grupet e Veprimit Vendor);
- përfaqësimi i grave në poste udhëheqëse dhe vendimmarrëse;
- përfshirja e organeve qeveritare përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore;
- veprim afirmativ (kuotat, preferenca ndaj grave aplikante);
- raportim i rezultateve të barazisë gjinore.

Nuk ka informacion të disponueshëm për nivelin e përmbushjes dhe zbatimit të rregulloreve të barazisë gjinore gjatë zbatimit të IPA-ZHR III. Në vitin 2023, Komisioni Evropian pezulloi IPA-ZHR III dhe ajo vazhdon të jetë joaktive.

Rregullat e BE-së të përcaktuara në kuadër të programit IPA-ZHR III për adresimin dhe promovimin e barazisë gjinore në bujqësi shërbejnë si udhëzues i vlefshëm për harmonizimin me standardet e BE-së. Është e nevojshme që të reagohet me politika dhe rregullore kombëtare që rezultojnë në ngushtimin e hendekut gjinor dhe promovojnë një mjedis ku gratë kanë akses të barabartë në burime, në mënyrë që ato të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në prodhim bujqësor, konkurrencë, rritje ekonomike dhe zhvillim rural.

### Boshllëqe në statistikat dhe të dhëna gjinore për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe statistikat gjinore janë shumë të rëndësishme për të kuptuar situatën me të cilën përballen gratë dhe burrat në sektorin BZHR në Shqipëri. Ato janë gjithashtu me rëndësi kyçe për kryerjen e analizave gjinore, hartimin e politikave reaguese gjinore dhe zhvillimin e masave për trajtimin e pabarazive dhe sfidave specifike gjinore. Megjithatë, mangësitë aktuale në të dhëna pengojnë hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe buxheteve që kanë lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural të cilat u kundërvihen pabarazive, trajtojnë sfidat specifike gjinore, dhe monitorojnë siç duhet përparimin e bërë në ngushtimin e dallimeve gjinore.[120]

116. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Programi-IPARD-III_2021-2027_English.pdf

117. UN Women - *Women's Resilience to Disasters Knowledge Hub (2017). Aide-Memoire on integrating gender equality in the UN plan of action on disaster risk reduction for resilience* (Qendër e njohurive për përballimin e fatkeqësive nga gratë (2017). (Kujtesë për integrimin e barazisë gjinore në planin e veprimit të BE-së për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe përballimin e situatave). Gjendet në: https://wrd.unwomen.org/practice/resources/aide-memoire-integrating-gender-equality-un-plan-action-disaster-risk-reduction

118. Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Treguesis to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*(Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor III), f.27. Gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284

119. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 15/07/2021. Shih: https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112. Gjendet në:
https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

120. KEGJFDG e OKB-së (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en]

**Figura 8.** Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri




Burimi: INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në : FAO dhe UN Women (së shpejti). National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

# Fuqizim i Grave për Zhvillim Rural në Shqipërinë e Veriut

SHKODËR DIBËR MALËSI E MADHE BULQIZË

Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN